



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 19

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 19

Janar-Dhjetor 2022

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MNI	Margjina Neto e Interesit
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2023),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 19, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	8
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	9
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	18
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	22
3.1. Ekonomia e brendshme-----	25
Kutia 2. Kontributi i diasporës në ekonominë e Kosovës: skenari bazë dhe skenari alternativ ---	30
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	32
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	34
Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e huamarrësëve Individual në Kosovë -----	36
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	43
4.1. Aktiviteti bankar -----	46
Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar -----	51
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	56
5.1. Rreziku kreditor -----	57
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit -----	61
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja -----	65
5.4. Kapitali-----	65
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	68
5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test-----	73
Kutia 5. Vlerësimi i integritetit të menaxhimit të rreziqeve nga ndryshimet klimatike në sektorin bankar -----	81
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	86
6.1 Sektori Pensional-----	86
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	88
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	93
7. Infrastruktura financiare në Kosovë -----	99
7.1. Sistemi i pagesave -----	99
8. Korniza për Makroprudencë -----	101
9. Shtojca Statistikore -----	104

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inputeve bujqësore -----	11
Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	13
Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja -----	14
Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar -----	15
Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar -----	19
Grafik 6. Harta e stabilitetit financiar -----	20
Grafik 7. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje -----	25
Grafik 8. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve -----	26
Grafik 9. Indikatorët e çmimeve në vend -----	27
Grafik 10. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja -----	32
Grafik 11. Borxhi i ndërmarrjeve -----	32
Grafik 12. Normat e interesit për ndërmarrjet -----	33
Grafik 13. Borxhi i ekonomive familjare -----	33
Grafik 14. Depozitat e ekonomive familjare -----	34
Grafik 15. Normat e interesit për ekonomitë familjare -----	34
Grafik 16. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së -----	43
Grafik 17. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar -----	43
Grafik 18. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	44
Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve -----	46
Grafik 20. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	46
Grafik 21. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja -----	47
Grafik 22. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve -----	47
Grafik 23. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët -----	48
Grafik 24. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	48
Grafik 25. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	49
Grafik 26. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë -----	49
Grafik 27. Kreditë a aprovuara dhe të garantuara nga FKGK -----	50
Grafik 28. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	50
Grafik 29. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	50
Grafik 30. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	56
Grafik 31. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	57
Grafik 32. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	58
Grafik 33. Kreditë sipas kalsifikimit të ri kreditor në tri shtylla -----	58
Grafik 34. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	58
Grafik 35. Kreditë joperformuese -----	59
Grafik 36. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	60
Grafik 37. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	60
Grafik 38. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	60
Grafik 39. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	61

Grafik 40. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	61
Grafik 41. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	62
Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	62
Grafik 43. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit-----	62
Grafik 44. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	63
Grafik 45. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	63
Grafik 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	63
Grafik 47. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	64
Grafik 48. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	65
Grafik 49. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj-----	65
Grafik 50. Kapitalizimi i sektorit bankar-----	66
Grafik 51. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	66
Grafik 52. Struktura e kapitalit rregullator-----	66
Grafik 53. Norma e levës -----	67
Grafik 54. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit-----	67
Grafik 55. Asetet e peshuara me rrezik kreditor-----	67
Grafik 56. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut-----	67
Grafik 57. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor -----	68
Grafik 58. Struktura e financimit-----	69
Grafik 59. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	69
Grafik 60. Struktura e depozitave-----	70
Grafik 61. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	70
Grafik 62. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	71
Grafik 63. Indikatorët e likuiditetit -----	71
Grafik 64. Rezervat e likuiditetit -----	72
Grafik 65. Hendeku i likuiditetit -----	73
Grafik 66. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit -----	76
Grafik 67. Rezultatet e stres testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi-----	78
Grafik 68. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 1 -----	79
Grafik 69. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2 -----	80
Grafik 70. Asetet e sektorit pensional-----	86
Grafik 71. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	87
Grafik 72. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale -----	87
Grafik 73. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	88
Grafik 74. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	88
Grafik 75. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve-----	88
Grafik 76. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	89
Grafik 77. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	89
Grafik 78. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve -----	90
Grafik 79. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	90

Grafik 80. Primet bruto të arkëtuara -----	91
Grafik 81. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	92
Grafik 82. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	93
Grafik 83. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	94
Grafik 84. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	94
Grafik 85. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	95
Grafik 86. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare-----	95
Grafik 87. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	95
Grafik 88. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	96
Grafik 89. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	96
Grafik 90. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	96
Grafik 91. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	97
Grafik 92. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	97
Grafik 93. Kapitali shtesë kundër-ciklik -----	102
Grafik 94. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë 1 -----	103
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës-----	45
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës-----	45

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar -----	11
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë -----	23
Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare -----	34
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	44
Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor-----	74
Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve -----	74
Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor -----	76
Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit-----	79
Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit-----	81
Tabela 10. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	91
Tabela 11. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	92
Tabela 12. Rezultati financiar -----	93
Tabela 13. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së-----	99
Tabela 14. Rrjeti i sektorit bankar -----	100
Tabela 15. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela-----	100
Tabela 16. Objektivat, indikatorët vlerësues të rrezikut sistemik dhe instrumentet e politikës makroprudenciale -----	102

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) i prezanton publikut numrin e 19-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, të rrisë transparencën dhe nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Pasiguritë e larta që e karakterizuan ekonominë globale në vitin 2022, nxitur kryesisht nga pasojat e luftës së Ukrainës në dinamikën e çmimeve të energjisë dhe produkteve tjera bazë, si dhe shkallën e lartë të inflacionit që mbizotëroi përgjatë gjithë vitit, iniciuan ndryshimin e politikave të lehtësuara monetare në mënyrë pothuajse të sinkronizuar nga bankat qendrore. Pas 11 vitesh, në korrik 2022, Banka Qendrore Evropiane vendosi që të rris normat e interesit, si masë kundrejt një shkalle në rritje të inflacionit, ndërkohë që aktiviteti ekonomik në eurozonë rezultoi të jetë dobësuar.

Për vitin 2023, rreziqet kryesore për stabilitetin financiar në nivel global vazhdojnë të mbesin tensionet e rritura gjeopolitike, ritmi i ngadalshëm i rënies së inflacionit (inflacioni bazë mbetet i lartë), dhe për pasojë, vazhdimi i shtrëngimit të politikave monetare përmes rritjes së normave të interesit - dinamikë që rrezikon të mbaj eurozonën, vendet e rajonit dhe Kosovën në një ambient me aktivitet të dobësuar ekonomik.

Ngjashëm me dinamikat në ekonominë globale dhe rajonale, ekonomia e Kosovës shënoi ngadalësim të aktivitetit të përgjithshëm. Përkeqësimi i perspektivës ekonomike veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit si pasojë pasigurive të rritura në nivel global dhe eurozonë, inflacionit dhe rënies së besueshmërisë së konsumatorëve, rezultoi në dobësim të kërkesës së përgjithshme në vend.

Pakot e mbështetjes fiskale, rritja e remitancave, rritja e pagave, si dhe rritja e kreditimit ndihmuan në mbështetjen e konsumit të ekonomive familjare, duke kompenzuar pjesërisht rënien e të hyrave reale nga inflacioni. Krahas zbutjes së presioneve inflacioniste në vitin 2023, rikuperimi i aktivitetit ekonomik pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve. Megjithatë, shtrëngimi i kushteve kreditore në eurozonë dhe aktiviteti i dobësuar ekonomik në kushtet e një shkalle të lartë të inflacionit bazë mund të përkeqësohen në rënie të të hyrave të disponueshme në eurozonë dhe për pasojë, të reduktojnë kontributin e lartë e të hyrave nga diaspora.

Megjithë rreziqet e rritura makroekonomike, segmentet përbërëse të sistemit financiar të Kosovës vazhduan rritjen, duke reflektuar qëndrueshmërinë e sistemit. Sektori bankar ka vazhduar të mbështes aktivitetin e përgjithshëm ekonomik përgjatë vitit 2022, vit kur kreditimi rezultoi të ketë shënuar shkallën më të lartë të rritjes në njëmbëdhjetë vitet e fundit. Për vitin 2023, presionet inflacioniste si dhe pasiguritë rreth aktivitetit ekonomik pritet të kenë ndikim në rënien potenciale të kërkesës për kredi dhe shkallën e përgjithshme të ndërmjetësimit financiar.

Rrethanat e tilla të çmimeve të larta, dobësimit të aktivitetit ekonomik, rritjes së normave të interesit në nivel global dhe Kosovë si dhe hapësirës më të kufizuar fiskale të mbështetjes së ekonomisë së Kosovës, rreziku kreditor dhe rreziku i likuiditetit të sektorit bankar janë në rritje dhe do të monitorohen më për së afërmi.

Përderisa ecuria e këtyre zhvillimeve është duke u shoqëruar me pasiguri të larta, sistemi financiar në Kosovë ka adaptuar qasje prudente të operimit përkitazi me rrethanat, si dhe ka krijuar rezerva të kënaqshme të kapitalit dhe likuiditetit për t'u përballuar me rreziqet e rritura të funksionimit të tij në periudhën në vijim.

Bashkim NURBOJA

U. D. i Guvernatorit

2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Viti 2022 u karakterizua me rreziqe të rritura dhe pasiguri të shumta ndaj funksionimit të sistemit financiar, të cilat u nxitën kryesisht nga pasojat e luftës së Ukrainës në dinamikën e çmimeve të energjisë dhe produkteve tjera bazë, si dhe thellimin e kufizimeve në zinxhirët e furnizimit dhe rritjen e inflacionit, të cilat veçse ishin nxitur nga situata pandemike. Përkundër rreziqeve të shtuara, sistemi financiar i Kosovës vazhdoi rritjen, duke reflektuar qëndrueshmëri në të gjithë sektorët e tij përbërës.

Aktiviteti kreditues shënoi ngadalësim të trendit rritës në gjysmën e dytë të vitit, ndikuar nga shtrëngimi i ofertës kreditore si pasojë e perspektivës më pesimiste për zhvillimet në tregun vendor dhe global dhe shtrëngimit të kushteve të financimit. Por, falë performancës ekonomike më të mirë se pritjet për sektorin e ndërmarrjeve, si dhe zhvillimeve pozitive në tregun e punës, rritja e rreziqeve nuk u materializua në performancën e sektorit bankar, i cili vazhdon të ketë rezerva adekuate të kapitalit dhe likuiditetit.

Sidoqoftë, rreziqet ndaj stabilitetit financiar mbesin të larta. Prospektet për rritje më të ngadalshme ekonomike si dhe inflacioni i lartë mund të rëndojnë gjendjen financiare të agjentëve ekonomik (ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare), me reflektim në rritje të rrezikut kreditor në periudhën në vijim. Shtrëngimi i kushteve të financimit, krahas rritjes së vazhdueshme të konkurrencës në vend dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave, rritë gjithashtu ekspozimin ndaj rrezikut të financimit

dhe të likuiditetit, gjë që kërkon monitorim të vëmendshëm.

Rreziqet kryesore për stabilitetin financiar vazhdojnë të burojnë nga faktorët e përkeqësuar makroekonomik, dhe përkundër pritjeve për përmirësim, mbesin të rritura për vitin vijues. Në nivel global, norma e rritjes së aktivitetit ekonomik pothuajse u përgjysmua në vitin 2022, si pasojë e rritjes së tensioneve gjeopolitike dhe efektit të tyre në rritjen e çmimeve të energjisë dhe ushqimit. Fuqia blerëse shënoi rënie dhe kushtet e financimit u përkeqësuan, si rezultat i shtrëngimit pothuajse të sinkronizuar të politikës monetare. Inflacioni i përgjithshëm global rezultoi 8.7 përqind në vitin 2022, dhe inflacioni bazë arriti nivele rekorde në disa ekonomi të zhvilluara në vitin 2023. Vazhdimi i tensioneve gjeopolitike, ritmi i ngadalshëm i rënies së inflacionit si dhe vazhdimi i shtrëngimit të politikave monetare – rritja e normave të interesit – paraqesin burimet e rrezikut për periudhën vijuese, sidomos në rrethanat e krizës së papritur në disa banka rajonale në SHBA dhe Credit Suisse në Zvicër, të cilat përkundër që ishin raste të izoluara, kanë ngritur shqetësimet më të përgjithshme për qëndrueshmërinë e bankave në një mjedis me norma interesi më të larta.

Eurozona* shënoi ngadalësim të rritjes ekonomike nga 5.3 në 3.5 përqind. Si pasojë e normave të larta të inflacionit dhe shtrëngimit të politikës monetare, kushtet financiare në eurozonë shënuan përkeqësim, dinamikë që po vazhdon tutje edhe në vitin 2023 për shkak të presioneve të larta në inflacionin bazë. Vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me ngadalësim edhe më të theksuar të rritjes ekonomike, në 3.8 përqind krahasuar me 8.6 përqind në vitin 2021. Dinamikat e inflacionit në eurozonë u reflektuan në rajonin e Ballkanit Perëndimor relativisht shpejtë, marrë parasysh lidhjet tregtare të rajonit me eurozonën si dhe varësinë nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike. Norma mesatare vjetore e inflacionit në rajon arriti në

* Partneri kryesor tregtar i Kosovës dhe njëkohësisht rajoni me origjinën më të lartë të remitencave dhe të hyrave tjera të diasporës.

11.6 përqind në 2022 me të gjitha vendet, përveç Shqipërisë, që shënuan rritje dyshifrore të inflacionit. Pakot e mbështetjes fiskale, rritja e remitancave, rritja e pagave, si dhe rritja e kreditimit ndihmuan në mbështetjen e konsumit të ekonomive familjare duke kompenzuar pjesërisht rënien e të hyrave reale nga inflacioni. Megjithatë, vazhdimi i inflacionit të lartë në rrethana të ngushtimit të hapësirës fiskale për mbështetje të vazhdueshme, mund të ndikoj negativisht aktivitetin ekonomik, me efekte indirekte negative edhe në zhvillimet në sistemin financiar.

Ekonomia e Kosovës shënoi ngadalësim të aktivitetit, ngjashëm me dinamikat në ekonominë globale dhe rajonale. Fillimi i vitit u karakterizua me rritje të konsumit privat dhe eksporteve, si vazhdimësi e dinamikave pozitive post-pandemike. Sidoqoftë, nga tremujori i dytë kishte ngadalësim në të dy kategoritë si pasojë e përkeqësimit të perspektivës ekonomike nga lufta në Ukrainë, inflacionit dhe rënies së besueshmërisë së konsumatorëve. Rritja e lartë e inflacionit, përkatësisht çmimeve të mallrave të importuara, ndikoi në rritjen e komponentës së importeve, duke dhënë kontribut negativ në rritjen ekonomike, së bashku me komponentën e shpenzimeve publike dhe investimeve. Vlerësimet sugjerojnë se rritja e BPV-së vjetore në 2022 u ngadalësua në 3.55 përqind, nga 10.7 përqind sa ishte në 2021. Sektorët me rritjen më të lartë të vlerës së shtuar ishin sektori i industrisë përpunuese dhe shërbimeve, ndërsa si pasojë e rritjes së kostos së ndërtimit sektori i ndërtimtarisë shënoi rënie të vazhdueshme nga tremujori i dytë deri në fund të vitit. Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave energjetike dhe ushqimore bëri që përshpejtimi i çmimeve të këtyre mallrave në tregjet globale të reflektohet relativisht shpejtë në presione të forta inflacioniste në vend. Norma e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) arriti në 11.6 përqind në 2022 (3.4 përqind në vitin 2021), me çmimet e ushqimit dhe energjisë që ishin nxitësit kryesorë të inflacionit me kontribut prej 6.6 respektivisht 2.9 pikë përqindje në

gjithsej normën e inflacionit. Inflacioni bazë, si indikator i prirjes më afatgjatë të inflacionit, rezultoi në rritje mesatare vjetore prej 4.9 përqind në vitin 2022, me nivelin më të lartë historik të shënuar në dhjetor 2022 prej 6.8 përqind. Rënia e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, e cila ishte më e theksuar në tremujorin e parë të vitit 2023, pritet të ndikoj në rënien e presioneve inflacioniste, krahas lehtësimeve të mëtejshme të pengesave në zinxhirët e furnizimit si dhe efektit të pritshëm të shtrëngimit të politikës monetare në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik – rënien e kërkesës. Megjithatë, rënia në inflacionin bazë pritet të jetë më e ngadalshme, dhe në terma realë, çmimet e ushqimit pritet të mbeten më të larta se në periudhën e para pandemisë, duke u bërë kështu më të kushtueshme veçanërisht për familjet me të hyra të ulëta. Sipas skenarit bazë të parashikimeve aktuale të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit pritet të jetë 4.9 përqind në vitin 2023. Krahas zbutjes së presioneve inflacioniste, pritjet janë për përmirësim të lehtë të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2023, të gjeneruar nga kërkesa e brendshme dhe neto eksportet. Por, pasiguritë janë të larta, dhe anojnë në kahun e efekteve negative. Shtrëngimi i kushteve kreditore në tregjet ndërkombëtare, ngadalësimi i pritur i aktivitetit ekonomik dhe rënia e të hyrave të disponueshme në eurozonë, mund të reduktojnë të hyrat nga diaspora. Rreziqet për tensione gjeopolitike mbesin të larta, dhe implikimet e tyre në politikat e tregtisë, trendin e inflacionit dhe të ardhurat e disponueshme, në kushte të ngushtimit të hapësirës fiskale për mbështetje, mund të rëndojnë tutje fuqinë blerëse dhe besueshmërinë e konsumatorëve.

Pozicioni fiskal shënoi përmirësim gjatë vitit, si rezultat i të hyrave më të larta buxhetore të gjeneruara nga efekti i rritjes së çmimeve dhe rritjes së formalizimit të ekonomisë. Shpenzimet e qeverisë gjithashtu u rritën, ndikuar nga rritja e shpenzimeve për masat mbështetëse fiskale për tejkalimin e krizës energjetike dhe të inflacionit, në kuadër të pakos së Ringjalljes Ekonomike. Por, mungesa e shpenzimeve

kapitale ndikoi që rritja e shpenzimeve të jetë më e ulët se rritja në të hyrat, ndaj dhe pozicioni fiskal u përmirësua. Rrjedhimisht, edhe borxhi publik në raport me BPV-në shënoi rënie. Ngritja e pagave në sektorin publik, pritjet për rritje të investimeve

kapitale publike, rritja e kostos së financimit, si dhe rënia e ngadalshme e inflacionit/nevojat për subvencionim të shtresave më të prekura, mund të shtojnë presionin mbi sektorin fiskal në vitin 2023.

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar

Rreziqet	2020	2021	TM1 2022	TM2 2022	TM3 2022	TM4 2022	Trendi i rrezikut
Rreziqet							
Rreziku makroekonomik	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Red	→
Rreziku kreditor	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	↑
Rreziku në të hyrat (profitabiliteti)	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	→
Qëndrueshmëria e sektorit							
Kapitalizimi	Green	Green	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	→
Likuiditeti dhe financimi	Yellow	Green	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	↓
	Qëndrueshmëri e lartë Q. Mesatare Q. e ulët Q. e shumë e ulët Rrezik i ulët Rrezik i mesëm Rrezik mbimesatar Rrezik i lartë						

Burimi: BQK.


*Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar bazohet pjesërisht në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës (sipas së cilës vlera e treguesve kryesorë përkatës notohet në relacion me historikun e tij), si dhe në vlerësimin e gjykimit të analistëve.

Kahja e shigjetës sugjeron për tendencën e rrezikut/qëndrueshmërisë në periudhën e fundit (tremujorin e fundit), si dhe pritjet për zhvillimet në periudhën vijuese një vjeçare

Përkundër dinamikave pozitive në eksportet e mallrave dhe shërbimeve të Kosovës, të karakterizuara me zgjerim të bazës së eksportit, vendeve partnere si dhe volumit, deficitit i llogarisë rrjedhëse u thellua dukshëm. Kontribuesit kryesorë në zgjerim të deficitit ishin rritja e çmimit të importeve si dhe rënia e bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore. Ndërsa, krahas rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, rritja e shënuar në komponentën e të ardhurave dytësore, përkatësisht remitencave, rezultoi në efekt në zbutjen e ndikimit negativ nga rritja e importeve. Trendi pozitiv i komponentës së neto eksportit të shërbimeve, i cili shënoi rritje rekorde në vitin paraprak, vazhdoi edhe në vitin 2022, i nxitur nga rritja e numrit të vizitave të diasporës dhe shpenzimet e tyre në Kosovë. Me rritje u karakterizua edhe eksporti i shërbimeve kompjuterike, i cili konsiderohet si sektor me potencial të lartë për rritje. Remitencat, të cilat përbëjnë burim të rëndësishëm të financimit me pjesëmarrje prej 13.7 përqind në BPV-në e vendit, shënuan ngadalësim të rritjes nga shkalla rekord e rritjes së vitit të kaluar. Fillimi i vitit shënoi

ngadalësim të lehtë të rritjes së fluksit të remitencave, ndërsa nga gjysma e dytë e vitit, u vërejt fluks i shtuar i remitencave, përkundër sfidave të inflacionit të lartë në vendet me koncentrim të diasporës kosovare, dhe efektit të mundshëm të rrethanave makroekonomike në pozitën financiare të tyre.

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inpueteve bujqësore



Burimi: BQK.

Kontributi i diasporës ishte i lartë edhe në sektorin e investimeve të huaja direkte (IHD-të), përmes blerjes së patundshmërive, të cilat përfaqësuan 67.3 përqind të gjithsej IHD-ve. Sektorët tjerë me kontribut në rritjen vjetore të IHD-vë ishin sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, si dhe sektori i ndërtimitarisë.

Inflacioni i lartë ka ndikuar në rritjen e qarkullimit në ndërmarrjet tregtare, ndërsa vëllimi i prodhimit industrial shënoi rritje të ulët. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare ka vazhduar trendin e rritjes, por që megjithatë ishte më i ngadalshëm në raport me vitin paraprak si reflektim i perspektivës më të dobët të tregut. Vazhdimi i presioneve inflacioniste si dhe rritja e kostos së financimit/servisimit të borxhit rrezikon përkeqësimin e gjendjes financiare, në veçanti për ekonomitë familjare të cilat po përballën me rritje të lartë të çmimeve të produkteve bazë si dhe shërbimeve, në rrethana të kompenzimeve/pagave të pandryshueshme, apo rritjes së ulët.

Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë shënoi rritje prej 9.1 përqind, me rritjen më të lartë në sektorin e tregtisë së karburanteve. Ndërsa, përkundër rritjes së lartë të çmimeve, indeksi i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, shënoi një rritje të vogël prej 0.3 përqind në vitin 2022, që sugjeron për ngadalësim të aktivitetit industrial. Sektori i ndërtimitarisë, përkundër ballafaqimit me rritjen më të lartë të çmimeve të inpueteve, u karakterizua me numrin më të lartë të ndërmarrjeve të reja të regjistruara, ndërsa sektori i tregtisë rezultoi me rënie në numrin e ndërmarrjeve të reja. Inflacioni i lartë dhe kostot më të larta të financimit kanë rënduar në pozicionin financiar si të ndërmarrjeve ashtu edhe të ekonomive familjare. Trendi i emigracionit të punëtorëve dhe mungesa e shkathtësive profesionale gjithashtu kanë rritur koston e punëtorëve, dhe pritjet janë që ky aspekt të përkeqësohet, sidomos pas liberalizimit të vizave në fillim të vitit 2024. Pozicioni financiar i ekonomive familjare vlerësohet të jetë përkeqësuar për shkak të rritjes së lartë të çmimeve, por të dhënat e mangëta pamundësojnë vlerësimin më të saktë të gjendjes. Të dhënat zyrtare të tregut të punës nuk janë në dispozicion përtej TM1 2022, kur është raportuar rënie e papunësisë në 16.6 përqind, apo 9.2 pikë përqindje më e ulët

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Treguesit indirekt si tatimi në të ardhura dhe kontributet pensionale², remitancat, kompenzimi i punëtorëve jashtë vendit si dhe kursimet sugjerojnë për rritje të burimeve të financimit. Por, rritja e lartë e inflacionit përgjatë gjithë vitit 2022 si dhe vazhdimi i rritjes tutje në vitin 2023, pritet të ndikojnë në dobësimin e pozitës financiare të ekonomive familjare, sidomos të pjesës së tyre me të ardhura më të ulëta dhe përfituesit e skemave sociale. Paga mesatare neto rezulton të jetë mesatarisht 446 euro në muaj³, një rritje vjetore prej 14 euro. Rrethanat e reja në kontekst të rritjes së lartë të çmimeve jo vetëm të produkteve bazë por edhe produkteve dhe shërbimeve tjera, sugjerojnë për rënie të fuqisë blerëse, me pasoja potenciale në përkeqësim të kapacitetit ripagues të borxhit dhe rritje të rrezikut kreditor në sektorin bankar. Përderisa ndërmarrjet në përgjithësi bartin efektin e rritjes së çmimeve të konsumatorët, rreziku megjithatë iu kanoset përmes kanalit të rënies së kërkesës dhe presionit për rritje të pagave. Shkalla e bartjes së efekteve të përkeqësimit të pozicionit financiar të sektorit privat në sektorin bankar gjatë vitit 2022 ka qenë e ulët. Sektori i ekonomive familjare - pjesa që posedojnë kredi - është më e koncentruar drejtë punëtorëve me të ardhura në sektorin publik dhe punëmarrësve më stabil. Kjo, së bashku me ndihmat nga remitancat, rritjen e punësimit jashtë vendit dhe rritjen sado të ulët të pagave, mendohet se kanë ulur ndjeshmërinë e sektorit të ekonomive familjare ndaj mos-pagesës së kredive si rezultat i krizës së kostos së jetesës – inflacionit të lartë. Sidoqoftë, zgjatja e presioneve të larta inflacioniste përtej vitit 2022 dhe rritja e normave të interesit – kombinuar potencialisht me një stagflacion në eurozonë në vitin 2023, mund të dobësojnë aftësinë paguese të borxhit me efekte në rritjen më të lartë të rrezikut kreditor.

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik ndikoi që shkalla e ndërmjetësimit financiar të rritet lehtësisht, përkundër ngadalësimit të trendit të rritjes së borxhit. Borxhi i

² [Raporti-i-Punes-Janar-Dhjetor-2022.pdf \(atk-ks.org\)](#)

³ [niveli-i-pagave-ne-kosove-2022.pdf \(rks-gov.net\)](#)


ndërmarrjeve ndaj vlerës së BPV-së arriti në 43.9 përqind, 0.6 pikë përqindje më lartë se vitin paraprak, ndërsa për ekonomitë familjare ky raport arriti në 20.8 përqind, 0.3 pikë përqindje më lartë se vitin paraprak. Borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 15.9 përqind. Struktura e borxhit dominohet nga kreditë ndaj bankave dhe institucioneve mikrofinanciare vendore. Megjithatë, borxhi i jashtëm ka vazhduar trendin e rritjes së pjesëmarrjes, duke arritur në 28.7 përqind të gjithsej borxhit në dhjetor 2022. Pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar në vend u rrit për 14.8 përqind, ndikuar nga rritja më e lartë e vlerës absolute të kredive në raport me depozitat. Në aspekt valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë, por që megjithatë, mbetet i ulët pasi që pjesëmarrja e depozitave në valutë ndaj gjithsej depozitave ishte 3.0 përqind ndërsa kreditë në valutë ndaj gjithsej kredive vetëm 0.4 përqind. Borxhi i ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 16.0 përqind në vitin 2022. Borxhi i jashtëm, i cili ka pjesëmarrje të ulët prej vetëm 2.3 përqind, shënoi rënie vjetore prej 5.9 përqind. Ndërsa borxhi i brendshëm, që përbënë kryesisht kreditë ndaj sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar, shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore në raport me vitin paraprak. Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 2.4 përqind si rezultat i rritjes së depozitave.

Kosto e huamarrjes është rritur sikurse për ndërmarrjet, ashtu edhe për ekonomitë familjare. Rritja e normave të interesit ka ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së kredive me normë variable në 27.2 përqind nga 21.0 përqind në 2021, si mekanizëm për bartjen e rrezikut nga normat e interesit tek huamarrësit, gjë që në rrethanat aktuale të pritjeve për shtrëngim të mëtejme të politikës monetare, rezulton në kosto më të lartë të servisimit të borxhit për huamarrësit.

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar përshpejtoi rritjen, duke shënuar shkallën më të lartë të rritjes në njëmbëdhjetë vitet e

fundit. Kjo dinamikë u ndikua nga zhvillimet në gjysmën e parë të vitit ku kreditii u karakterizua me rritje më të theksuar, përderisa në gjysmën e dytë është shënuar ngadalësim i trendit rritës. Oferta kreditore përgjithësisht është shtrënguar në gjysmën e dytë të vitit, ndikuar nga rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë në tregun vendor dhe tregjet globale. Presionet e vazhdueshme inflacioniste si dhe pasiguritë rreth aktivitetit ekonomik pritet të ndikojnë në rënie të kërkesës për kreditim në vitin 2023, sidomos për ekonomitë familjare.

Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, në milionë euro




Burimi: BQK

Dinamika e aktivitetit kreditues, gjatë pjesës më të madhe të vitit 2022, sipas anketës së kreditimit bankar, u përcaktua kryesisht nga lëvizjet në kërkesën kreditore. Rritja e theksuar e kërkesës kreditore nga ndërmarrjet u nxit nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse, përderisa për ekonomitë familjare, kërkesën për kredi e ndikoi kërkesa për financimin e shpenzimeve të konsumit dhe perspektiva e tregut të patundshmërive. Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 4.35 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.1 përqind, më e larta në 11 vitet e fundit. Segmenti i korporatave ndikoi në rritje, përderisa ekonomitë familjare shënuan ngadalësim të trendit rritës. Kreditë e reja shënuan ngadalësim të theksuar të trendit rritës duke u kthyer në nivelet e rritjes së viteve parapandemike. Vetëm tremujori i parë i vitit u karakterizua me rritje të kredive të reja, ndërsa, pas shpërthimit të luftës në Ukrainë dhe rritjes së presioneve inflacioniste, kishte

ngadalësim, përkatësisht rënie vjetore të kredive të reja, përkatësisht të kredive të reja konsumuese të ekonomive familjare. Kreditë e reja hipotekare ngadalësuan dukshëm trendin e rritjes, pas rritjes mbi 50 përqind në vitin 2021. Rritja më e theksuar e kredive hipotekare në vitet e fundit rezultoi në ndryshimin e strukturës së kredive sipas maturitetit, me ç'rast kreditë afatgjata (mbi 5 vite) dominuan strukturën e gjithsej kredive të sektorit. Në rrethana të pasigurive të larta rreth zhvillimeve ekonomike globale, bankat gjatë vitit 2023 presin efekte negative si në kërkesën për kredi, ashtu edhe në anën e ofertës, e cila kryesisht do të manifestohet përmes shtrëngimit të normës së interesit dhe vigjilencës së shtuar në procedurat e brendshme për analizimin e kërkesave për kredi.

Rritja e normës së interesit si dhe aktivitetit kreditor ndikuan në rritjen e profitit të sektorit, përkundër shpenzimeve më të larta në të gjitha kategoritë e shpenzimeve (të përgjithshme dhe administrative, të interesit si dhe shpenzimet për provizione). Tutje, ambienti me normë të lartë të interesit pritet të ketë efekt pozitiv në margjinën neto të interesit, efekt ky që mund të neutralizohet deri në një masë nga shkalla më e lartë e provizioneve si rezultat i rritjes së rrezikut kreditor.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja



Burimi: BQK.

Profiti i sektori shënoi rritje vjetore prej 19.4 përqind, të ndikuar nga rritja në të gjitha kategoritë e të hyrave. Presionet inflacioniste që filluan qysh nga fundi i vitit 2021 kanë nxitur autoritetet monetare drejtë shtrëngimit të politikave monetare, gjë që ka krijuar


ambient me norma të rritura të interesit, duke u reflektuar kështu në rritjen e të hyrave nga interesi në plasmanet në bankat tjera dhe të hyrave nga interesi në letra me vlerë. Të hyrat nga interesi në kredi kontribuan gjithashtu në rritje, si rezultat më shumë i efektit sasior të rritjes së kreditimit. Në anën tjetër, edhe shpenzimet e interesit shënuan rritje si rezultat i presioneve konkurruese në tërheqjen e depozitave, por në nivel shumë më të ulët se të hyrat nga interesi. Si rezultat, margjina neto e interesit shënoi rritje në 4.6 përqind nga 4.3 përqind në vitin paraprak. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit u rrit në 2.5 përqind, përkatësisht 23.0 përqind nga 2.3 përqind dhe 19.5 përqind një vit më parë. Rritja në nivelin e profitit dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit ishte më e lartë se rënia në vendet e rajonit, duke rritur dallimin mbi mesataren e rajonit që ka sektori bankar i Kosovës. Në periudhën në vijim, dobësimi i aftësisë paguese të klientëve si pasojë e shkallës së inflacionit dhe dobësimit të aktivitetit ekonomik pritet të shoqërohet me rritje të nivelit të provizioneve të projektuara për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë – duke ndikuar kështu në rritje të shpenzimeve dhe eventualisht rënie të hyrave nga interesi i perealizuar. Efektet e shtrëngimit të politikës monetare mund të ndjehen në të dy aspektet e marzhës së profitit të bankave në vend, por me efekt të pritshëm pozitiv në margjinën neto të interesit për shkak të kostos së ulët të financimit nga depozitat. Sidoqoftë ekziston rreziku që presionet konkurruese të shtyjnë banka të caktuara që të mos e rrisin normën e interesit në kredi në nivelin e normës ndërbankare në përpjekje për të mbajtur klientët dhe për të mos rrezikuar aftësinë ripaguese, ndërsa në anën tjetër, kostot e financimit të tyre mund të rriten në përmasa më të larta për shkak të aplikimit të normave të rritura nga institucionet financuese dhe rritjes së normave në depozita.

Aktiviteti kreditor i rritur ndikoi që treguesi kyç i cilësisë së portofolios kreditorë, përkatësisht raporti i kredive-jo-performuese ndaj gjithsej kredive të bie tutje. Përkundër nivelit të ulët të këtij treguesi, pasiguritë e shtuara nga ecuria e nivelit të çmimeve dhe rritja e vlerës së

kredive jo-performuese në fund të vitit 2022 e vendosin rrezikun kreditor si rrezikun më eminent të sektorit bankar dhe stabilitetit financiar. Norma e KJP-ve vazhdoi trendin rënës prej vitit 2021, edhe pas përfundimit të fazës së fundit të ristrukturimeve për zbutjen e efekteve të pandemisë në janar-shkurt të vitit 2022. Në dhjetor 2022, ky tregues zbriti në 2.0 përqind nga 2.3 përqind një vit më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit, ngase vlera e KJP-ve u rrit për 4.5 përqind në 87.9 milionë euro, si rezultat i zhvillimeve në tremujorin e fundit të vitit. Rimëkëmbja e shpejtë ekonomike në vitin 2021 dhe performanca e mirë financiare e ndërmarrjeve edhe përgjatë pjesës më të madhe të vitit 2022 ndikuan që materializimi i rreziqeve të shtuara nga çmimet e larta të mos reflektohet në përkeqësim të performancës së pagesës. Faktorë tjerë që ndikuan në neutralizimin e rreziqeve të shtuara nga ambienti makroekonomik dhe rritja e çmimeve ishin aftësia e bartjes së kostos së lartë nga ndërmarrjet të konsumatori final. Ndërsa sa i përket segmentit të ekonomive familjare, faktorët me efekt neutralizues ishin rritja e remitencave, ndihmat fiskale, rritja e pagave, ekspozimi ndaj ekonomive familjare me paga në sektor publik dhe ata me burime më të qëndrueshme të financimit, si dhe shkalla relativisht e ulët e ndërmjetësimit financiar të sektorit. Por, rritja e vazhdueshme e çmimeve me efekt në rritje të lartë të inflacionit bazë, rritja e tarifave të energjisë në vend, dhe pasiguritë rreth aktivitetit ekonomik pritet të thellojnë krizën e kostos së jetesës me efekte potenciale në kapacitetin ripagues të ekonomive familjare, në kushtet e rritjes më të lartë të borxhit në këto vitet e fundit. Sektori i ndërmarrjeve, shtesë rrezikut të rënies së kërkesës së përgjithshme, po ballafaqohet me sfidën e mungesës së punëtorëve dhe hendekun në shkathtësi, sfidë kjo që pritet të thellohet tutje në vitin 2024 kur pritet të filloj zbatimi i masës së lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës në shtetet e shengenit. Rritja e migrimit që pritet të pasojë liberalizimin e vizave paraqet sfidë për funksionimin e ndërmarrjeve, veçanërisht sektorin e ndërtimit dhe prodhimit,

me efekte potenciale negative në performancën e tyre financiare dhe për pasojë, kapacitetin e tyre ripagues.

Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit zbriti si rezultat i rritjes së lartë të aseteve me peshë rreziku, përkatësisht kreditimit. Megjithatë, niveli i kapitalit qëndron mbi nivelet minimale rregullative. Bankat me rëndësi sistemike rezultojnë me normë më të lartë të kapitalizimit dhe në nivel sektori, varianca midis raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie, përkatësisht për afrim ndaj mesatares së sektorit. Norma e kapitalit rregullativ zbriti në 15.5 përqind, nga 16.4 përqind në vitin e kaluar. Por rritja e kapitalit nga bankat më të vogla të cilat kishin nivel më të ulët të normës së kapitalizimit reflekton zhvillim pozitiv në aspekt të rritjes së kapacitetit absorbues. Pozita e kapitalizimit të sektorit reflektohet të jetë në nivel adekuat edhe nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj aseteve të peshuara me rrezik, si dhe leva financiare, të cilët qëndruan në 13.5 përqind, respektivisht 9.3 përqind. Sidoqoftë, rritja e konkurrencës dhe rritja më e shpejtë nga banka të caktuara shton nevojën për vlerësim të pozitës së kapitalit dhe nivelit të provizionimit, veçanërisht marrë për bazë rrethanat e funksionimit në ambient me rreziqe të shtuara ndaj stabilitetit financiar. Analiza stres test sugjeron që sektori në përgjithësi do të ishte në gjendje për përballimin e humbjeve të mundshme në dy nga tre skenarët e dizajnuar të zhvillimeve makroekonomike (skenarin bazë

si dhe skenarin e moderuar). Ndërsa, në skenarin e rënduar me rënie ekonomike në nivel të rënies së përjetuar gjatë pandemisë (i cili sipas definicionit është i mundshëm, por ka probabilitet shumë të ulët të ndodhjes), përkatësisht rënies ekonomike prej 5.6 përqind, sektori do të ballafaqohet me probleme në pozitën e tij kapitale.

Likuiditeti i akumuluar i bankave ndër vite si dhe vazhdimi i rritjes së depozitave të sektorit privat, përkundër përballjes me krizën e inflacionit, mundësoi financimin e aktivitetit të shtuar kreditor edhe në vitin 2022. Treguesit kryesorë të likuiditetit, përkundër rënies, qëndruan mbi nivelet minimale rregullative, duke ruajtur pozitën e qëndrueshme të likuiditetit të sektorit. Megjithatë, ndryshimi i politikës monetare nga ECB dhe rritja e normave të interesit është përkthyer në presione të rritura konkurruese për sigurim të financimit të qëndrueshëm. Tutje, rritja më e dobët ekonomike në eurozonë dhe në ekonominë vendore, dhe presionet ende evidente inflacioniste, mund të reflektohen në dobësim të kapacitetit kursyes të diasporës me reflektim edhe në kursimet në vend. Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në zbriti në 36.5 përqind krahasuar me 37.2 përqind në vitin 2021. Raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshinë vetëm asetet shumë likuide (paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet afatshkurtra zbriti po ashtu në 29.3 përqind nga 30.4 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve kundrejt aseteve likuide. Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 49.2 përqind. Shtrëngimi i politikës monetare në nivel global është reflektuar menjëherë në rritjen e kostos së financimit për sektorin bankar në Kosovë, si nga burimet e jashtme ashtu edhe nga depozitat vendore. Përgjatë gjysmës së dytë të vitit, afatizimi i depozitave ka marrë përmasa më atraktive nga normat më të larta të ofruara në treg nën presionet e konkurrencës për mbajtjen e depozitorëve. Trendi tashmë i ngadalësuar i

rritjes së depozitave të ekonomive familjare mund të ngadalësohet tutje në rrethanat e vazhdimësisë së inflacionit të lartë dhe rënies së aktivitetit ekonomik, gjë që do të shtojë presionin në financimin e sektorit bankar dhe pozitën e likuiditetit, si në aspekt të mirëmbajtës së nivelit të depozitave ashtu edhe në aspekt të kostos për mirëmbajtjen e tyre. Nga viti 2023, sektori bankar do të fillojë raportimin e dy treguesve kyç të likuiditetit dhe financimit në kuadër të Basel III, Raportin e Mbulimit me Likuiditet (LCR) dhe Raportin neto të Financimit të Qëndrueshëm (NSFR), të cilët do të ofrojnë bazë të informacioneve të vlefshme për vlerësimin e aftësisë së sektorit për të përballuar goditjet e likuiditetit dhe për të mbajtur burime të qëndrueshme të financimit.

Sektori pensional në vitin 2022 shënoi rritje dukshëm më të ngadalësuar kundrejt vitit paraprak, si pasojë e luhatjeve të mëdha në tregjet financiare ndërkombëtare të ndikuar nga tensionet gjeopolitike dhe presionet inflacioniste, të cilat u reflektuan në kthim negativ nga investimet për sektorin. Në tremujorin e katërt të vitit u evidentua një normalizim në tregjet globale, që mund të jetë indikacion për zbutje të rreziqeve ndaj performancës së sektorit pensional. Vlera e aseteve të sektorit arriti në 2.42 miliardë euro në fund të vitit 2022, që përkon me një rritje vjetore prej 2.4 përqind nga 18.2 përqind në vitin 2021. Sektori mbylli vitin me kthim negativ në vlerë prej 118.9 milionë euro, për dallim nga kthimi rekord prej 228.4 milionë euro në vitin paraprak. Arkëtimet e reja prej kontribut-dhënësve ekzistues por dhe atyre të rinj përshpejtuan rritjen në 13.1 përqind nga 9.8 përqind në vitin paraprak, mbështetur nga rritja e pagave dhe shkallës së punësimit, ashtu edhe nga përpjekjet për të stimuluar formalizimin e sektorit privat. Në tremujorin e katërt të vitit, konform tendencave për normalizim në tregjet globale, kthimet e sektorit pensional të Kosovës ishin pozitive. Megjithëse viti 2023 po vazhdon të karakterizohet me pasiguri ende të larta, në përgjithësi pritjet janë për vit më të favorshëm për ekonominë globale edhe tregjet financiare,

kryesisht si rezultat i normalizimit deri në një masë të disa çmimeve në bursë, zvogëlimit të hendekut kërkesë/ofertë dhe zbutjes së tensioneve gjeo-politike në nivel global.

Sektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aseteve të mbështetur nga rritja e primeve. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara u përmirësua, si rezultat i rritjes më të lartë të primeve të arkëtuara në raport me dëmet e paguara. Fitimi neto i sektorit ishte më i ulët se viti paraprak si rezultat i rritjes së shpenzimeve të nxitura nga presionet inflacioniste. Sidoqoftë, ky vit shënon vitin e tretë më radhë që sektori operon me fitim, duke kontribuar tutje në zvogëlim të humbjeve të bartura nga vitet e kaluara. Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit shënoi rritje vjetore prej 14.1 përqind, me rritje më të theksuar të kategorisë së sigurimeve shëndetësore. Dëmet e paguara, përfshirë dëmet e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje për 5.4 përqind. Raporti dëme/prime zbriti për 4.0 përqind në 48.0 përqind. Sektori e mbylli vitin me rezultat pozitiv financiar prej 2.1 milionë euro, krahasuar me 6.3 milionë euro vitin e kaluar, si rrjedhojë e rritjes së kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve, si dhe shpenzimeve administrative, përkatësisht kompensimit për punëtor, zhvillime këto të nxitura presionet e larta inflacioniste që e karakterizuan vitin 2022. Në nivel të sektorit, gjatë vitit 2022 kishte rënie të lehtë në treguesit e likuiditetit, si dhe ngadalësim të rritjes së kapitalit si rezultat i profitit më të ulët gjatë vitit.

Sektori mikrofinanciar vazhdoi rritjen e përshpejtuar, të ndikuar nga zgjerimi i aktivitetit kreditor dhe të lizingjeve. Fitimi i sektorit tejkaloi nivelin e vitit të kaluar duke shënuar rekord historik. Meqenëse burimi i financimit të sektorit janë huatë e marra jashtë vendit, në periudhën në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen tutje të kostos së financimit, me efekt potencial në rritjen e normës së interesit për kreditë. Huazimet nga sektori i jashtëm, që paraqesin 61.1 përqind

të detyrimeve dhe kapitalit të sektorit, u rikuperuan plotësisht nga viti kritik pandemik, duke shënuar rritje vjetore prej 12.1 përqind (rritje për 2.2 përqind në vitin 2021). Kreditimi si për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare shënoi rritje të theksuar në vitin 2022 (16.6 përqind, respektivisht 26.9 përqind). Të gjithë sektorët ekonomik u karakterizuan me rritje të kreditimit, ndër të cilët rritjen e dytë më të lartë e kishte sektori i bujqësisë, i cili ka peshën më të madhe në portfolion e kredive ndaj korporatave jofinanciare. Rritja e kreditimit për bujqësinë u mbështet nga garancia e ofruar nga FKGK për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të, e cila ishte për 23.9 përqind më e lartë se shumica e garancive në vitin paraprak. Normat e interesit, në mesatare shënuan rënie të lehtë vjetore në 18.6 përqind nga 19.4 përqind një vit më parë, përkundër rritjes së normave të interesit bazë në nivel global. Sektori realizoi fitimin më të lartë vjetor që nga fillimi i operimit të tij, në vlerë prej 17.2 milionë euro, si rezultat i rritjes më të lartë të hyrave në raport me shpenzimet. Të gjitha kategoritë e të hyrave shënuan rritje, por rritja e lartë e aktivitetit kreditues ishte kontribuuesi kryesor në rritjen e të hyrave në përgjithësi. Në kuadër të shpenzimeve kishte gjithashtu rritje në të gjitha kategoritë, të nxitura nga rritja e kostos së operimit si rezultat i inflacionit të lartë, si dhe rritja e financimit nga jashtë. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Në të njëjtën kohë, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u rritë në 153.2 përqind nga 141.6 përqind.

Rritja e vazhdueshme e inovacionit dhe digjitalizimit të sistemeve të pagesave ndikoi në zvogëlimin e kostos së transfereve, duke ndikuar në rënien e të hyrave nga transferet për ndihmësit financiar, përkundër rritjes vjetore të volumit të remitencave të dërguara përmes këtyre agjencioneve. Burimet tjera të të hyrave të ndihmësve financiar shënuan rritje, por rritja më e lartë e shpenzimeve ndikoi në fitim më të ulët të këtij sektori në raport me vitin paraprak. Ky sektor, me

peshë të ulët prej vetëm 0.4 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP), të cilat burim kryesorë të t'hyrave kanë të hyrat nga transferet, me pjesëmarrje prej 59.3 përqind në dhjetor 2022. Asetet e sektorit shënuan rritje vjetore më të lartë, prej 45.1 përqind, të ndikuar kryesisht nga ndërrimet metodike në kategorizimin e këtyre institucioneve.⁴ Sektori mbylli vitin me fitim neto prej 2.9 milionë euro, përkatësisht 11.5 përqind më të ulët se viti paraprak.

Mbikëqyrja makroprudenciale e sektorit financiar nga BQK ka vazhduar, krahas vazhdimit të përpjekjeve për ngritje të kapaciteteve për monitorim dhe vlerësim si dhe ngushtimit të hendekut të të dhënave për vlerësim më kualitativ të rrezikut sistemik. Komiteti këshillëdhënës për makroprudencë, si trupë e brendshme e BQK-së, ka mbajtur takimet e rregullta tremujore, duke shqyrtuar tregues të përzgjedhur për vlerësimin e rrezikut sistemik, të cilët në përgjithësi në vitin 2022 kanë sugjeruar për stabilitet të sektorit përkundër funksionimit në ambient me rreziqe të rritura. Vlerësimi i rrezikut sistemik, ndër tjera, është subjekt i mungesës së theksuar të dhënave, dhe përpjekjet për mbylljen e hendekut të të dhënave kanë vazhduar. Në këtë aspekt, është pranuar asistencë teknike nga FMN e cila krahas udhëzimeve për ngritjen e kapaciteteve për makro stresstest, ka udhëzuar për krijimin e një databaze të veçantë për qëllime të vlerësimit të rrezikut sistemik. Njëherit BQK ka pranuar asistencë teknike në ngritjen e kapaciteteve për makromodelim, si dhe me ndihmën e FMN-së, është iniciuar nisma kombëtare për krijimin e databazës së çmimeve të patundshmërive në Kosovë.

Infrastruktura financiare ka vazhduar avancimin. Iniciativat për digjitalizim kanë vazhduar me ritëm të intensifikuar

qysh prej nxitjes nga kriza pandemike. Krahas përfitimeve që po sjellë digjitalizimi, ka ndikuar gjithashtu në rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut operacional/kibernetik, që ka shtuar nevojën për investim në mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku. Sistemi i pagesave ka vazhduar operimin pa ndërprerje përkundër rritjes së rreziqeve, duke ofruar sigurinë, efikasitetin dhe fleksibilitetin e duhur për pjesëmarrësit, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe identifikimit dhe adresimit të hershëm të problemeve të mundshme. Trendi i shpejtë i zhvillimit të infrastrukturës virtuale, i cili morri hov nga rrethanat pandemike, ka vazhduar. Bankat kanë rritur përpjekjet e përgjithshme për digjitalizim dhe automatizim të shërbimeve, në funksion të rritjes së efikasitetit dhe konkurrentshmërisë. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', janë rritur për 28.1 përqind krahas vitit paraprak. Infrastruktura bankare ka vazhduar zgjerimin edhe në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve dhe numrit të pajisjeve për pagesë përmes kartelave – POS. Tutje, zhvillimet e hovshme të inteligjencës artificiale pas revolucionit të vitit 2022 me zbulimin e chatbotëve, pritet të kenë implikime edhe në funksionimin e sektorit financiar. Përdorimi i inteligjencës artificiale do të mundësojë përfitime të shumta në aspekt të automatizimit të proceseve dhe zvogëlimit të kostos, si dhe në shumë dimensione tjera si përmirësimi i përvojës së klientëve, vlerësimin e rrezikut, etj. Njëkohësisht, rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara dhe inteligjencës ka rritë njëkohësisht edhe sfidat dhe rreziqet e funksionimit si dhe shkallën e sulmeve të mundshme kibernetike, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut operacional si dhe nevojën për mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku.

⁴ Një institucion me pjesëmarrje më të lartë të kapitalit dhe asetëve është rikategorizuar nga kategoria e mikrofinancave në atë të

ndërmjetësve financiar, si dhe një institucion tjetër, me pjesëmarrje më të ulët të kapitalit dhe asetëve ka kaluar nga kategoria e ndërmjetësve në atë të mikrofinancave.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar⁵

Harta e stabilitetit financiar⁶ paraqet zhvillimet në treguesit kryesorë të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës (grafik 4). Në vitin 2022 u vërejtën ndryshime të ndjeshme në rrezikun ndaj stabilitetit financiar, përkatësisht rritje e rrezikut në pothuajse të gjitha dimensionet e rrezikut, si rezultat i pasojave të luftës së Ukrainës dhe krizës pandemike në rritjen e çmimeve, si dhe ndikimit të tyre - së bashku me masat e shtrënguara të politikës monetare - në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik.


Treguesit e ekonomisë së brendshme dhe të jashtme u karakterizuan me rritje rreziku, pasuar gjithashtu nga veprimtaria e agentëve ekonomik si ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Rritje e rrezikut u reflektua edhe nga treguesi i Kapitalizimit dhe profitabilitetit, si dhe Likuiditetit dhe financimit, ku njëherit ky i fundit ishte treguesi me rritjen më të theksuar. Treguesit si Qeveria dhe Struktura e sektorit bankar shfaqen rënie të lehtë të notës së rrezikut. Dy nga treguesit që patën rritjen më të theksuar gjatë vitit, Likuiditeti dhe Financimi, si dhe Ekonomia e Brendshme, tejkaluan gjithashtu nivelin e notës mesatare historike të rrezikut (grafik 5).⁷

Dinamikat në nëntreguesit e **ekonomisë së jashtme** për vitin 2022 sugjerojnë për rritjen më të theksuar të rrezikut në nëntreguesin e normës së rritjes ekonomike të partnerëve kryesorë tregtar të Kosovës, te cilët u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ekonomike. Rënia e sentimentit të ndërmarrjeve si dhe rritja e normave të interesit si rezultat i ndryshimit të politikës monetare kontribuan gjithashtu me rritje rreziku. Ndërsa treguesi i çmimeve të naftës u karakterizua me rënie rreziku në raport me vitin 2021 kur rritja e çmimeve kishte arritur kulmin. Treguesi i papunësisë gjithashtu kontriboi me rënie rreziku, meqë dinamikat negative në sektorin real dhe politika e shtrënguar monetare nuk u reflektuan gjatë vitit në tregun e punës në vendet evropiane me koncentrimin më të lartë të diasporsës kosovare. Tutje në vitin 2023, pritjet janë që rreziqet nga sektori i jashtëm të vazhdojnë të jetë të larta, me mundësi përkeqësimi.

Rreziku nga **ekonomia e brendshme** shënoi rritje më të theksuar, duke reflektuar ndikimin e

ngadalësimit të rritjes ekonomike në vend si dhe rritjen e vazhdueshme të çmimeve të konsumit. Zgjerimi i borxhit të jashtëm si dhe deficitit të llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në kontribuan gjithashtu në rritjen e rrezikut, por në nivel më të ulët. Kontribut pozitiv në notën e rrezikut kishte vetëm forcimi i valutës euro në raport me valutat e partnerëve tregtarë. Ecuria e nëntreguesve për vitin 2023, si dhe pritjet për rritje më të ngadalësuar ekonomike, sugjeron për vazhdimësi të rrezikut më të lartë nga ekonomia e brendshme.

Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Sektori i ndërmarrjeve shënoi rritje rreziku, si rezultat i ecurisë rënëse në indekset e qarkullimit në sektorët kryesorë me peshën më të madhe në ekonominë e vendit. Përkatësisht, indeksi i qarkullimit industrial, indeksi i qarkullimit në sektorin e shërbimeve, si dhe vlera e shtuar në BPV nga sektori i tregtisë shënuan rënie. Me kontribut pozitiv u karakterizuan nëntreguesi i hendekut të kreditimit si rezultat i ngadalësimit të trendit të kreditimit krahas ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, që rezultoi në ngushtim të letë të hendekut pozitiv të kredisë në raport me BPV-në. Gjithashtu nëntreguesi i cilësisë së portfolios kreditore kishte kontribut pozitiv, si rezultat i përmirësimit të normës së kredive joperformuese në raport me kreditimin e ndërmarrjeve. Sidoqoftë, për vitin 2023, pritjet janë për ngadalësim të trendit të kreditimit si dhe përkeqësim të cilësisë së portfolios, si reflektim i vazhdimësisë së rreziqeve të larta nga sektori real, përkatësisht përkeqësimit të aktivitetit ekonomik dhe rritjes së çmimeve, me reflektim potencial në rritje të rrezikut nga ndërmarrjet.

⁵ Kalkulimi i treguesve bazohet në vlerën e BPV-së deri në muajin mars 2021, dhe nuk përfshinë revidimin e fundit të BPV-së në prill 2021.

⁶ Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton

rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.


⁷ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

Rreziku nga **ekonomitë familjare** shënoi rritje më të lehtë, i ndikuar krejtësisht nga ngadalësimi i trendit të rritjes së dërgesave të emigrantëve. Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së shënoi rënie rreziku si rezultat i ngadalësimit të trendit të rritjes së ekonomive familjare. Cilësia e portfolios kreditore kontribuoi gjithashtu me rënie, për shkak se rreziqet e rritura nuk u reflektuan në rritje të kredive joperformuese. Ndërsa, informatat për nëntreguesit tjerë të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut të ekonomive familjare, siç janë tregu i punës/papunësia dhe përballueshmëria e shpenzimeve, ishin të mangëta edhe për vitin 2022. Ecuria e inflacionit të lartë që po karakterizon edhe muajtë e parë të vitit 2023 paraqet rrezik të shtuar për aktivitetin e sektorit privat dhe gjendjen financiare të ekonomive familjare, ndaj dhe pritjet janë për përkeqësim të pozicionit financiar të ekonomive familjare për vitin 2023. Rreziku nga **sektori qeveritar** shënoi rënie të lehtë, si rezultat i rënies së notës së rrezikut në tre nëntregues: primin e rrezikut sovran, bilancin buxhetor në raport me BPV-në si dhe madhësinë e borxhit publik. Shtërngimi i politikës monetare ka ndikuar në rritjen më të theksuar të normës së interesis në bonot e thesarit të qeverisë gjermane, në krahasim me ato të qeverisë së Kosovës të cilat pësuan rritje më të ulët të normës, duke u reflektuar kështu në ngushtim të dallimit, përkatësisht rënie të primit të rrezikut sovran. Rënia në dy nëntreguesit tjerë ishte si rezultat i ngadalësimit të rritjes së borxhit publik dhe rënies së shpenzimeve buxhetore, përkatësisht bilancit pozitiv buxhetor në raport me BPV-në. Kosto e borxhit shënoi rritje rreziku si rezultat i rritjes së normave të interesit dhe kontribuoi me rritje të normës së rrezikut. Nëntreguesi i të ardhurave tatimore gjithashtu shënoi rritje të notës së rrezikut, për shkak të ngadalësimit të trendit të rritjes në krahasim me vitin paraprak kur të ardhurat tatimore kishin arritur në nivelin më të lartë historik. Sa i përket vitit 2023, shtërngimi i politikës monetare në nivel global pritët të ndikoj në rritjen e kostos së borxhit. Ngadalësimi i rritjes ekonomike mund të ndikoj në nivel më të ulët të të ardhurave tatimore, si dhe në rritje të shpenzimeve publike për stimulim të aktivitetit ekonomik, me efekt potencial në rritjen e notës së rrezikut nga sektori qeveritar.

Në kuadër të treguesve të brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit, **treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit** u karakterizua me rritje të përgjishme të rrezikut, por me dinamika

të ndryshueshme në kuadër të nëntreguesve të tij. Rezerva e kapitalit, përkatësisht diferenca e normës së kapitalizimit dhe minimumit të kërkuar me rregullore u zvogëlua në raport me vitin paraprak, duke dhënë kontributin kryesorë në rritjen e notës së rrezikut.

Grafik 6. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Raporti i ekuitet ndaj aseteve të sektorit gjithashtu shënoi rënie, dhe së bashku me rritjen e ekspozimeve të mëdha në raport me kapitalin e klasit të parë, ndikuan në rritje rreziku. Nëntreguesit me kontribut në zbutjen e rrezikut ishin rënia e raportit të kredive joperformuese, rritja e të hyrave nga interesi, si dhe rritja e profitit.

Treguesi i likuiditetit dhe financimit të sektorit shënoi rritjen më të lartë të rrezikut, të ndikuar nga rritja e notës së rrezikut në të gjithë nëntreguesit. Dinamika e rritjes më të lartë të kreditimit dhe ngadalësimit të rritjes së depozitave, përkatësisht depozitave të ekonomive familjare, ishte faktori kryesor që ndikoi në rritjen e raportit kredi/depozita si dhe rënien e raportit të likuiditetit, duke u reflektuar me notë më të lartë rreziku nga këta nëntregues që njëherit kishin peshën më të lartë në rritjen e përgjithshme të rrezikut. Hendeku i likuiditetit për periudhën 3 mujore gjithashtu u zgjerua, si rezultat i rritjes së maturitetit të depozitave, përkatësisht rritjes së depozitave të afatizuara si rezultat i normës më të lartë të interesit. Rritja e lartë e notës mesatare të rrezikut të treguesit të likuiditetit dhe financimit në vitin 2022 zgjeroi përsëri devijimin mbi nivelin e mesatares historike që ky tregues e kishte ndër vite, i cili në masë të madhe reflekton natyrën e komponentëve të përfshirë në tregues.⁸

Struktura e sektorit bankar shënoi rënie rreziku, pas rritjes në vitin e kaluar që ishte përjashtim nga trendi i përmirësimit/rënies graduale të rrezikut që e

⁸ Treguesi i normës kredi/depozita ka përcjellë trend natyreshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit, dhe periudhat e fundit reflektojnë raport më të lartë (notë më të lartë rreziku). Ngjashëm, trendi i normës

së rritjes së depozitave të ekonomive familjare është karakterizuar me fluktuime të theksuara përgjatë viteve, duke qenë më i lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyreshëm ka filluar të bie si rezultat i zhvillimit të sektorit, por që përsëri është rritur në periudhën e fundit.

karakterizoi ndër vite. Nëntreguesi me peshën më të madhe në rënien e rrezikut ishte ai i devijimit negativ të normës së kapitalizimit ndaj normës mesatare të kapitalizimit, i cili u karakterizua me përmirësim, përkatësisht ngushtim të devijimit të bankave individuale ndaj mesatares së kapitalizimit të sektorit. Ky zhvillim u ndikua si nga rënia e normës mesatare të kapitalizimit të ndikuar nga bankat më të mëdha, ashtu edhe nga përmirësimi i pozicionit të kapitalit nga disa banka më të vogla që kishin normën nën mesataren e sektorit.

Nëntreguesi i përgjithshëm i konkurrencës, përkatësisht asetet e 3 bankave më të mëdha ndaj aseteve të sektorit, shënoi përmirësim duke kontribuar në ulje rreziku. Me zhvillime pozitive u karakterizuan edhe nëntreguesi i divesifikimit të porfolios së kredive të bizneseve. Ndërsa, nëntreguesit që pësuan rritje të rrezikut ishin rënia e shkallës së divesifikimit të portfolios së kredisë së bankave ndaj asaj të tregut si dhe diversifikimit të burimeve të financimit të bankave.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Aktiviteti ekonomik global u karakterizua me ngadalësim në vitin 2022, pas përkeqësimit të perspektivës ekonomike globale si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare dhe rënies rezultuese të fuqisë blerëse, rritjes së pasigurive rreth tensioneve gjeopolitike, si dhe normalizimit pothuajse të sinkronizuar të politikës monetare. Sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), aktiviteti ekonomik global u ngadalësua në 3.4 përqind në vitin 2022, nga 6.3 përqind në 2021. Në afatin e shkurtër, rënia e çmimeve të energjisë, rihapja e ekonomisë së Kinës, reduktimi i kufizimeve në ofertë dhe tregjet e forta të punës në ekonomitë e zhvilluara pritet të ndikojnë pozitivisht në ekonominë globale. Megjithatë, shtrëngimi i politikës monetare krahas normave të larta të inflacionit dhe rreziqeve tjera që minojnë perspektivën e ekonomisë globale pritet të ngadalësojnë aktivitetin ekonomik tutje në 2.8 përqind në 2023.

Inflacioni i përgjithshëm global që rezultoi 8.7 përqind në vitin 2022, ndoqi trend rënës por me ritëm të ngadalshëm. Në tregjet ndërkombëtare, çmimet e ushqimit pritet të lehtësohen në 2023 dhe 2024 bazuar në mbarëvajtjen e eksportit të grurit dhe drithërave nga Ukraina. Megjithatë, në terma realë, çmimet e ushqimit pritet të mbeten më të larta sesa para pandemisë, duke i bërë ato më të kushtueshme, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare ishte më e fortë në tremujorin e parë të vitit 2023, dhe pritet të zbehet tutje si rrjedhojë e stabilizimit të çmimeve të energjisë. Sidoqoftë, efekti indirekt i rënies së çmimeve të energjisë në çmimet e mallrave tjera në tregjet globale pritet të jetë më i ngadalshëm. Rrjedhimisht, presionet e inflacionit bazë vazhdojnë të jenë të forta me inflacionin bazë që arriti nivele rekorde në disa ekonomi të zhvilluara në vitin 2023. Përgjatë vitit 2023, inflacioni pritet të ngadalësohet mbështetur nga lehtësimi i pengesave në zinxhirët e furnizimit, rënia e

çmimeve të energjisë, si dhe ngadalësimi i kërkesës së përgjithshme si pasojë e politikave të shtrënguara monetare dhe rritjes së kostos së financimit. Sidoqoftë, si pasojë e tregjeve të shtrënguara të punës dhe rritjes së lartë të pagave në ekonomitë e zhvilluara, presionet inflacioniste përkundër ngadalësimit pritet të mbeten të larta, ku sipas projeksioneve të FMN-së, norma mesatare e inflacionit global në vitin 2023 pritet të jetë 7.0 përqind, për t'u ngadalësuar më pas në 4.9 përqind në 2024.

Në zbatim të mandatit të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, bankat qendrore me regjim të targetimit të inflacionit ndërmorrën masa shtrënguese monetare përmes shtrëngimit sasior dhe rritjes së normave të interesit, që u reflektuan në shtrëngim të kushteve të kreditimit dhe rrjedhimisht ngadalësim të kreditimit dhe kërkesës së përgjithshme. Për më shumë, edhe hapësira për mbështetje fiskale rezultoi të jetë zvogëluar në nivel global si rrjedhojë e niveleve të larta të borxhit publik (të trashëguar dhe akumuluar si pasojë e përballjes me krizën shëndetsore pandemike), dhe rritjes së kostos së financimit të borxhit publik pas rritjes së normave të interesit. Këto dinamika parashihet të rëndojnë tutje mbi fuqinë blerëse, veçanërisht të ekonomive familjare me të ardhura më të ulëta me ndërprerjen e masave mbështetëse fiskale.

Përderisa rreziqet nga ambienti makroekonomik pritet të vazhdojnë të minojnë perspektivën e ekonomisë globale, rritja e rreziqeve që burojnë nga sistemi financiar me vështirësitë dhe dështimin e disa bankave rajonale në SHBA dhe Credit Suisse në Zvicër ndikoi në rritjen e shqetësimeve për amplifikim të mundshëm të një krize më të gjerë financiare. Përkundër kësaj, si pasojë e frenimit të ngadalshëm të inflacionit, Rezerva Federale, Banka Qendrore Evropiane, Banka Qendrore e Anglisë, si dhe banka tjera qendrore me peshë në sistemin financiar global vazhduan rritjen e normave të interesit për frenimin e inflacionit drejt targetit prej 2.0 përqind. Për më shumë, bazuar në sinjale të paqarta nga dinamikat në tregun e punës si dhe marrjen e vendimeve të politikave monetare bazuar në të dhëna, mbetet e paqartë se kur mund të pritet ndërprerje e

rritjes së normave të interesit dhe sfidë në rritje paraqet kohëzgjatja e duhur e normave të ngritura të interesit për të frenuar inflacionin duke shmangur tkurrjen e aktivitetit ekonomik.

Ekonomia e Eurozonës dhe Ballkanit

Perëndimor

Pas rritjes së fortë ekonomike prej 5.3 përqind në 2021, aktiviteti ekonomik në eurozonë shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.5 përqind në vitin 2022. Kjo ndodhi si pasojë e përsheptimit të inflacionit dhe pasojave negative në fuqinë blerëse dhe besueshmërinë e konsumatorëve (tabela 2). Në tremujorin e parë të vitit 2022, rritja ekonomike u mbështet nga neto

eksportet, si rezultat i lehtësimit të pengesave në zinxhirët e furnizimit, ndërsa me rihapjen e ekonomisë së eurozonës në tremujorin pasues u evidentua rritje e konsumit, veçanërisht të shërbimeve. Sidoqoftë, perspektiva e ekonomisë së eurozonës u përkeqësua në gjysmën e dytë të vitit 2022 si pasojë e rrezikimit të sigurisë së furnizimit me energji (pas reduktimit të eksportit të gazit natyror nga Rusia). Kjo situatë u reflektua në rritje të pasigurive dhe rënie të besueshmërisë së konsumatorëve. Rritja e çmimeve të energjisë, dhe për pasojë e çmimeve tjera, u përkthye në rritje të kostos së jetesës dhe dobësim të kërkesës së brendshme përgjatë tremujorit të fundit të vitit - kur ekonomia e eurozonës stagnoi në raport me tremujorin paraprak.

Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
Eurozona	1.6	-6.1	5.3	3.5	1.2	0.3	2.6	8.4
Austria	1.5	-6.5	4.6	5	1.5	1.4	2.8	8.6
Franca	1.8	-7.8	6.8	2.6	1.3	0.5	2.1	5.9
Gjermania	1.1	-3.7	2.6	1.8	1.4	0.4	3.2	8.7
Greqia	1.9	-9	8.4	5.9	0.5	-1.3	0.6	9.3
Italia	0.5	-9	7	3.7	0.6	-0.1	1.9	8.7
Spanja	2	-11.3	5.5	5.5	0.8	-0.3	3	8.3
Kosova	4.8	-5.3	10.7	3.5	2.7	0.2	3.4	11.6
Shqipëria	2.1	-3.5	8.9	4.2	1.7	2.2	2.3	6.6
Mali i Zi	4.1	-15.3	13	6.6	0.5	-0.5	2.5	11.9
Bosnja dhe Hercegovina	2.9	-3	7.4	4	0.6	-1.1	2	14
Serbia	4.3	-0.9	7.5	2.3	1.9	1.8	4	11.7
Maqedonia e Veriut	3.9	-4.7	3.9	2	0.7	1.2	3.4	14

Burimi: Eurostat, dhe Agjencitë Statistike të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2023)

Rritja e çmimeve të ushqimit dhe energjisë në tregjet ndërkombëtare rezultoi në rritje të çmimeve të importit, gjë që u pasqyrua në rritje të kostos së prodhimit dhe çmimeve të konsumit. IHÇK në eurozonë arriti në 8.4 përqind në 2022. Për të rikthyer inflacionin brenda targetit prej 2.0 përqind, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ndërhyri duke normalizuar politikën monetare përmes ndalimit të blerjes së aseteve dhe reduktimit të riinvestimit të pagesave të kryegjësë nga letrat me vlerë, si dhe përmes rritjes së normave të interesit për 250 pikë bazë në vitin 2022.

Shtrengimi i kushteve të financimit nga BQE vazhdoi edhe në vitin 2023, ku normat e interesit deri në maj 2023 rezultuan në rritje shtesë prej 125 pikë bazë, duke çuar në një rritje kumulative prej 375 pikë bazë që nga fillimi i shtrengimit të politikës monetare në korrik të vitit 2022.

Sidoqoftë, përkundër ngadalësimit të inflacionit të përgjithshëm me rënien e çmimeve të energjisë, presionet nga inflacioni bazë rezultojnë të jenë rritur dukshëm, me normën e inflacionit bazë që arriti normën më të lartë të shënuar historikisht prej 5.7 përqind në Mars 2023. Shkalla e lartë e inflacionit dhe

pasojat në të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare dhe margjinat e fitimit të ndërmarrjeve, si dhe shtrëngimi i kushteve të financimit, paraqesin rreziqe në rritje për agjentët ekonomik dhe aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Për pasojë, prospektet për rritje ekonomike në 2024 dhe 2025 janë rishikuar për poshtë në 1.6 përqind nga 1.9 respektivisht 1.8 përqind. Ndërsa, për vitin 2023, projeksionet e BQE-së parashohin rritje ekonomike prej 1.0 përqind (rishikim për lartë nga 0.5 përqind në parashikimet e dhjetorit 2022) bazuar mbi supozimet për rënie të çmimeve të energjisë, qëndrueshmërinë e provuar të ekonomisë së eurozonës kundrejt goditjeve nga ambienti i jashtëm, rritjen e të hyrave reale si dhe përmirësimin e perspektivës së aktivitetit ekonomik global pas rihapjes së ekonomisë së Kinës.

Presionet inflacioniste, ndonëse në magnitudë më të ulët, akoma vazhdojnë të nxiten nga pengesat në zingjirët e furnizimit - me theks të veçantë presionet në çmimet e mallrave. Kurse, çmimet e shërbimeve vazhdojnë të ndikohen nga rigjallërimi i kërkesës së brendshme pas rihapjes nga pandemia dhe rritja e pagave. Për më shumë, përkundër vlerësimit të valutës së euros, zhvlerësimi i shënuar gjatë vitit 2022 vazhdon të ndjehet akoma në çmimet e konsumit. Në vitin 2023, inflacioni pritet të ngadalësohet në 5.3 përqind në eurozonë, si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë dhe masave shtrënguese monetare që pritet të ngadalësojnë kërkesën e përgjithshme. Për më shumë, ky projeksion po ashtu bazohet në supozime për pritje të ankoruara të konsumatorëve për inflacion prej 2.0 përqind. Ndërsa në afatin e mesëm, inflacioni pritet të ngadalësohet në 2.9 përqind në 2024 dhe 2.1 përqind në 2025. Në anën tjetër, ritmi i inflacionit bazë pritet të jetë më i ngadalshëm për shkak të efektit të ngadalshëm indirekt të rënies së çmimeve të energjisë në çmimet tjera, tregjeve të forta të punës dhe rritjes së pagave për të kompenzuar rënien e të hyrave reale nga inflacioni.

Si pasojë e shtrëngimit të vazhdueshëm të politikës monetare përmes rritjes së normave të interesit, rritjes rezultuese të rrezikur kreditor,

si dhe zvogëlimit të tolerancës së bankave ndaj rrezikut bankat në eurozonë kanë shtrënguar standardet e kreditimit, që nënkupton shtrëngimin e kritereve për aprovim të kredive. Sipas anketës për kreditim bankar të BQE-së në tremujorin e parë të vitit 2023, shtrëngim më i fortë i standardeve keditore u evidentua në kreditimin ndaj ndërmarrjeve me 27.0 përqind të bankave në eurozonë që shtrënguan kushtet e kreditimit ndaj këtij segmenti, si dhe kreditimin ndaj ekonomive familjare gjegjësisht kredive hipotekare me 19.0 përqind të bankave që shtrënguan kushtet e kreditimit pasi norma mesatare e interesit në kredi hipotekare arriti në 3.4 përqind (2.0 pikë përqindje më e lartë se vitin paraprak). Ngjashëm, edhe dinamikat në kërkesën për kredi tregojnë për dobësim të aktivitetit kreditues në eurozonë, me kërkesën për kredi hipotekare dhe kërkesën për kredi nga ndërmarrjet që shënuan rënie përtej parashikimeve të bankave. Përderisa rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet ishte kryesisht rezultat i rritjes së normave të interesit dhe rënies së investimeve fikse, rënia e kërkesës për kredi hipotekare u ndikua edhe nga rritja e rreziqeve në tregun e patundshmërive, rënia e besueshmërisë së konsumatorëve si dhe rënia e shpenzimeve të ekonomive familjare në mallra të qëndrueshme. Shtrëngim i kushteve të kredive konsumuese u regjistrua në 10.0 përqind të bankave në eurozonë, ndërsa edhe rënia e kërkesës së ekonomive familjare për këtë lloj të kredive ishte më e ulët. Pritjet e bankave në eurozonë janë për dobësim të mëtejshëm të dinamikave të kreditimit dhe kërkesës për kredi nga të dy segmentet, mirëpo në shkallë më të ulët sesa në tremujorin e parë të vitit 2023.

Aktiviteti ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor po ashtu shënoi ngadalësim, ku rritja ekonomike rezultoi 3.8 përqind në 2022 krahasuar me 8.6 përqind në vitin 2021. Në gjysmën e parë të vitit 2022, aktiviteti ekonomik u mbështet nga forcimi i kërkesës së brendshme si rezultat i rritjes së konsumit privat me heqjen e masave kufizuese të pandemisë që u shoqëruan me zgjerim të aktivitetit ekonomik në sektorët e shërbimeve, si dhe në ekonomi të caktuara, edhe nga rritja e

investimeve publike. Në anën tjetër, kontributi pozitiv nga dinamikat e lartpërmendura u neutralizua nga efekti negativ i neto eksporteve, si pasojë e rritjes së çmimeve të importit.


Dinamikat e inflacionit në eurozonë u reflektuan shpejt në rajonin e Ballkanit Perëndimor, marrë parasysh lidhjet tregtare të rajonit me eurozonën si dhe varshmërinë nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike. Rrjedhimisht, norma mesatare vjetore e inflacionit në rajon arriti në 11.6 përqind në 2022 me të gjitha vendet, përveç Shqipërisë, që shënuan rritje dyshifrore të inflacionit. Sidoqoftë, paket e mbështetjes fiskale, rritja e remitancave, rritja e pagave dhe e kreditimit ndihmuan në mbështetjen e konsumit të ekonomive familjare, duke kompenzuar pjesërisht rënien e të hyrave reale nga inflacioni.

Për të frenuar inflacionin, vendet e rajonit me politikë monetare konvencionale si Serbia dhe Shqipëria ndërmorrën veprime drejt shtrëngimit të politikës monetare duke rritur normat e interesit, me normën e interesit në Serbi që u rrit në 5.5 përqind deri në shkurt 2023, ndërsa norma bazë e interesit në Shqipëri në qershor 2023 ishte 3.0 përqind. Ndonëse dinamikat e kërkesës për kredi ishin pozitive në Serbi, prospektet janë për zbehje të kërkesës për huamarrje si rrjedhje e parashikimeve për rritje relativisht të ulët ekonomike në Serbi (2.0 përqind sipas FMN-së). Në anën tjetër, u evidentua shtrëngim i kushteve të kreditimit si pasojë e rritjes së normave të interesit dhe në linjë me shtrëngimin e kushteve të financimit në nivel global. Për dallim, në Shqipëri kërkesa për kredi pritet të qëndrojë në pozitë më të favorshme e që pritet të nxitet më shumë nga kërkesa për kredi hipotekare. Sidoqoftë, rritja e normave të interesit ka ndikuar në përkeqsimin e prospekteve për kualitet të kredive si dhe të prospekteve të KJP-ve, duke ndikuar kështu në shtrëngim të kushteve të kreditimit që pritet të jetë më i shprehur në kreditimin ndaj ndërmarrjeve.

3.1. Ekonomia e brendshme

Aktiviteti ekonomik në Kosovë, ngjashëm me dinamikat në rajon dhe më gjerë, po ashtu u karakterizua me ngadalësim në vitin 2022, me normën e rritjes reale që rezultoi 3.55 përqind sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, kundrejt 10.7 përqind në 2021 (grafik 7).

Grafik 7. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK.

Në tremujorin e parë të vitit 2022, rritja ekonomike u gjenerua kryesisht nga konsumi privat dhe eksportet si rezultat i dinamikave pozitive nga viti paraprak. Sidoqoftë, si pasojë e rritjes së pasigurive të ndërlidhura me luftën në Ukrainë dhe rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë që gërryen të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare, nga tremujori i dytë e tutje u evidentua ngadalësim i dukshëm i kërkesës së brendshme. Për më shumë, rritja e çmimeve të mallrave në tregjet globale ndikoi në rritjen e vlerës së mallrave të importuara në tremujorin e parë duke kontribuar negativisht në rritjen ekonomike. Sidoqoftë, rritja e çmimeve të mallrave të importuara krahas rënies së fuqisë blerëse ndikoi në ngadalësimin dhe eventualisht rënien e importeve përgjatë vitit 2022. Si pasojë e përkeqësimit të perspektivës ekonomike, në dy tremujorët e fundit të vitit 2022 u evidentua ngadalësim i kërkesës së brendshme, veçanërisht i investimeve fikse si pasojë e rritjes së çmimeve të lëndës së parë dhe normës së ulët të ekzekutimit të investimeve kapitale, ndërsa konsumi mbeti në territor pozitiv ndonëse, i ulët, mbështetur pjesërisht në pako fiskale, remitanca dhe kreditim, si kompenzim për efektin e inflacionit në të ardhurat e disponueshme.

Sektorët me rritjen më të lartë të vlerës së shtuar ishin sektori i industrisë përpunuese, tregtisë, aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, informimit dhe komunikimit, hoteleve dhe restoranteve, etj., ndërsa si rezultat i rritjes së kostos së ndërtimit, sektori i ndërtimitarisë shënoi rënie të vazhdueshme nga tremujori i dytë deri në fund të vitit.

Rritja e aktivitetit ekonomik, sidomos në sektorin e shërbimeve, është paraqitur edhe tek statistikat afatshkurtra të shërbimeve ku është vërejtur rritje e qarkullimit pjesërisht si rezultat i rritjes së çmimeve dhe rritje e shkallës së punësimit mbështetur nga rritja e formalizimit të vendeve të punës dhe pakot fiskale.

Grafik 8. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve (2015=100)



Burimi: ASK.

Sektorët që shënuan rritjen më të lartë të shitjeve ishin hotelet dhe restorantet (48.5 përqind), pasuar nga tregtia (33.3 përqind), informacioni dhe komunikimi (24.1 përqind), aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike (16.6 përqind) si dhe transporti dhe magazinimi (11.3 përqind). Mesatarisht, indeksi i shitjeve neto në sektorin e shërbimeve shënoi rritje prej 20.3 përqind në vitin 2022, ndërsa indeksi mesatar i numrit të punësuarëve u rrit për 11.2 përqind (grafik 8).


Për vitin 2023, BQK parashikon që rritja ekonomike do të jetë rreth 4.0 përqind. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik gjatë këtij viti pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe neto eksportet. Konsumi pritet të shënojë rritje reale prej 1.8 përqind, ndërsa rritja nominale pritet të jetë 5.6 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë pozitivisht konsumin, ndër tjera, janë dinamikat pozitive

në remitanca, kompensimin e punëtorëve, rritjen e kredive konsumuese si dhe rritjen e konsumit publik. Për më shumë, investimet në vitin 2023 parashihet të shënojë rritje reale prej 2.6 përqind (6.1 përqind rënie në vitin 2022). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve pritet të ketë rritja e investimeve publike dhe dinamikat pozitive në çmimet në tregjet globale. Deficiti i eksporteve neto pritet të uljet për 6.3 përqind në terma real, si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 7.1 përqind, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet për vetëm 1.0 përqind.

Sidoqoftë, pasiguritë rreth këtyre projeksioneve janë të larta dhe anojnë nga kahu i poshtëm për shkak të shtrëngimit të kushteve kreditore në tregjet ndërkombëtare dhe efekteve direkte në kostot e kredimarrjes në vend, ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në eurozonë dhe pasojave potenciale në të hyrat e përgjithshme nga diaspora, rreziqeve për tensione gjeopolitike dhe implikimeve në politikat e tregtisë dhe pozicionin e investimeve, pasojave nga shkalla ende e lartë e inflacionit, e të tjera.

Varshmëria e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave energjetike dhe ushqimore ndikoi që përshpejtimi i çmimeve të këtyre mallrave në tregjet globale të reflektohet relativisht shpejtë në presione të forta inflacioniste në vend. Norma e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) arriti në 11.6 përqind në 2022, me çmimet e ushqimit dhe energjisë që ishin nxitësit kryesorë të inflacionit me kontribut prej 6.6 respektivisht 2.9 pikë përqindje në gjithsej normën e inflacionit (grafik 9). Marrë parasysh peshën e këtyre mallrave në shportën e konsumit, veçanërisht në atë të ekonomive familjare me të hyra më të ulëta, rëndimi i inflacionit në fuqinë blerëse është asimetrik duke prekur më shumë ekonomitë familjare më të ardhura më të ulëta. Për më shumë, rritja e kostos së prodhimit që rëndoi mbi ndërmarrjet rezultoi në bartjen e kostos së ngritur të prodhimit në çmimet e shitjes gjegjësisht konsumit. Rrjedhimisht, u evidentua zgjerim i bazës së inflacionit me 80.5

Grafik 9. Indikatorët e çmimeve në vend



Burimi: ASK (2023) dhe kalkulimet e BQK-së

përqind të shportës së konsumit që shënoi rritje vjetore më të lartë se 5.0 përqind në 2022.

Në këtë kontekst, rritje u shënuar edhe në inflacionin e brendshëm i cili përbën 1.5 pikë përqindje të inflacionit në 2022, kundrejt 10.1 pikë përqindje që ishte inflacioni i importuar. Ngjashëm me dinamikën në eurozonë, presionet e brendshme inflacioniste u intensifikuan edhe në vend kryesisht si rrjedhojë e përsheptimit të çmimeve të shërbimeve. Inflacioni bazë si indikator i prirjes më afatgjatë të inflacionit rezultoi në rritje mesatare vjetore prej 4.9 përqind në vitin 2022, me nivelin më të lartë historik të shënuar në dhjetor 2022 prej 6.8 përqind.

Pengesat e mbetura në zingjirët e furnizimit dhe luhatjet e mëdha të çmimeve të mallrave në tregjet globale u përkthyen në rritjen e tre indekseve tjera të çmimeve në vend, përkatësisht atij të prodhimit i cili shënoi rritje mesatare vjetore prej 9.4 përqind, indeksit të çmimeve të importit me rritje prej 18.9 përqind, si dhe kostos së ndërtimit me rritje vjetore prej 20.1 përqind.

Dinamikën e parashikuara në tregjet globale pritet të reflektohen edhe në ekonominë e Kosovës. Sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2023 pritet të ngadalësohet në 4.9 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në ngadalësimin e inflacionit përfshijnë rënien e çmimeve të energjisë, lehtësimet e mëtejshme të pengesave në zinxhirët e furnizimit, trendin rënës të inflacionit të përgjithshëm në eurozonë, ngadalësimin e aktivitetit ekonomik

në eurozonë dhe në vend, e të tjera. Sidoqoftë, projeksionet për inflacionin shoqërohen nga rreziqe që anojnë nga kahu i lartë dhe përfshijnë rreziqet potenciale për pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit si pasojë e përshkallëzimit potencial të tensioneve gjeopolitike dhe fragmentimit gjeoekonomik, reduktimin e sasisë së prodhimit të naftës, përsheptimin potencial të çmimeve të energjisë dhe mallrave tjera, zhvendosjen e pritjeve të konsumatorëve për inflacionin, e të tjera.

Sektori fiskal gjatë vitit 2022 u karakterizua me rritje të të hyrave buxhetore për 13.7 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore për 10.5 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte kryesisht rezultat i normës së lartë të inflacionit dhe përpjekjeve të ndërmarra për formalizimin e ekonomisë, përmes formalizimit të punësimit si dhe rritjes së kontrolleve dhe inspektimeve në teren. Si rezultat i rritjes së të hyrave buxhetore, deficiti primar buxhetor ishte shumë i ulët, duke rënë në 0.1 përqind të BPV-së nga 0.9 përqind sa ishte në vitin 2021. **Borxhi publik si përqindje e BPV-së ra në 20.7 përqind nga 21.5 përqind sa ishte në vitin 2021.** Kjo ulje ishte si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale, e cila reduktonte raportin e borxhit ndaj BPV-së. Sidoqoftë, në terma absolut borxhi publik ka arritur në 1.75 miliardë euro që është për 4.2 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2021. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm publik për 11.2 përqind duke arritur në 641.2 milionë euro, si dhe rritjes së borxhit të

brendshëm publik prej 0.5 përqind që arriti në 1.11 miliardë euro.

Në vitin 2022, sektori i jashtëm i Kosovës ka shënuar rënie në pozicionin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, duke reflektuar sfidat dhe disbalancin në aktivitetet e tregtisë së mallrave. Këto dinamika u neutralizuan deri në një masë nga dinamikat pozitive që karakterizuan pozicionin e llogarisë financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave u rrit për 35.4 përqind, duke arritur në 940.3 milionë euro përkatësisht në 10.5 përqind të BPV-së në vend. Rritja e deficitit të llogarisë së mallrave me 20.2 përqind dhe rënia e bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave parësore me 40.5 përqind ishin faktorët kryesorë që kontribuan në rritje. Megjithatë, bilanci pozitiv i llogarisë së të ardhurave dytësore që u rrit me 11.6 përqind dhe i shërbimeve me 32.9 përqind, ndihmuan në zbutjen e ndikimit negativ nga dinamikat e tregtisë së mallrave.

Në vitin 2022, eksporti i mallrave nga Kosova është rritur për 21.7 përqind duke arritur vlerën prej 920.4 milionë euro, si rezultat i rritjes së kërkesës për eksporte dhe sasisë së mallrave të eksportuara. Mallrat më të eksportuara vijojnë të jenë metalet bazë, plastika, goma dhe produktet minerale, ndërsa partnerët kryesorë të eksportit vendet e BE-së dhe Ballkani Perëndimor. Përderisa përpjekjet për diversifikim të eksporteve të mallrave duhet të intensifikohen, dinamikat globale e veçanërisht ato në eurozonë e Ballkanin Perëndimor mund të kenë peshë në dinamikat e eksporteve të Kosovës në periudhat në vijim.

Rritja e çmimeve të importit përgjatë vitit 2022 rezultoi në rritje vjetore të vlerës së importeve të mallrave prej 20.4 përqind në 5.6 miliardë euro, ekuivalente me 63.0 përqind të BPV-së. Produktet minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë shënuan rritjen më të lartë të importeve. Shtetet e BE-së përbëjnë 42.3 përqind e importit të përgjithshëm, ndërsa Turqia dhe Kina ishin burimet kryesore jashtë BE-së.

Rritja e eksportit të shërbimeve ka vazhduar të kontribuoj në përforcimin e

bilancit pozitiv të tregtisë së shërbimeve në vend. Tregtia e shërbimeve në Kosovë ka shënuar rritje të bilancit pozitiv mbështetur nga rritja e eksporteve prej 31.3 përqind dhe duke arritur në 2.5 miliardë euro, ndërkohë që importi i shërbimeve shënoi rritje prej 29.4 përqind dhe arriti në 1.1 miliard euro. Ndryshimi i strukturës së shërbimeve të eksportuara ndër vite përbën një dinamikë shumë të rëndësishme drejtë transformimit të modelit të ekonomisë së vendit. Një dëshmi të tillë na ilustron në dhënat e bilancit në shërbimet kompjuterike – që tregojnë për një rritje të vazhdueshme dhe qëndrueshme të kontributit që kanë në rritjen e gjithsej tregtisë në shërbime, nga pothuajse 0.7 pikë përqindje në 2018 (rreth 3 përqind e gjithsej shërbimeve të eksportuara) në 5.8 pikë përqindje në vitin 2022 (8.4 përqind e shërbimeve të eksportuara). Rritja e shërbimeve të udhëtimit, kategori që njëherësh ka edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej llogarinë e shërbimeve, kryesisht u ndikua nga rritja e shpenzimeve të diasporës në Kosovë, por edhe rritjes së numrit të udhëtarëve për 37.3 përqind krahasuar me vitin paraprak. Shërbimet e importuara, në anën tjetër, u dominuan nga dinamikat në kategorinë e udhëtimit që shënoi rritje vjetore prej 30.4 përqind dhe arriti vlerën prej 449.6 milionë euro, dhe kategoria e shërbimeve të transportit që shënoi rritje vjetore prej 39.1 përqind dhe arriti në 290.5 milionë euro.

Bilanci i të ardhurave parësore ka shënuar rënie prej 60.0 përqind, duke arritur vlerën prej 90.1 milionë euro, (151.4 milionë euro në vitin 2021). Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë rënie ka qenë bilanci i investimeve direkte, konkretisht, kthimi i dividendes prej 218.0 milionë euro kryesisht në sektorin financiar dhe të tregtisë. Tutje, kategoria e të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve janë rritur me 8.7 përqind, mbështetur nga rritja e të ardhurave nga punëtorët rezidentë të Kosovës që punojnë jashtë për periudhë të caktuar.

Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 1.22 miliardë euro, rritje vjetore prej 6.0 përqind, që përfaqëson 13.7 përqind të BPV-së. Rritja e

ngadalësuar e remitancave gjatë vitit 2022 mund t'i atribuohet deri në një masë, përkeqësimit potencial të pozicionit financiar të diasporës kosovare, si pasojë e rritjes së kostos së jetesës me rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, rritjes së normave të interesit e për pasojë shtrenjtimit të borxhit, dhe dobësimit të kërkesës së përgjithshme në eurozonë. Duke qenë se shumica e remitancave vijnë nga vendet e eurozonës (60.2 përqind), pasiguritë rreth dinamikave makroekonomike në vitin 2023 rrisin pasiguritë për këto të hyra të rëndësishme për ekonominë e vendit (13.7 përqind e BPV-së), duke vështirësuar tutje pozicionin e ekonomive familjare në vend, me efekte potenciale indirekte në dinamikat e rrezikut kreditor.

Në vitin 2022, investimet e huaja direkte në Kosovë u rritën për 85.0 përqind dhe arritën në 778.2 milionë euro. Sektori i patundshmërisë ka vazhduar të mbetet sektori me i rëndësishëm për investime të huaja dhe përbën 67.3 përqind të gjithëj IHD-ve. Sektorët tjerë me kontribut në rritjen vjetore të IHD-vë ishin sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, si dhe sektori i ndërtimitarisë. Marr parasysh hendekun në të dhëna në segmentin e patundshmërive, si në kontekst të mungesës së një indeksi të çmimeve në patundshmëri ashtu edhe të shtrirjes së kreditimit në këtë segment (rritje e lartë e evidentuar në vitet e fundit), monitorimi i rreziqeve që vijnë nga ky segment shoqërohet me pasiguri të larta.

Kutia 2. Kontributi i diasporës në ekonominë e Kosovës: skenari bazë dhe skenari alternativ

Kontributi i diasporës për ekonominë e Kosovës është i shumëanshëm dhe sfidues për t'u kuantifikuar. Diaspora ndikon në uljen e varfërisë përmes financimit të një pjese të konsumit, përmirësimin e gjendjes sociale, financimin e deficitit tregtarë, etj. Tutje, dërgesat e diasporës vlerësohet të kenë efekt të rëndësishëm edhe në pozitën e likuiditetit të sektorit bankar, përmes kontributit që kanë në bazën e depozitave. Ndërkohë që janë ndërmarrë iniciativa për të kuantifiku peshën e depozitave të diasporës në gjithsej depozitat e sektorit, dinamika e rritjes së lartë të depozitave dhe njëkohësisht, zvogëlimi i kredive të reja konsumuese në tremujorin e tretë jap indikacione për kontributin e këtyre të ardhurave në treguesit e sistemit financiar. Në anën tjetër, diaspora gjithashtu përbën edhe kanal kryesor përmes së cilit do të mund të transmetoheshin goditjet nga ekonomia e jashtme në Kosovë – si pasojë e peshës së lartë që ka në gjithsej BPV-në që gjenerohet në vend (reth 40 përqind e BPV-së).

Përgjithësisht, diaspora ka mbështetur aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, nëpërmjet:

- **Remitencave:** Remitencat janë burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje në Kosovë. Diaspora dërgon shuma të konsiderueshme parash në formë të remitencave, të cilat ndihmojnë në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e standardit të jetesës. Vetëm në vitin 2022, diaspora ka dërguar 1.2 miliardë euro apo 6.0 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. Remitencat janë karakterizuar me rritje të

qëndrueshme ndër vite dhe janë një burim i sigurt i të ardhurave për shumë familje kosovare;

- **Investimeve:** Diaspora investon në biznese në Kosovë, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, investimi në patundshmëri është forma kryesore e investimit të diasporës, dhe vetëm në vitin 2022, arriti vlerën prej 523.7 milionë euro;
- **Turizmit:** Si rezultat i lidhjeve të ngushta familjare, si aspekt kulturor por edhe ekonomik, diaspora viziton Kosovën disa herë gjatë vitit, me fokus në tremujorin e tretë të cdo viti, duke kontribuar kështu në rritjen e industrisë së turizmit përmes shpenzimit të parave në hotele, restorante dhe biznese lokale. Në vitin 2022, rritja e numrit të vizitorëve nga diaspora u shoqërua me rritje të shpenzimeve të tyre në Kosovë, vlerë që arriti në rreth 1.9 miliardë euro;
- **Transferimi i njohurive dhe shkathtësive:** Përmes shkathtësive të fituara ndër vite në vendet kryesore në Bashkimin Evropian si në Gjermani dhe Zvicër, dhe praktikave të të bërit biznes në këto vende, diaspora ka potencial të ndikoj në hendekun e shkathtësive në tregun e punës në vend dhe rritjen e produktivitetit të përgjithshëm.


Pesha që ka diaspora në aktivitetin e gjeneruar në vend, vlerësuar përmes burimeve të rëndësishme të financimit të konsumit dhe investimeve si remitencat, investimet dhe turizmi, arriti vlerën prej 3.6 miliardë euro në vitin 2022, që korrespondon me 40.4 përqind të BPV-së (tabela 1).

Tabela 1. Flukset hyrëse financiare të diasporës, në milionë euro

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Remitencat	665.5	691.0	759.2	800.5	851.7	980.1	1,153.4	1,223.0
Eksporti i shërbimeve të udhëtimit	719.7	901.4	1,112.1	1,228.2	1,321.4	628.0	1,490.1	1,875.3
Investimet në patundshmëri	153.3	139.7	154.7	205.2	223.8	201.1	384.0	523.7
<i>Gjithsej</i>	<i>1,538.5</i>	<i>1,732.1</i>	<i>2,026.0</i>	<i>2,233.9</i>	<i>2,396.9</i>	<i>1,809.2</i>	<i>3,027.5</i>	<i>3,622.0</i>
<i>% e BPV-së</i>	<i>27.1</i>	<i>28.7</i>	<i>31.9</i>	<i>33.5</i>	<i>34.0</i>	<i>26.7</i>	<i>38.0</i>	<i>40.4</i>

Burimi: BQK


Grafik 1. BPV dhe remitencat, në përqindje



Burimi: BQK dhe FMN.

Kontributi i një diaspore varet nga madhësia e saj dhe lidhja që e ka me vendin e origjinës. Diaspora kosovare vlerësohet të jetë sa 1/3 e popullsisë së Kosovës, dhe në aspekt ekonomik, social dhe kulturor, ka lidhje të forta familjare dhe shoqërore me Kosovën. Evidencë është veçanërisht karakteri kundër-ciklik i dërgesave të diasporës në vitin pandemik (15.1 përqind në vitin 2020 dhe 17.7 përqind në vitin 2021), dhe motivin altruist⁹ të kësaj dërgese (figura 1).

Grafik 2. BPV, investimet dhe shpenzimet e udhëtimit, në përqindje



Burimi: BQK dhe FMN.

Faktor i rëndësishëm përcaktues për kontributin e diasporës në një vend, mbështetur në studime të shumta, është gjithashtu perspektiva ekonomike si në vendin e origjinës, ashtu edhe në vendin ku është e lokalizuar një diasporë. Dinamikat makroekonomike në dy vendet rezultojnë të jenë përcaktuese në nivelin e kontributit të një diaspore në vendet e origjinës (figura 2).

Simulimi i reduktimit të të ardhurave nga diaspora

Marrë parasysh peshën e lartë që kanë të hyrat nga diaspora, BQK dhe akterët tjerë relevant duhet të kenë qasje proaktive në vlerësimin e ndjeshmërisë që kanë këto të hyra ndaj faktorëve të ndryshëm të

brendshëm apo të jashtëm, përmes monitorimit të afërt, analizave specifike dhe politikave përkatëse.

Projeksionet e realizuara në fillim të vitit 2023 parashikojnë një rritje të aktivitetit ekonomik në Kosovë rreth 4.0 përqind, krahasuar me 3.5 përqind në vitin 2022. Megjithatë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë mund të ndikoj negativisht në kontributin e diasporës ndaj ekonomisë së Kosovës. Projeksionet e muajit qershor nga BQE sugjerojnë një ngadalësim të rritjes së BPV-së reale në Eurozonë në 0.9 përqind në vitin 2023.

Në këto rrethana, BQK ka simuluar një skenar alternativ të rritjes ekonomike për vitin 2023, duke supozuar se kontributi i diasporës në ekonominë e Kosovës do të ishte më i ulët krahasuar me skenarin bazë.

Në këtë analizë, rezultatet kryesore të ndikimit të diasporës në aktivitetin ekonomik janë paraqitur duke përdorur një kombinim të simulimeve: goditje e investimeve në patundshmëri dhe shpenzime të udhëtimit me një devijim prej -3.2 pikë përqindje nga skenari bazë, si dhe goditje e remitencave me një devijim prej -1.6 pikë përqindje nga skenari bazë (tabela 2). Magnituda e këtyre goditjeve është përcaktuar në formë arbitrare, në mungesë të goditjeve direkte mbi këto të hyra në periudha paraprake.

Tabela 2. Goditjet në skenarin alternativ, në përqindje

Përshkrimi	Skenari bazë	Skenari alternativ	Devijimi, p.p
Remitencat	7.6	6.0	-1.6
Investimet në patundshmëri	2.6	-0.6	-3.2
Shpenzimet e udhëtimit	13.6	10.4	-3.2

Burimi: BQK.

Goditjet janë dhënë vetëm për vitin 2023, dhe është analizuar dhe vlerësuar efekti i tyre në të njëjtin vit.

Tabela 3. Parashikimi i BPV-së sipas skenarit bazë dhe skenarit alternativ, në përqindje

Përshkrimi	Skenari bazë	Skenari alternativ	Devijimi, p.p
Konsumi	1.1	1.0	-0.1
Investimet	2.6	0.5	-2.0
Eksportet neto	-6.3	-3.6	2.7
BPV	4.0	2.4	-1.6

Burimi: BQK.

⁹ Emigrantët dërgojnë më shumë para atëherë kur familjet e tyre në vendin e origjinës ballafaqohen me nivele më të ulëta të të ardhurave.

Në këtë skenar alternativ, ku është simuluar një kontribut më i ulët i diasporës përmes dy kanaleve kryesore, kundrejtë skenarit bazë, rezultojnë që rritja reale e BPV-së do të ishte 2.4 përqind në vitin 2023 gjegjësisht 1.6 pikë përqindje më e ulët krahasuar me skenarin bazë (tabela 3).

Në këtë skenar, deficitin e eksporteve neto do të përmirësohej me 3.6 përqind apo 2.7 pikë përqindje më pak krahasuar me skenarin bazë, investimet do të rriteshin për vetëm 0.5 përqind, ndërsa konsumi do rritej me pothuajse të njëjtën normë sikurse në skenarin bazë. Në përgjithësi, në skenarin alternativ, ndikimi i përgjithshëm negativ në BPV-

në reale është i dukshëm, duke treguar se reduktimi i të ardhurave nga diaspora ka një ndikim relativisht të lartë negativ në performancën ekonomike të Kosovës.

Megjithatë, skenari alternativ nuk merr parasysh faktorë të tjerë që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë, përveç ndikimit negativ në të ardhurat nga diaspora, nënkupton edhe kërkesë më të dobët për eksportet e mallrave. Për më tepër, skenari alternativ është përgatitur duke u bazuar në të njëjtat supozime fiskale dhe deflatorë të skenarit bazë.

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë rritjen e qarkullimit në tregtinë me pakicë, ndërsa vëllimi i prodhimit industrial shënoi rritje më të ulët gjatë vitit 2022. Si rezultat i rritjes së çmimeve, indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë shënoi rritje prej 9.1 përqind. Rritja më e lartë është shënuar në tregtinë me pakicë të karburanteve (34.6 përqind) dhe në pothuajse të gjithë sektorët e tjerë, me përjashtim të tregtisë së paisjeve informatike dhe të komunikimit, segment që shënoi rënie prej 4.3 përqind. Në anën tjetër, indeksi i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, shënoi një rritje të ulët prej 0.3 përqind në vitin 2022. Rritja e ulët e aktivitetit në sektorin e prodhimit mund t'i atribuohet deri në një masë ngadalësimit të rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht, rënies së investimeve të përgjithshme prej 6.1 përqind në vitin 2022. Në kuadër të indeksit të prodhimit industrial, indeksi i furnizimit me rrymë shënoi rritje prej vetëm 0.2 përqind ndërsa vlera e shtuar në BPV ishte më e ulët për 0.3 përqind. Indekset e industrisë nxjerrëse dhe industrisë përpunuese ishin pothuajse të pandryshuar ndërsa vlera e shtuar në BPV shënoi rritje të ngadalësuar.

Ngjashëm me rritjen e aktivitetit ekonomik, është rritur edhe iniciativa ndërmarrëse. Në vitin 2022 u regjistruan 11,024 ndërmarrje, ose 3.5 përqind më shumë se në vitin 2021, ndërsa u mbyllën 1,784 ndërmarrje, ose 10.9 përqind më shumë.

Sektorët që shënuan rritjen më të lartë në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i ndërtimit, me 238 ndërmarrje më shumë krahasuar me vitin paraprak, aktivitetet administrative dhe mbështetëse me 141 ndërmarrje më shumë, bujqësisë me 101 ndërmarrje më shumë, etj. Në sektorin e tregtisë, njëri nga sektorët me numrin më të madh të ndërmarrjeve, u regjistruan 272 ndërmarrje më pak krahasuar me vitin 2021 (grafik 10).

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar trendin e rritjes së shpejtë, por me normë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Gjithsej, borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 15.9 përqind në vitin 2022 (grafik 11) dhe arriti në 43.9 përqind të BPV-së.

Grafik 10. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve kredidhënëse në vend është rritur për 16.6 përqind (13.3 përqind rritje në vitin 2021), si rezultat i rritjes së kredive bankare prej 16.2 përqind por edhe rritjes prej 26.8 përqind të kredive të

lëshuara nga ndërmjetësit tjerë financiarë, të cilat kanë peshë më të vogël (3.7 përqind) në gjithë borxhin e ndërmarrjeve ndaj sektorit financiar.

Grafik 11. Borxhi i ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Kryesisht si rezultat i rritjes së kredive tregtare, borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve ka shënuar rritje prej 14.4 përqind dhe ka arritur në 28.7 përqind të gjithë borxhit. **Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në rritjen shkallës së ndërmjetësimit financiar.** Raporti i kreditimit të ndërmarrjeve nga institucionet kredituese në vend ndaj BPV-së arriti në 31.3 përqind në vitin 2022 (30.2 përqind në 2021). Kjo rritje e raportit kreditues ndaj BPV-së ka çuar në një hendek pozitiv të kredisë ndaj BPV-së.¹⁰


Pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 14.8 përqind (9.4 përqind rritje në vitin 2021). Depozitat e ndërmarrjeve shënuan normë të rritjes prej 19.0 përqind, ndërsa norma e rritjes së kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve ishte 16.6 përqind. Pra, përkundër rritjes më të lartë të depozitave, volumi shumë më i madh i kredive për ndërmarrjet ka ndikuar në rritjen e pozicionit debitor të ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar. Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët pasi që pjesëmarrja e depozitave në valutë ndaj gjithë depozitave ishte 3.0 përqind ndërsa kreditë në valutë ndaj gjithë kredive vetëm 0.4 përqind.

¹⁰ Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

Kreditë e reja për ndërmarrjet shënuan rritje për 9.6 përqind në vitin 2022 (10.4 përqind rritje në vitin 2021). Kreditë e reja jo-investuese shënuan rritje më të ngadalësuar prej 7.8 përqind dhe e zvogëluan pjesëmarrjen në strukturë nga 42.6 përqind në 41.9 përqind të gjithë kredive të reja për ndërmarrjet. Në anën tjetër, kreditë e reja investuese shënuan rritje prej 9.0 përqind dhe përbëjnë 54.4 përqind të gjithë kredive të reja për ndërmarrjet. Në aspektin e maturimit, kreditë me maturitet mbi 5 vjet përbëjnë rreth 17.5 përqind të kredive të reja dhe në vitin 2022 shënuan rënie prej 22.1 përqind. Kreditë me maturitet mbi 2 vite deri në 5 vite, si kategoria kryesore, e rritën pjesëmarrjen nga 47.2 përqind në 53.4 përqind në strukturën e përgjithshme të kredive të reja për ndërmarrjet.

Mbështetës i rëndësishëm i kreditimit ndaj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme ishte Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Rritja në vitin 2022 ishte në shkallë më të ulët krahasuar me vitin paraprak për shkak të mbylljes së dritares së Rimëkëmbjes Ekonomike në fund të vitit 2021. Sidoqoftë, me përkrahje edhe të donatorëve, FKGK në vitin 2022 ka lansuar dritare të reja të cilat kanë në fokus mbështetjen e sektorëve dhe profileve të ndryshme të ndërmarrjeve.

Grafik 12. Normat e interesit për ndërmarrjet




Kostoja e huamarrjes për ndërmarrjet ka shënuar rritje, pas trendëve rënës në vitet paraprake. Norma mesatare e interesit në kreditë e reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 6.1 përqind në vitin 2022, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me

normën prej 5.9 përqind në vitin 2021. Rritja e e normave të interesit kryesisht i atribuohet shtrëngimit të politikës monetare të BQE-së, gjë që u përkthye në rritje të kostos së financimit për banka dhe tutje në dinamika rritëse të normave të interesit. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara si dhe në ato të kursimit ka shënuar rënie të lehtë (grafik 12).

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare, sikurse ai i ndërmarrjeve, është rritur. Gjithsej borxhi i ekonomive familjare shënoi rritje prej 16.0 përqind në vitin 2022 dhe arriti në 20.8 përqind të BPV-së. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar dhe borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje të ngjashme prej 16.6 përqind. Në anën tjetër, borxhi i jashtëm i ekonomive familjare, i cili ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e ekonomive familjare (2.3 përqind), shënoi rënie prej 5.9 përqind (grafik 13).

Grafik 13. Borxhi i ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare shënuan rritje të ngadalësuar. Sipas qëllimit, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje për 13.5 përqind, kreditë investuese për 2.9 përqind, ndërsa kreditë konsumuese – që njëherësh kanë pjesëmarrjen më të lartë (62.5 përqind) në gjithsej kreditë e reja shënuan rënie për 6.3 përqind. **Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave.**

¹¹ Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 3.6 miliardë euro¹¹, që paraqet rritje vjetore prej 8.3 përqind (grafik 14).


Grafik 14. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK.

Gjithashtu, kreditë shënuan rritje prej 16.6 përqind duke arritur vlerën prej 1.6 miliardë euro. Si rezultat, pozicioni kreditor, që tradicionalisht e kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar, shënoi rritje vjetore prej 2.4 përqind. Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rënie të pozicionit të tij kreditor për 34.8 përqind, si rezultat i rënies së depozitave në valutë prej 34.6 përqind dhe rënies së kreditimit në valutë për 20.2 përqind.

Grafik 15. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Gjithsej depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 8.3 përqind (14.6 përqind rritje në vitin 2021). Rritja më e ngadalësuar e depozitave të ekonomive familjare mund t'i atribuohet deri në një masë, zvogëlimin të të hyrave të disponueshme për ekonomitë familjare. Depozitat e afatizuara shënuan rritje prej 18.4 përqind, ku norma mesatare e interesit në

depozitat e afatizuara ishte 1.54 përqind apo 0.35 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2021. Depozitat e kursimit shënuan rënie prej 2.0 përqind, ndërkohë që norma e interesit në depozita të kursimit ishte 0.14 përqind (0.11 përqind në vitin 2021).

Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare shënoi rënie të lehtë, e ndikuar nga presionet

konkurruese. Norma mesatare e interesit në kreditë e reja konsumuese prej 6.4 përqind në vitin 2021 zbriti në 6.3 përqind në vitin 2022 (grafik 15), ndërsa norma e interesit tek kreditë investuese prej 9.8 përqind ra në 9.5 përqind.

Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	1,104.7	1,182.2	1,401.2	1,634.1
prej të cilave në valutë	2.6	2.3	2.2	17
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,601.9	2,937.1	3,366.1	3,646.9
prej të cilave në valutë	138.5	155.4	176.1	115.1
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,497.3	1,754.9	1,964.9	2,012.9
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	3,041.6	3,406.3	3,655.7	4,205.7
Shkalla e varësisë ekonomike	253.0%	275.0%	248.0%	243.0%

Burimi: BQK.

Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, ku remitencat u rritën për 6.0 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve¹² shënoi rritje vjetore prej 12.5 përqind. Sa i përket tregut të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte 38.6 përqind në tremujorin e parë 2022 apo 1.3 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Shkalla e punësimit është rritur në 32.2 përqind, që është për 2.9 pikë përqindje më e

lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Edhe treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin në mes të popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, në tremujorin e parë 2022 është zvogëluar në 243 përqind nga 248 përqind sa ishte në vitin 2021. Në anën tjetër, shkalla e papunësisë është zvogëluar në 16.6 përqind, apo 9.2 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

¹² Të ardhurat nga kompenzimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e huamarrësëve Individual në Kosovë

Ngarkesa me borxh e huamarrësve në Kosovë është vlerësuar duke u bazuar në gjithsej popullacionin e klientëve individual nga të gjitha institucionet bankare dhe mikrofinanciare në Kosovë, përkatësisht huamarrësve fizik me kredi aktive të raportuara në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK) - sipas gjendjes në fund të muajit dhjetor 2022, që përfaqësohej nga gjithsej 331,914 klient fizik me gjithsej 576,527 kredi aktive¹³.

Duke theksuar mungesën e konsensusit për indikatorin më të 'mirë', tregues të ndryshëm

Tabela 1. Treguesit objektiv të ngarkesës me borxh

Kategoria	Treguesi	Vlerësimi/Treguesi	Rezultati
Kosto e servimit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Huamarrësit që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të të gjitha produkteve kreditore =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 251,293 huamarrës)	28.3% e huamarrësve shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
Vonesat	Huamarrësit me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	Indeksi i Ngarkesës me Borxh të Huave (shuma e kësteve mujore të huave aktive =>50% e të hyrave mujore të huamarrësit); (i kalkuluar për 199,837 huamarrës)	26.1% e huamarrësve me hua aktive shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore vetëm për hua
Nonesat	Huamarrësit me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	Huamarrësit me vonesa më shumë se 60 ditë (gjithsej 331,914 huamarrës)	12.5% e huamarrësve kanë vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kësteve kreditore. Ndërsa nga 183,743 huamarrës që kanë vetëm nga një kontratë kreditore 14.4% e tyre (apo 8.0% e gjithsej popullacionit të huamarrësve) janë në vonesë mbi 2 muaj.
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare =>4 kontrata aktive kreditore	Huamarrësit =>4 kontrata aktive kreditore (gjithsej 331,914 huamarrës)	5.84% e huamarrësve kanë 4 apo më shumë se 4 kontrata aktive kreditore

Burimi: BQK.

Indeksi i ngarkesës me borxh të huamarrësve është konstruktuar sipas metodologjisë së përdorur edhe në dy studimet paraprake¹⁴ të ngarkesës me borxh, përkatësisht si raport i shumës së kësteve mujore ndaj të hyrave mujore të huamarrësit. Nivelet e ngarkesës janë të definuara sipas katër klasifikimeve, varësisht prej vlerës së indeksit:

- 1) Të pangarkuar (indeksi i ngarkesës me borxh < 0.50):** huamarrësit të cilët shpenzojnë më pak se 50 përqind të të hyrave mujore, në pagesën e kësteve mujore të huave.
- 2) Në rrezik (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.50 – 0.75):** huamarrësit të cilët shpenzojnë 50 përqind deri në 75 përqind të të hyrave mujore në pagesën e kësteve mujore të huave.
- 3) Në fazë kritike (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.75 – 1.0):** huamarrësit të cilët shpenzojnë 75 përqind deri në 100 përqind të të hyrave mujore në pagesën e kësteve mujore të huave.
- 4. Jo-solvent (indeksi i ngarkesës me**

përdoren për të vlerësuar aspekte specifike të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet tek një pasqyrë më reale e gjendjes. Indikatorët të cilët respektojnë shumicën e parimeve të elaboruara në studime të ndryshme, reflektojnë katër aspekte të ngarkesës si: pjesëmarrjen e lartë të borxhit në raport me të hyrat, vonesat në pagesë, përdorimin e shpeshtë të kredive dhe aspektin subjektiv të konsiderimit të borxhit si barrë e rëndë. Rrjedhimisht, në këtë analizë është bërë vlerësimi i ngarkesës përmes disa prej këtyre treguesve objektiv, si dhe është testuar dhe analizuar ndërlidhja mes tyre (tabela 1).

borxh > 1.0): huamarrësit të cilët shpenzojnë gjithë të hyrat mujore në pagesën e kësteve mujore të huave; pra, këstet mujore tejkalojnë vlerën e të hyrave mujore.

Për matjen sa më reale të nivelit të ngarkesës, paraprakisht janë bërë trajtimet e nevojshme së të hyrave si dhe kësteve mujore në observimet ku ky informacion ka munguar. **Në rastin e të hyrave mujore** të huamarrësit, janë marrë për bazë të hyrat e fundit, përkatësisht të hyrat që janë raportuar në kredinë e fundit të lëshuar për huamarrësin përkatës. Në rastet kur informacioni ka munguar, është konsideruar mesatarja e të hyrave të raportuara në të gjitha observimet (kreditë aktive). Mirëpo kishte raste që vlera e të hyrave të raportuara në kredinë e fundit të devijonte negativisht prej mesatares së të hyrave për klientin e njejtë, si dhe raste kur këstet mujore të borxhit tejkalonin dukshëm të hyrat e fundit të raportuara, të cilat nga një mostër e vlerësimit është vërejtur se kanë të bëjnë me kredi të lëshuara për sektorin e agrokulturës¹⁵, apo kredi të lëshuara

¹³ Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike janë të prezantuara në tabelën 3.

¹⁴ NGARKESA ME BORXH E KLIENTËVE BANKARË NË KOSOVË | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)

¹⁵ Kreditë për agro-kulturë në shumicën e rasteve kanë frekuencë jo të rregullt të pagesës, përkatësisht këste të larta të ndara në periudha më të rralla kohore.

tek profesionet si menaxher/pronar/drejtor etj., të cilët përveç të hyrave si individ, kanë edhe të hyra nga bizneset individuale. Për të eliminuar problemin e tillë, pra të mbivlerësimit të ngarkesës, përkatësisht josolvensës, në këto raste kur devijimi i vlerës së fundit të raportuar e të hyrave dhe atyre mesatare për klientin e njejtë ishte negativ dhe shumica e kësteve tejkalonte dukshëm vlerën e të hyrave të fundit, atëherë janë marrë për bazë të hyrat maksimale, nën supozimin që ato paraqesin të hyrat më reale të huamarrësit (konsideruar që klientët e tillë kanë edhe të hyra që realizohen nga biznesi por që nuk janë raportuar në kredinë e fundit). Nga i gjithë popullacioni i klientëve me kredi aktive, pjesëmarrja e rasteve me mungesë të informacionit mbi të hyrat e fundit të raportuara ishte 16.7 përqind, ndërsa me përfshirjen e të hyrave mesatare apo maksimale aty ku mungonte informacioni (përkitazi me llojet e rasteve të elaboruara më lartë), pjesëmarrja e rasteve me mungesë të informacionit mbi të hyrat zbritet në 13.5 përqind.

Mungesa e informacionit mbi këstet kreditore është trajtuar specifikisht sipas produkteve kreditore. Në grupin e **produkteve kreditore hua (hua, lizing dhe kredi hipotekare)**, kësti mujor ka munguar në 3,032 raste (2.4 përqind të gjithsej portfolios së kredive hua). Për këto raste janë bërë kalkulimet përkitazi me informacionet në dispozicion. Mirëpo në disa prej observimeve, norma e interesit ishte në nivele ekstreme që zgjonte dyshime mbi kualitetin e raportimit të kësaj variable. Prandaj, për të eliminuar dyshimet, kalkulimi i këstit në observimet ku mungonte ky informacion, është bazuar në normën mesatare të interesit në kreditë e ekonomive familjare, që korrespondon me llojin e kredisë, me vitin e disbursimit të asaj kredie, si dhe llojin e institucionit huadhënës (bankar ose mikrofinanciar). Për **produktin kreditor mbitërheqje**, kalkulimi i kësteve kreditore në observimet ku mungonte informacioni (29 përqind e rasteve me bilanc të shfrytëzuar të gjithsej portfolios së mbitërheqjeve), është realizuar duke aplikuar normën mesatare të interesit për mbitërheqje. Ndërsa për ato observime ku maturiteti i mbetur ishte më i ulët se një muaj nga data efektive (dhjetor 2022) është trajtuar ashtu që e gjithë vlera e mbetur (outstanding) të konsiderohet si këst. Për **produktin kreditor kreditkartelë**, mungesat e informacionit mbi këstet (63.2 përqind e rasteve me bilanc të shfrytëzuar në gjithë portfolion e kreditkartelave),

janë trajtuar si në vijim: për kontratat kreditore të cilat nuk kishin vonesa në pagesë, si këst është konsideruar 15 përqind e shumës së borxhit, që përfaqëson nivelin minimal që një përdorues i kreditkartelës duhet ta paguaj në muajin vijues. Në rastet kur kishte vonesa në pagesë të këstit më shumë se 30 ditë dhe kur norma efektive e interesit ishte në dispozicion, atëherë janë kalkuluar këstet bazuar në shumën e mbetur borxh, ndërsa në rastet kur informacioni mbi normën efektive nuk posedohej, atëherë është konsideruar norma mesatare e interesit në të gjitha kreditkartelat e popullacionit në analizë. Me trajtimet përkatëse, informacioni mbi këstet kreditore ishte i disponueshëm për 85.6 përqind të huamarrësve, ndërsa në 14.4 përqind të rasteve, kësti ishte i barabartë me zero që reflekton bilancet e pashfrytëzuara të produktete kreditore si kreditkartelat dhe mbitërheqjet.


Si pasojë e mungesës së informacioneve rreth të hyrave të huamarrësve dhe vlerës zero të kësteve kreditore në disa observime, indeksi i ngarkesës ka munguar në 13.5 përqind të rasteve ose ka rezultuar me vlerë zero në 10.8 përqind të rasteve (që janë rastet e kësteve zero). Rrjedhimisht, bazuar në disponueshmërinë e të dhënave dhe trajtimeve përkatëse të realizuara si më lartë, vlerësimi i nivelit të ngarkesës më borxh është arritur të kalkulohet për 75.7 përqind të gjithsej huamarrësve.

Rezultatet e vlerësimit të ngarkesës me borxh sugjerojnë që 28.3 përqind e huamarrësve janë të mbingarkuar me borxh.¹⁶ Në fazën e parë të mbingarkesës – pra në rrezik për mbingarkesë ngase kësti mujor përbën 50 përqind deri në 75 përqind së të hyrave mujore - janë 17.7 përqind të huamarrësve. Në fazën kritike rezultojnë 7.2 përqind e huamarrësve. Rastet kur shpenzimet e kësteve të huamarrësit tejkalojnë plotësisht të hyrat mujore bruto duke kaluar në **gjendje josolvente, paraqiten në 3.5 përqind të mostrës së huamarrësve** (grafik 1).


¹⁶ Mbingarkesa përfshinë rastet kur niveli i borxhit mujor për të gjitha produktet kreditore (shuma e kësteve mujore të huave,

lizingjeve, mbitërheqjeve, dhe kreditkartelave aktive) tejkalon 50 përqind së të hyrave mujore.

Grafik 1. Shpërndarja e huamarrësve fizik sipas indeksit të ngarkesës



Grafik 2. Huamarrësit sipas produkteve kreditore (331,914 huamarrës)



E rëndësishme është të theksohet se niveli aktual i mbingarkesës jo-domosdoshmërisht reflekton gjendjen faktike të huamarrësve. Ky nivel, mund të paraqes mbivlerësim të gjendjes së mbingarkueshmërisë, për shkak të mungesës së të dhënave të anëtarëve tjerë të ekonomisë familjare

apo bashkëhuamarrjes, të cilat rrjedhimisht nuk janë konsideruar, si dhe për shkak të informalitetit të lartë në ekonomi që përveç të hyrave të deklaruarra dhe të mbështetura me kontratë, huamarrësit mund të kenë edhe burime të tjera të të hyrave.

Indikatori është kalkuluar edhe ndaras për produkte kreditore. Në përbërjen e gjithë huamarrësve, 68.92 përqind rezultojnë të kenë hua aktive (228,794 huamarrës), ndërsa 31.08 përqind vetëm produkte tjera kreditore. Mbitërheqje më bilanc të shfrytëzuar kanë 9.8 përqind e huamarrësve (32,494 huamarrës), ndërsa kreditëkartelë me bilanc të shfrytëzuar kanë 37.2 përqind e gjithsej huamarrësve (123,443 huamarrës) (grafik 2).

Niveli i ngarkesës me borxh vetëm për produktin kreditor hua (hua, lizing, kredi hipotekare), duke përfshirë produktet tjera kreditore si kreditëkartelat dhe mbitërheqjet, është kalkuluar për 60.2 përqind të gjithë popullacionit të huamarrësve, duke sugjeruar se të mbingarkuar me borxh janë 26.1 përqind e tyre.

Vlerësimi i ngarkesës për huamarrësit që posedojnë produktin kreditor mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar është realizuar në popullacionin prej 10,335 klientëve apo 3.1 përqind e të gjithë popullacionit të huamarrësve, dhe sugjeron se të mbingarkuar me borxh janë 11.4 përqind e këtyre huamarrësve.

Ndërsa indeksi i ngarkesës për huamarrësit që posedojnë kreditëkartela është kalkuluar për 35.4 përqind e të gjithë huamarrësve, rezultate që sugjerojnë se vetëm 1.1 përqind e tyre janë të mbingarkuar me borxh.

Probabiliteti i **mbingarkesës** është më i larti te huamarrësit me tri e më shumë kontrata aktive kreditore si dhe me kredi në institucione në të dy sektorët - bankar dhe mikrofinanciar njëkohësisht. Pra, niveli më i lartë i ngarkesës me borxh të huamarrësve asocohet me huamarrjen e shumëfishtë - me posedimin e shumë kontratave aktive kreditore në disa institucione të ndryshme.

Të pasurit histori kreditore dhe kontrata kreditore të mbështetura në kolateral asocohen me nivele më të larta të ngarkesës me borxh. Problemet në performancën e pagesës rezultuan poashtu të jenë të ndërlidhura me nivelin më të lartë të ngarkesës me borxh, me ç'rast niveli më i lartë i rasteve të mbingarkesës është i shprehur në mesin e huamarrësve me vonesa më shumë se 180 ditë në pagesën e kësteve kreditore (tabela 2).

Huamarrësit e shumëfishtë në institucione të ndryshme kishin 47.3 përqind të rasteve të mbingarkesës krahasuar me 38.9 përqind e huamarrësve me disa kontrata kreditore por vetëm në një institucion. Duke krahasuar nivelin e ngarkesës ndaras sipas sektorëve, tendencat për mbingarkesë ishin më të larta në mesin e huamarrësve me kredi aktive në sektorin bankar (29.1 përqind e huamarrësve, krahasuar me 17.7 përqind të huamarrësve të mbingarkuar, me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar).

Nga **karakteristikat socio-demografike** që kishin dallime statistikisht të rëndësishme në **mbingarkesë me borxh rezulton gjinia** (më të mbingarkuar rezultojnë të jenë huamarrësit burra), **statusi martesor** (më të mbingarkuar me borxh rezultojnë të jenë huamarrësit në grupin me status martesor 'të martuar'). Ky rezultat, përkatësisht mbingarkesa më e lartë në mesin e huamarrësve të martuar ndërlidhet me faktin se në shumë raste të martuarit marrin kredi me bashkëhuamarrje – gjë që nuk është konsideruar gjatë vlerësimit të ngarkesës në këtë analizë, për shkak të të dhënave

jo të plota mbi bashkëhuamarrjet, dhe për pasojë mund të ketë mbivlerësuar gjendjen e ngarkesës së kësaj kategorie. Tutje, **rajoni** rezultojn me rëndësi statistikore në nivel të mbingarkesës (rajoni i Prishtinës dhe Mitrovicës ka më shpesh raste të mbingarkesës); **mosha** (rastet më të shpeshta të


mbingarkesës paraqiten në mesin e huamarrësve në grup-moshën 31-40 dhe 51-65 vjeç); **dhe niveli i të ardhurave** (rastet më të shpeshta të mbingarkesës paraqiten në mesin e huamarrësve me të hyra 250-450 euro) (tabela 2).

Tabela 2. Ngarkesa me borxh e huamarrësve sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike si dhe të modeleve të huamarrjes

Karakteristikat	Të pa ngarkuar (kësti mujor < 50% e të hyrave të EF)	Të mbingarkuar (kësti mujor > 50% e të hyrave të EF)		
		Në rrezik (borxh/të hyra = 50%-75%)	Në fazë kritike (borxh/të hyra = 75%-100%)	Josolvent (borxh/të hyra = mbi 100%)
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL				
Gjinia e huamarrësit				
Grua	71.5%	18.1%	7.4%	3.0%
Burrë	71.6%	17.7%	7.1%	3.7%
Statusi martesor i huamarrësit respektiv				
E/l pamartuar	76.3%	15.8%	5.5%	2.5%
Martuar	69.2%	18.7%	8.1%	4.0%
Ve ndarë	72.1%	17.4%	6.4%	4.1%
Lloji i huamarrësit				
Fizik rezident	71.7%	17.7%	7.2%	3.5%
Fizik jo-rezident	82.9%	8.9%	4.7%	3.4%
Rajoni i huamarrësit respektiv				
Prishtinë	69.5%	19.4%	7.5%	3.7%
Mitrovicë	70.4%	18.9%	7.4%	3.3%
Prizren	75.4%	15.4%	6.4%	2.8%
Ferizaj	73.9%	16.1%	7.0%	3.1%
Gjilan	73.6%	16.4%	6.7%	3.4%
Gjakovë	72.3%	16.8%	7.0%	3.9%
Pejë	71.5%	17.2%	7.3%	4.0%
Mosha e huamarrësit respektiv				
< 30 vjet	78.9%	14.2%	4.7%	2.2%
30 - 40 vjet	69.4%	19.2%	7.8%	3.7%
40 - 50 vjet	68.5%	19.2%	8.3%	4.0%
50- 60 vjet	68.4%	19.3%	8.2%	4.0%
> 60 vjet	84.6%	8.4%	3.6%	3.4%
Niveli i të hyrave të huamarrësit				
deri në 170 euro	34.0%	26.2%	20.5%	19.3%
170-249 euro	64.7%	18.1%	11.0%	6.3%
250-449 euro	68.6%	19.9%	8.1%	3.4%
450-749 euro	69.1%	20.8%	7.5%	2.7%
750-999 euro	78.6%	14.8%	4.6%	2.1%
1000-2000 euro	85.4%	9.6%	2.9%	2.2%
mbi 2000 euro	91.9%	4.8%	1.6%	1.7%
MODELET E HUAMARRJES				
Ngarkesa me borxh sipas numrit të kontratave kreditore				
Një kontratë aktive kreditore	89.0%	7.1%	2.4%	1.5%
Dy kontrata aktive	68.3%	21.4%	7.2%	3.1%
Tri kontrata aktive	52.4%	30.8%	12.0%	4.9%
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	32.6%	32.6%	22.4%	12.4%
Ngarkesa sipas llojit të kontratave kreditore				
Hua, lizing, kredi hipotekare	73.9%	17.4%	5.9%	2.8%
Mbitërheqje me bilanc të shfrytëzuar	88.6%	4.3%	4.6%	2.6%
Kreditkartelë me bilanc pozitiv të shfrytëzuar	98.9%	0.9%	0.2%	0.1%
Ngarkesa sipas llojit të institucionit huadhënës				
Bankë	70.9%	19.8%	6.4%	2.8%
Mikrofinancë	82.3%	10.3%	4.8%	2.7%
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	49.4%	24.7%	17.0%	8.9%
Ngarkesa sipas huamarrjes së shumfishtë dhe në institucione të ndryshme				
Shumë kontrata - një institucion kredidhënës	61.1%	27.5%	8.2%	3.2%
Shumë kontrata - disa institucione kredidhënëse	52.7%	24.9%	14.9%	7.5%
Ngarkesa sipas historisë kreditore				
Asnjë kontratë të mbyllur	84.4%	10.3%	3.4%	1.9%
Të paktën një kontratë të mbyllur	67.1%	20.4%	8.5%	4.0%
Ngarkesa sipas kontratave të kolateralizuara				
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	76.8%	14.5%	5.6%	3.1%
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	70.5%	18.5%	7.5%	3.5%
Ngarkesa me borxh sipas klasifikimeve kreditore (vonesave në pagesën e obligimeve kreditore)				
Në kohë, apo me vonesë <30 ditë	72.0%	17.8%	7.0%	3.2%
Vonesë 30- 60 ditë	72.3%	16.7%	7.3%	3.7%
Vonesë 60-90 ditë	73.6%	14.6%	7.1%	4.8%
Vonesë 90 - 180 ditë	71.3%	15.3%	8.7%	4.8%
Vonesë > 180 ditë	65.3%	17.1%	9.3%	8.2%
Shlyerjet	74.4%	14.6%	6.9%	4.2%


Burimi: BQK.

Grafik 2 a. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore




Burimi: BQK.

Grafik 2 b. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas kolateralizimit



Burimi: BQK.

Grafik 2 c. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës



Burimi: BQK.

Tendencat për vonesë në pagesën e kësteve mujore dallojnë sipas karakteristikave të njejta sociodemografike me ato të mbingarkesës, përjashtuar rastin e *statusit martesor* ku në tendencat për vonesë në pagesën e kësteve më të shpeshta janë rastet e huamarrësve në grupin me status martesor ‘të pa-martuar’. Në kuadër të modeleve të huamarrjes, të rëndësishme statistikisht në tendencat për vonesë rezultuan numri i kontratave kreditore, kolateralizimi, lloji i

institucionit huadhënës, historia kreditore, dhe huamarrja e shumëfishtë.


Rrastet më të shpeshta të vonesave paraqiten në grupin e huamarrësve me dy si dhe katër e më shumë kontrata kreditore (grafik 2a).

Rastet më të shpeshta të vonesave paraqiten tek kontratat e kolateralizuara (grafik 2b).

Tendencat më të larta të vonesave paraqiten tek huamarrësit me kredi vetëm në mikrofinanca (grafik 2c).

Vonesat më të shpeshta paraqiten tek grupi i huamarrësve me histori kreditore me të paktën një kontratë të mbyllur (grafik 2d).


Grafik 2 d. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas historisë kreditore



Burimi: BQK.

Po ashtu tendencat më të larta të vonesave në pagesën e kredive ishin në mesin e huamarrësve të shumëfishtë - më shumë se një kontratë kreditore aktive dhe nga institucione të ndryshme. Rreth 20.9 përqind e huamarrësve të shumëfishtë, me produkte kreditore në institucione të ndryshme, janë në vonesë, krahasuar me vetëm 2.7 përqind të huamarrësve të shumëfishtë por në të njëjtin institucion (grafik 2e).

Grafik 2 e. Performanca e pagesës sipas numrit të kontratave kreditore dhe institucioneve huadhënëse



Burimi: BQK.

Rezultatet e nxjerra nga gjithsej popullacioni janë shumë të përafërta me rezultatet nga studimi i fundit i realizuar¹⁷. Indeksi i ngarkesës i kalkuluar për gjithsej popullacionin e huamarrësve, sugjeron se 26.1 përqind janë të mbingarkuar me borxh të huave, ndërsa në mostrën e studimit të kaluar¹⁸ prej 1,805 të huamarrësve individual që posedonin produktin hua, të mbingarkuar rezultonin të ishin 27.4 përqind e tyre. Në këtë analizë nuk janë reflektuar të hyrat e anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare, ngase si analizë është mbështetur vetëm në të dhënat e RKK-së që përmbajnë informata për huamarrësin, përderisa në studimin e kaluar është analizuar niveli i ngarkesës edhe për ekonomi familjare duke bërë gërshetim informacionesh që janë në RKK dhe informacioneve të siguruara nga institucionet financiare për klientët e tyre (të dhëna edhe për të hyrat e anëtarëve të tjerë të familjes së huamarrësit përkatës).

Përfundimisht mbingarkesa me borxh është tentuar të vlerësohet përmes tre treguesve, si indeksi i ngarkesës, vonesat në pagesën e kësteve dhe posedimi i shumë kontratave kreditore, të cilat së bashku japin informacion të rëndësishëm mbi nivelin e ngarkueshmërisë me borxh të huamarrësve të sektorit financiar në Kosovë. **Megjithëse rezultatet sugjerojnë se mbingarkesa asocohet me huamarrje të shumëfishtë dhe performancë më të dobët të pagesës**, relacioni shkak-pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është i përcaktuar, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme. Posedimi i më shumë kontratave kreditore patjetër ndikon në rritjen e borxhit mujor për pagesë dhe ka ndikim në rritjen e nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve. Megjithatë, ekziston mundësia që huamarrësit marrin borxh shtesë për servisim të borxhit ekzistues në rastet e pamundësisë së pagesës, dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në mbingarkesë.

Gjithsesi, rezultatet e studimit mund të jenë subjekt i disa kufizimeve në aspekt të kualitetit të të dhënave në dispozicion dhe supozimeve të bëra për shkak të mungesave të hasura. **Në aspektin e disponueshmërisë së të dhënave janë evidentuar rastet si: mungesa e informacionit mbi të hyrat në disa observime, diferenca të theksueshme ndërmjet të hyrave të fundit të**

raportuara dhe atyre maksimale apo mesatare (në të gjitha kontratat aktive kreditore) si dhe të hyrave shumë më të ulëta të raportuara në kontratën e fundit që tejkaloheshin nga këstet kreditore për huamarrësin respektiv. Kjo mund të jetë e ndikuar nga mos-konsistenca e mundshme e azhurnimit të të dhënave për huamarrësin, apo nga mos-evidentimi i të gjitha burimeve të të hyrave të huamarrësit (të hyrat nga biznesi privat, remitencat, të hyra e anëtarëve të tjerë të ekonomisë familjare), të cilat janë konsideruar gjatë shqyrtimit të aplikacionit për kredi, por që nuk kanë qenë të dokumentuara me kontratë apo qarkullim bankar, faktorë që mund të ndikojnë në nënvlerësimin apo mbi-vlerësimin e ngarkesës aktuale me borxh. Poashtu mungesa e informacionit të plotë për bashkë-huamarrjet mund të ndikojnë në mbivlerësim të ngarkesës së huamarrësit. **Në aspekt të cilësisë**, janë evidentuar rastet e raportimeve të vlerave ekstreme, të hyra shumë të larta apo me vlerë zero, norma shumë të larta apo të ulëta të interesit (që janë të nevojshme për kalkulim të këstit në observimet ku ka munguar), këste shumë të larta që në raste tejkallonin dukshëm të hyrat mujore të huamarrësit e që për pasojë e mbivlerësojnë ngarkesën me borxh. Megjithatë, disa nga rastet e tilla janë trajtuar përkitazi me mundësitë dhe të dhënat e disponueshme, të cilat janë të elaboruara në fillim të kësaj analize. Poashtu janë vërejtur gabime të tjera teknike si mungesa e kodimit të profesioneve, gabime në futjen e të dhënave si data e lëshimit të kredisë më e vonshme se data e maturimit etj.

Kufizimet në disponueshmërinë dhe kualitetin e të dhënave, dhe natyra komplekse dhe shumë e rëndësishme e problematikës së mbingarkueshmërisë, theksojnë nevojën për ndërveprim të institucioneve, përkatësisht angazhimin e të gjitha palëve relevante në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore, ashtu sic është rekomanduar edhe në studimin e kaluar të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare, e realizuar në vitin 2022 (BQK_FSR_18.pdf (bqk-kos.org))

Të hyrat dhe kësti (në euro)	Mesatarja	Mediana	Maksimumi
Të hyrat	787	488	50,000
Kësti gjithsej	203	127	140,176
Kësti hua	169	106	140,176
Kësti mbilësheje	3	-	8,241
Kësti kreditkartelë	26	-	4,551
Kësti kredi hipotekare	5	-	15,249
Shuma e aprovuar në kredi	11,498	5,600	2,114,800
Shuma e mbetur aktive në kredi (outstanding amount)	8,334	3,432	1,977,813

¹⁷ Studimi i kaluar i publikuar në vitin 2022, reflekton gjendjen e ngarkesës sipas të dhënave me muajin Mars 2021.

¹⁸ Mostra në studimin e kaluar është përzgjedhur duke respektuar nivelin e besueshmërisë prej 99% dhe me marginën e gabimit 3%. Kjo mostër fillimisht ka përfshirë 1,841 klientë me gjithsej 5,014 kredi aktive. Ndërsa indeksi i ngarkesës për produktin kreditor hua është llogaritur për 1,805 klientë.

Tabela 3. Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike dhe të modeleve të huamarrjes së huamarrësve individual fizik


Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësit individual	Pjesëmarrja(%)	Numri/Frekuenca
Numri i huamarrësve: 331,914		
Numri i kontratave aktive kreditore: 576,527		
KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË HUAMARRËSIT INDIVIDUAL		
Gjinia e huamarrësit		
Grua	31.8%	102,425
Burrë	68.2%	219,911
Statusi martesor i huamarrësit respektiv		
E/! pamartuar	39.6%	130,128
Martuar	60.0%	197,205
I/e ndarë	0.5%	1,549
Lloji i huamarrësit		
Fizik rezident	98.3%	326,171
Fizik jo-rezident	1.7%	5,743
Rajoni i huamarrësit respektiv		
Prishtinë	36.3%	120,304
Mitrovicë	11.9%	39,359
Prizren	14.6%	4,847
Ferizaj	9.4%	31,203
Gjilan	8.9%	29,382
Gjakovë	9.2%	30,323
Pejë	9.8%	32,315
Mosha e huamarrësit respektiv		
< 30 vjet	23.7%	7,858
30 - 40 vjet	26.7%	88,755
40 - 50 vjet	22.6%	75,052
50 - 60 vjet	23.5%	77,957
> 60 vjet	3.5%	11,568
Niveli i të hyrave të huamarrësit		
deri në 170 euro	2.3%	6,667
170-249 euro	8.4%	24,235
250-449 euro	34.2%	98,177
450-749 euro	29.8%	85,603
750-999 euro	8.7%	24,923
1000-2000 euro	11.4%	32,821
mbi 2000 euro	5.2%	14,824
MODELET E HUAMARRJES		
Numri huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore		
Një kontratë aktive kreditore	55.4%	188,743
Dy kontrata aktive	23.4%	77,772
Tri kontrata aktive	15.4%	51,011
Katër e më shumë kontrata aktive kreditore	5.8%	19,388
Numri huamarrësve sipas numrit të institucioneve		
Klient me kontratë në vetëm një institucion	81.9%	271,835
Klient me kontrata në disa institucione	18.1%	60,079
Numri huamarrësve sipas llojit të institucionit huadhënës		
Bankë	63.9%	211,945
Mikrofinancë	27.5%	91,324
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	8.6%	28,538
Numri huamarrësve sipas historisë kreditore		
Asnjë kontratë të mbyllur	30.1%	99,874
Të paktën një kontratë të mbyllur	69.9%	232,040
Numri huamarrësve sipas kontratave të kolateralizuara		
Asnjë kontratë aktive të kolateralizuar	16.1%	53,518
Të paktën një kontratë të kolateralizuar	83.9%	278,396

4. Zhvillimet në sistemin financiar

Sistemi financiar shënoi rritje të aktivitetit përkundër ballafaqimit me rreziqe me të larta – inflacion dhe perspektivë më të dobët ekonomike. Të gjithë sektorët përbërës u karakterizuan me përshejtim të trendit rritës, me përjashtim të sektorit pensional i cili shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes.

Në dhjetor 2022, vlera e asetëve të sistemit financiar arriti në 9.89 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 10.8 përqind (12.7 përqind në vitin 2021). Shkalla e ndërmjetësimit financiar (raporti i asetëve ndaj BPV-së) u zvogëlua për të dytin vit me radhë, duke zbritur në 110.4 përqind nga 112.2 përqind në vitin 2021. Rritja më e lartë e BPV-së nominale, si rezultat i rimëkëmbjes së ekonomisë në periudhën pas-pandemike, ndikoi në trendin rënës të shkallës së ndërmjetësimit pas vitit 2020 (grafik 16).


Grafik 16. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së



Kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej asetëve të sistemit financiar e kishte sektori bankar, i cili në dhjetor 2022 përfaqësoi 68.4 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit, dhe përkundër peshës së ulët prej

vetëm 4.1 përqind në gjithsej asetet e sistemit, u radhit i dyti për nga kontributi në gjithsej rritjen vjetore të asetëve. Sektori pensional u karakterizua me rënie të vlerës së investimeve, që u reflektua në ngadalësim të theksuar të trendit të rritjes së asetëve të këtij sektori dhe rrjedhimisht edhe në rënie e peshës/kontributit në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar (grafik 17). Ndërsa sektori i sigurimeve dhe ndërmjetësve financiar, për shkak të peshës më të ulët, kishin ndikim më të kufizuar në strukturën e përgjithshme të asetëve të sistemit përkundër përshejtimt të rritjes.

Grafik 17. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar



Viti 2022 u përmbyll me 4 institucione financiare më shumë se fundi i vitit paraprak, respektivisht me 131 institucione aktive. Në vitin 2022 filloi operimin një bankë e re me kapital vendor, duke shtuar numrin e gjithsej bankave në 12. Numri i ndihmësve financiarë (këmbimoreve) - me pjesëmarrje marginale në asetet e sistemit financiar prej 0.4 përqind - u rrit në 59 nga 53 vitin e kaluar. Ndërsa, numri i ndërmjetësuesve në sigurime u zvogëlua në 16 nga 19 një vit më parë (tabela 4).


Kapitali i huaj mbizotëron pjesën më të madhe të sektorëve të sistemit financiar, e veçanërisht sektorëve që merren me aktivitet kreditues.

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Bankat komerciale	10	10	10	10	10	11	11	12
Siguruesit	15	15	15	14	13	13	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	44	40	43	50	50	57	53	59
Ndërmjetësuesit në sigurime	18	16	16	16	18	18	19	16
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jobankare		22	25	29	29	29	30	30

Burimi: BQK.

Grafik 18. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2022



Burimi: BQK.

Sektori bankar dominohet nga kapitali me prejardhje nga BE, që përfshinë tri bankat me pjesëmarrjen më të lartë të aseteve në treg. Rritja e konkurrencës nga bankat tjera, përfshirë operimin e një bankës së re gjatë vitit 2022, ndikoi në rënien e shakllës së koncentrimit¹⁹ (njëherit peshën e bankave me prejardhje të kapitalit nga BE) në 51.9 përqind nga 52.5 përqind një vit më parë. Hyrja në treg e një banke të re me kapital vendor ndikoi që pesha e bankave vendore në gjithsej asetet e tregut të rritet në 15.1 përqind (14.5 përqind në dhjetor 2021). Bankat me origjinë nga Shqipëria rritën pjesëmarrjen në 16.1 përqind nga 14.6 përqind, duke tejkaluar pjesëmarrjen e bankave turke të cilat në dhjetor 2022 përfaqësuan 15.2 përqind të aseteve të sektorit (16.6 përqind në dhjetor 2021).

Sektori mikrofinanciar gjithashtu dominohet nga institucionet me kapital të huaj (grafik 18), si dhe karakterizohet me shkallë të lartë të koncentrimit, me ç'rast raporti i aseteve të tri institucioneve më të mëdha ndaj gjithsej

aseteve të sektorit në dhjetor 2022 ishte 56.1 përqind (56.5 përqind një vit më parë). Sektori i sigurimeve vazhdon të ketë nivel më të ulët të koncentrimit si rrjedhojë e shpërndarjes më të baraspeshuar të aseteve në treg. Sidoqoftë, gjatë katër viteve të fundit shihet një tendencë e rritjes së koncentrimit të aseteve të sektorit të sigurimeve, të ndikuar kryesisht nga revokimi i licencës së dy siguruesve (një në vitin 2019 dhe një në vitin 2021).

Kompanitë e sigurimit me kapital vendor përbëjnë 48.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit, nga 50.2 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, kompanitë me kapital të huaj me pjesëmarrje prej 51.7 përqind kanë vend të origjinës Austrinë, Slloveninë dhe Shqipërinë.

Sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë të bilancit, përkitazi me modelin tradicional të aktiviteteve, me shkallë të ulët të kompleksitetit dhe ndërlidhjes së aktiviteteve ndërmjet sektorëve të sistemit.


Sektori bankar, si një entitet qendror, ka shkallën më të lartë të ndërlidhjes me sektorë të ndryshëm. Lidhja më e fortë vazhdon të jetë me BQK-në, në formë të depozitave dhe parasë së gatshme (rezervën e detyrueshme dhe tepricën e kësaj rezerve), pasuar nga ndërlidhja me Qeverinë Qendrore në formë të investimeve në letra me vlerë. Ndërlidhja e sektorit bankar me sektorët tjerë financiar si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar në përgjithësi është i ulët, analizuar nga perspektiva e sektorit bankar (kërkesa e bankave komerciale ndaj këtyre sektorëve përbëjnë 0.2 përqind të aseteve të sektorit bankar). Sidoqoftë, depozitat që

¹⁹ Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej aseteve të sektorit.

institucionet financiare jo-bankare mbajnë në banka komerciale paraqesin ekspozim të lartë ndër-institucional për disa nga këto institucione, ndaj dhe kjo ndërvarësi thekson rëndësinë e monitorimit dhe kuptimit të efekteve të përhapjes së rreziqeve brenda sistemit financiar. Likuiditeti i sektorit bankar paraqet faktor me rëndësi në funksionimin stabil të sektorëve tjerë financiar, pasi që në kontekst të ndërlidhjeve, depozitat përbëjnë një nga kanalet kryesore për bartje të mundshme të problemeve ndër-institucionale.

Sektori financiar si tërësi ka ndërlidhjen më të lartë me sektorin qeveritar në vend, në formë të investimeve në letra me vlerë. Sektori pensional është një ndër investuesit kryesor në letrat me vlerë të qeverisë, pasuar nga BQK (përmes tregut sekondar), dhe bankat komerciale. Institucionet e tjera financiare gjithashtu kanë kërkesa ndaj Qeverisë në formë të letrave me vlerë qeveritare, ndërsa qeveria ka kërkesa (ekspozim) vetëm ndaj BQK-së dhe bankave komerciale përmes depozitave që mban në këto institucione.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës njeje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion, përjashtuar Qeverinë Qendrore ku është marrë për bazë gjithsej detyrimet që i ka në formë të letrave me vlerë ndaj këtyre institucioneve. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2022.

Dinamikat në ndërlidhjet mes akterëve të sistemit financiar në vitin 2022 kanë pësuar ndryshime të lehta krahas vitit paraprak. Lidhja kryesore me ndryshimin më të lartë ishte rënia e ekspozimit të sektorit bankar ndaj Qeverisë Qendrore, përkatësisht rënie e investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, kryesisht si rrjedhojë e ofertës më të ulët nga qeveria (figura 1). Ndërlidhja ndërmjet fondit pensional si dhe bankave komerciale dhe BQK-së shënoi rritje, e ndikuar nga rritja e


plasmanëve të fondit në këto institucione. Ky zhvillim reflekton, ndër tjera, hezitimin për investime në tregun e jashtëm, si rezultat i luhatjes së lartë në tregjet globale.

Në kuadër të ndërlidhjeve ndër-bankare, me nivel më të lartë vazhdon të qëndroj ndërlidhja në mes të sektorit bankar dhe bankave amë, si linjë proaktive për rritje të kapacitetit absorbues për humbje të mundshme, si dhe për financim.

Bankat e mëdha ekspozimet kryesore i kanë në tregjet e jashtme, ndaj bankave amë apo bankave/ institucioneve të tjera financiare (figura 2). Rritja e lartë e kreditimit mund të ketë ndikuar në faktin që njëra nga bankat e mëdha rriti më shumë detyrimet ndaj bankës amë. Por, njëra bankë ka ndërlidhje të theksuar me bankën amë në formë të kërkesave ndaj saj, përkatësisht depozitave në bankën amë dhe degët e tjera të grupit.

Bankat relativisht më të vogla kanë ekspozime të theksuara ndaj bankave më të mëdha, si dhe në nivel më të ulët ndërmjet tyre. Bankat me origjinë turke shfaqin ndërlidhje më të mëdha ndërmjet vete. Kryesisht ndërlidhjet ndërmjet bankave janë në formë të depozitave, të huazimeve afatshkurtra dhe në nivel më të vogël huave.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës njeje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion bankar, përjashtuar bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2022.

4.1. Aktiviteti bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2022 u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit, përkundër vazhdimin të ballafaqimit me rreziqe të rritura si rezultat i zhvillimeve jo të favorshme gjeopolitike dhe makroekonomike. Presionet e vazhdueshme inflacioniste dhe rreziqet përcjellëse nuk u materializuan në aktivitetin dhe performancën e sektorit.


Asetet e sektorit bankar u rritën për 13.5 përqind nga viti paraprak, dhe arritën vlerën prej 6.76 miliardë euro. Aktiviteti kreditor vazhdoi përsheptimin, duke shënuar rritjen vjetore më të lartë në njëmbëdhjetë vitet e fundit. Bilanci me bankat tjera ishte komponenta e dytë radhazi për nga kontributi në përsheptimin e rritjes së aseteve, përderisa zërat tjerë ngadalësuan ritmin rritës. Investimi në letra me vlerë ngadalësoi rritjen vjetore në 9.8 përqind nga 17.2 përqind në vitin paraprak, të ndikuar nga rënia e investimeve në letra me vlerë vendore, përderisa letrat me vlerë në tregun e jashtëm shënuan rritje të theksuar prej 30.6 përqind. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në po ashtu ngadalësoi rritjen, në 4.3 përqind nga 6.2 përqind në vitin paraprak, që sugjeron për orientim të mjeteve në instrumente me kthim më të lartë financiar si kompenzim për huambjet/zhvlerësimin nga inflacioni.

Sektori nuk ka pësuar ndryshime strukturore në anën e aseteve ndër vite, me përjashtim të nënkategorisë së letrave me vlerë që shënoi rritje nga viti 2012 si rezultat i fillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjes aktive të bankave në këtë treg (grafik 19). Në vitin 2022, investimet e sektorit bankar në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës shënuan rënie vjetore prej 14.9 përqind krahasuar me rritjen për 22.6 përqind në vitin paraprak, të ndikuar kryesisht nga oferta më e ulët.

Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, të cilat këtë vit shënuan ngadalësim të rritjes, përkundër trendit


të përsheptuar rritës të gjithsej depozitave.

Grafik 19. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve



Gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore të përsheptuar prej 13.3 përqind (rritje prej 12.4 përqind në dhjetor 2021) dhe arritën vlerën 5.6 miliardë euro. Depozitat e dy segmenteve dominuese në strukturën e gjithsej depozitave - ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare - shënuan ngadalësim të rritjes, por rritja e lartë në depozitat e korporatave financiare, korporatave publike si dhe depozitave nga jorezidentët, përcaktuan trendin e përsheptuar rritës të gjithsej depozitave. Në fund të viti 2022, depozitat përfaqësuan 82.3 përqind të burimeve të financimit të sektorit bankar (grafik 20).

Grafik 20. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake



Depozitat e ekonomive familjare, kategoria që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar me pjesëmarrje 65.7 përqind në dhjetor 2022, ngadalësuan rritjen në 8.3 përqind nga 14.6 përqind një vit më parë.

Trendi i ngadalësuar i rritjes së depozitave të ekonomive familjare mund të jetë ndikuar nga

shpenzimet më të larta të ekonomive familjare gjatë këtij viti si rezultat i rritjes së lartë të çmimeve, përderisa të ardhurat/pagat mbetën në nivel e njejtë ose u rritën në shkallë shumë më të ulët.

Depozitat e korporatave jofinanciare, të dytat për nga pjesëmarrja në strukturën e depozitave, shënuan rritje të ngjashme vjetore, përkatësisht ngadalësim të lehtë të shkallës së rritjes në 19.0 përqind nga 19.3 përqind në vitin 2021.


Korporatat tjera financiare shënuan rritje vjetore të lartë të depozitave, prej 52.2 përqind, krahasuar me rënie vjetore prej 25.3 përqind në vitin paraprak. Të gjithë sektorët në kuadër të kësaj kategorie (fondet pensionale, sektori i sigurimeve si dhe ndërmarrjet tjera financiare) u karakterizuan me rritje të depozitave, por kontributin kryesor në gjithsej rritjen e lartë e kishin fondet pensionale.

Viti 2022 u karakterizua me rritje të depozitave të reja, përkatësisht depozitave të afatizuara, si rezultat i rritjes së normës së interesit në depozita. Gjithashtu, inflacioni i vazhdueshëm dhe pasiguritë rreth perspektives ekonomike mund të kenë rritur nevojën për kursim duke dekurajuar investimin.

Depozitat e reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, arritën në vlerën prej 421.4 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind, përderisa vitin paraprak kishte rënie vjetore prej 24.0 përqind (grafik 21). Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së normave të interesit në depozita për këtë kategori, të cilat u rritën nga bankat në përpjekje për të mbajtur depozitat/financimin për mbështetjen e shkallës së lartë të kreditimit në vend, në rrethana të rritjes së kostos së financimit nga jashtë. Ngjashëm, depozitat e reja të korporatave jofinanciare u rritën në 356.2 milionë euro nga 106.2 milionë në vitin 2021.

Ofertat e favorshme për tërheqjen e depozitave të afatizuara nga sektori bankar pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2023, sugjeruar nga Anketa e Kreditimit Bankar, duke ndikuar në rritjen e më tejshme të depozitave të afatizuara në strukturën e financimit të sektorit.


Grafik 21. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Burimi: BQK.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje në vitin 2023, por në aspekt të pjesëmarrjes vazhdon të jetë relativisht i ulët. Pozicioni neto kreditor ndaj sektorit të jashtëm arriti në 739.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 26.4 përqind për dallim nga rënia prej 4.6 përqind në vitin paraprak (grafik 22 dhe 23). Rritja e pozicionit neto kreditor gjatë vitit 2022 i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë në sektorin e jashtëm, të cilat shënuan rritje më të theksuar, pasuar nga investimi në depozita dhe kredi.


Grafik 22. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve



Burimi: BQK.

Kërkesat ndaj jo rezidentëve zënë 15.6 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar, ku 87.5 përqind e tyre janë depozita dhe investime në letra me vlerë. Detyrimet e sektorit bankar ndaj jo rezidentëve zënë 4.7 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar, në formë të linjave kreditore dhe depozitave të sektorit të jashtëm të mbajtura në vend. Këto dy zëra përbëjnë 99.5 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj jo-rezidentëve.

Grafik 23. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK.

Sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Niveli i ulët i asetëve në valutë të huaj zvogëlon më tej efektet e bartjes së problemeve nga sektori i jashtëm si dhe eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet jo të favorshme në kurset e këmbimit kundrejt valutës euro.

4.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar përshejtoi rritjen, duke shënuar shkallën më të lartë të rritjes në njëmbëdhjetë vitet e fundit. Kjo dinamikë u ndikua nga zhvillimet në gjysmën e parë të vitit që u karakterizua me rritje më të theksuar, përderisa në gjysmën e dytë është shënuar ngadalësim i trendit rritës. Presionet e vazhdueshme inflacioniste si dhe pasiguritë rreth aktivitetit ekonomik pritet të ndikojnë në rënie të kërkesës për kreditim në vitin 2023.


Dinamika e aktivitetit kreditues, gjatë pjesës më të madhe të vitit 2022, sipas anketës së kreditimit bankar, u përcaktua kryesisht nga lëvizjet në kërkesën kreditore. Oferta kreditore përgjithësisht është shtrënguar në gjysmën e dytë të vitit, ndikuar nga rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë në tregun vendor dhe tregjet globale. Faktorët që mbështetën ofertën kreditore gjatë vitit ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, presionet e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

Rritja e theksuar e kërkesës kreditore nga ndërmarrjet u nxit nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe

investimeve fikse, përderisa për ekonomitë familjare kërkesën për kredi e ndikoi kërkesa për financimin e shpenzimeve të konsumit dhe perspektiva e tregut të patundshmërive. Kërkesa nga ana e ekonomive familjare ishte e lartë, përkundër pritjeve të vazhdueshme të bankave për rënie të kërkesës, të ndikuar nga pasiguritë e larta rreth dinamikave në ekonominë e vendit.

Sentimenti i bankave për vitin 2023 përsëri sugjeron për kërkesë më të ulët sidomos nga ekonomitë familjare, si dhe vazhdimësi të operimit në ambient me pasiguri të larta, të cilat pritet të reflektohen gjithashtu në anën e vigjilencës së shtuar në procedurat e brendshme për analizimin e kërkesave për kredi, si dhe ofertë më të shtrënguar kreditore.

Grafik 24. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 4.35 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.1 përqind. Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 15.7 përqind, që përkon me përshejtim të trendit vjetor të rritjes për 2.6 pikë përqindje. Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 16.7 përqind, që në krahasim me vitin paraprak paraqet ngadalësim të rritjes për 1.9 pikë përqindje (grafik 24).

Kreditë e reja shënuan ngadalësim të trendit rritës duke u kthyer në nivelet e rritjes së viteve parapandemike. Rritja në kreditë e reja ishte e lartë në tremujorin e parë të vitit, por në pjesën pasuese, pas shpërthimit të luftës në Ukrainë dhe rritjes së presioneve inflacioniste, kishte ngadalësim, përkatësisht rënie vjetore të kredive të reja. Trendi i rritjes së kredive të

reja u ngadalësua në 6.5 përqind, krahasuar me rritjen e theksuar prej 22.9 përqind në vitin 2021. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga dinamikat e kredive të reja në tremujorin e katërt, i cili u karakterizua me rënie vjetore të kredive në dy segmentet - korporata jofinanciare dhe ekonomi familjare.

Grafik 25. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro



Burimi: BQK.


Përgjithësisht gjatë vitit 2022, sektori i ekonomive familjare u karakterizua me rritje vjetore shumë më të ngadalësuar, prej vetëm 2.4 përqind krahasuar me rritjen 45 përqind në vitin 2021, përderisa kreditë e reja të korporatave jofinanciare u rritën për 9.6 përqind nga 10.4 përqind në vitin 2021 (grafik 25). Në vitin 2022 ka pasur rritje të përdorimit të produkteve kreditore si mbitërheqjet dhe linjat kreditore, si nga korporatat jofinanciare, ashtu edhe nga ekonomitë familjare, duke sugjeruar për rritje të nevojës së financimit emergjent/afatshkurtër.³

Me rritje të kreditimit u karakterizuan të gjithë sektorët ekonomik, ndër të cilët rritjen më të lartë të kreditimit e kishin prodhimitaria dhe ndërtimtaria. Në dhjetor 2022, kreditimi ndaj sektorit të prodhimitarisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare, si rezultat i rritjes së lartë vjetore prej 29.4 përqind. Sektori i tregtisë shënoi rritje vjetore prej 10.3 përqind dhe ishte i dyti për nga kontributi në rritjen e kredive për korporatat jofinanciare. Sektori i ndërtimtarisë shënoi rritje të përshpejtuar prej 21.1 përqind, përkundër sfidave me të cilat u

përball ky sektor për shkak të rritjes së lartë të inflacionit – rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore. Sektori i bujqësisë këtë vit u karakterizua me rritje pozitive prej 9.7 përqind, për dallim nga rënia e theksuar në vitin paraprak.

Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë ka pjesëmarrjen më të lartë ndër vite, pasuar nga ai i prodhimitarisë dhe i ndërtimtarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht duke rritur pjesëmarrjen. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje të ulët (grafik 26).

Grafik 26. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Sektori i prodhimit është mbështetur në vitin 2022, përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike, përkatësisht masës së subvencionimit të kredive investive për bizneset prodhuese. Zbatimi i kësaj mase gjatë këtij viti mund të ketë kontribuar në përshpejtimin më të lartë të rritjes së kredive për prodhim.


Mbështetës i rëndësishëm i kreditimit ndaj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme vazhdon të jetë Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfytëzueshmëria e të cilit ka vazhduar rritjen graduale. Rritja vazhdoi në vitin 2022, por në shkallë më të ulët krahasuar me vitin paraprak për shkak të mbylljes së dritares së Rimëkëmbjes Ekonomike²⁰ në fund të vitit 2021. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, në fund të vitit 2022 arriti në 12,084, me shumë totale prej 506.3 milionë euro. Me përkrahje edhe të donatorëve, në vitin 2022

²⁰ Pako e ofruar nga Qeveria e Kosovës, në kuadër të masave për mbështetjen e ndërmarrjeve për tejkalimin e sfidave të krijuara nga gjendja pandemike.

janë krijuar dritare të reja me të cilat kanë në fokus mbështetjen e sektorëve dhe profileve të ndryshme të ndërmarrjeve, siç janë dritarja Grow - dritare e Rimëkëmbjes dhe Mundësive të Gjellërta, dritarja e eksportit, dritarja e grave në biznes si dhe dritarja e ndërmarrjeve të reja – StartUp.

Kryesisht, struktura e kredive të garantuara nga FKGK është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar. Krahasuar me vitin paraprak, sektori i prodhimit zvogëloi pjesëmarrjen ndërsa sektori i shërbimeve, bujqësisë dhe i ndërtimitarisë shënuan rritje të lehtë. (grafik 27).

Grafik 27. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK



Burimi: FKGK.


Në kuadër të kredive të reja për ekonomitë familjare, kreditë konsumuese shënuan rënie vjetore për dallim nga rritja e theksuar në vitin paraprak, ndërsa kreditë hipotekare ngadalësuan trendin rritës. Deri në dhjetor 2022, kreditë e reja konsumuese shënuan rënie vjetore prej 6.3 përqind (rritje 40.3 përqind në vitin 2021), ndërsa kreditë hipotekare ngadalësuan rritjen në 13.5 përqind nga 56.5 përqind rritje një vit më parë.

Kreditë afatgjata kanë rritur gradualisht pjesëmarrjen në gjithsej stokun e kreditimit, duke dominuar pjesëmarrjen në gjithsej strukturën e kredive sipas maturitetit.²¹Rritja e kredive afatgjata ishte më e theksuar në dy vitet e fundit, ndikuar nga rritja e kredive hipotekare të cilat kanë maturitet më të gjatë.

²¹ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

Në dhjetor 2022, këto kredi shënuan rritje vjetore prej 22.8 përqind (rritje 20.4 përqind në vitin 2021), dhe përfaqësuan 55.0 përqind të gjithsej kredive. Kreditë me maturitet afatmesëm ngadalësuan rritjen vjetore për 1.7 pikë përqindje (7.9 përqind rritje vjetore) dhe ngushtuan pjesëmarrjen në 34.1 përqind. Ndërsa kreditë afatshkurtra shënuan shkallë të ngjashme të rritjes prej 11.6 përqind (11.8 përqind në vitin 2021) dhe kishin pjesëmarrje prej 10.8 përqind në gjithsej kreditë (11.2 përqind në dhjetor 2021).


Grafik 28. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Kreditë afatshkurtra dhe ato me afat të mesëm maturiteti janë kryesisht të dominuara nga kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare (grafik 28), përderisa kreditimi afatgjatë është kryesisht karakteristikë e portofolios kreditore të segmentit të ekonomive familjare (grafik 29).

Grafik 29. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar²²

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar²³ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës tetor - dhjetor 2022 (referuar si TM4 2022)²⁴, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën janar - mars 2023 (referuar si TM1 2023).


Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë TM4 2022, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht, në nivel më të

lartë nga kërkesa e rritur për kredi, ndërkohë që oferta kreditore nuk kishte ndryshime të rëndësishme.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan standarde kreditore të pandryshuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e katërt të vitit 2022.

Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat pritjet të aplikojnë ndryshime marginale në standardet kreditore, kryesisht ndryshime pozitive për NVM-të dhe negative për ndërmarrjet e mëdha (grafik 1).

Grafik 1. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Në kontekst të pritjeve për ngadalësim ekonomik, rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë në tregjet globale patën kontributin negativ kryesor në standardet kreditore. Në anën tjetër, faktorët që patën ndikim deri në një masë pozitiv në standardet kreditore ishin pozita e mirë e likuiditetit të sektorit, presionet e konkurrencës në mes të bankave, si dhe mbështetja nga FKGK.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive kishin lëvizje marginale për të dy segmentet e ndërmarrjeve. Konkretisht, u aplikua lehtësim marginal për kërkesën për

kolateral, si rezultat i mbështetjes së FKGK-së dhe presionit të konkurrencës (grafik 2).

Në tremujorin e parë të vitit 2023, bankat pritjet të aplikojnë ndryshime në kushtet dhe rregullat kryesisht për NVM-të, duke rritur normën e interesit në kredi në njërin anë dhe duke lehtësuar kërkesën për kolateral në anën tjetër. Ndryshimet pozitive në kushtet dhe rregullat e kredive për ndërmarrjet pritjet të nxiten nga mbështetja nga FKGK dhe presionet e konkurrencës, përderisa ndryshimet negative pritjet të nxiten nga perspektiva jo e mirë në tregun global dhe vendor, si dhe pritjet për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore.


²² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës 9 banka që operojnë në Kosovë dhe përfaqësojnë 99.9 përqind të kreditimit të gjithëj sektorit. Anketa realizohet në baza tremujore. Kjo anketë përfshinë periudhën tetor - dhjetor 2019 dhe pritjet për periudhën janar – mars 2020.

²³ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithëj portfolion kreditore të

sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në ëeb faqen e BQK.

²⁴ Periudhës tetor - dhjetor i referohemi si 'tremujori i katërt' – TM4, ndërsa periudhës janar - mars i referohemi si 'tremujori i parë' – TM1.

Grafik 2. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve




Burimi: BQK.

Gjatë periudhës raportuese, kishte rritje të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet në nivel dukshëm më të lartë në krahasim me tremujorin paraprak. Rritja e kërkesës për ndërmarrjet i atribuohet kryesisht kërkesës nga NVM-të, përderisa për ndërmarrjet e mëdha kishte rritje marginale (grafik 3). Kjo rritje e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punes. Raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u përmirësua lehtësisht gjatë TM4 2022 sipas deklaratave të bankave në anketë duke gjeneruar një indeks të ulët negativ.

Pasiguritë në perspektivën në vend dhe jashtë tij po diktojnë pritjet e bankave sa i përket ndryshimeve në kërkesën për kredi. Rrjedhimisht, gjatë tremujorit të parë 2023 bankat presin një hezitim për ndërmarrjen e borxheve bazuar në indeksin marginal të gjeneruar, e që nënkupton lëvizje jo të rëndësishme të kërkesës për kredi, nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve, në krahasim me tremujorin aktual.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditorë të ndërmarrjeve, bankat presin që gjatë tremujorit të parë raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të rritet ku përgjigjet gjeneruan indeks të lartë pozitiv.

Grafik 3. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Sa i përket afatit kohor të kredive, rezultatet e anketës tregojnë se rritje më të madhe të kërkesës nga ndërmarrjet gjatë kësaj periudhe kishte për kreditë afatshkurtra. Kërkesa për kredi afatgjata nuk kishte ndryshime të rëndësishme. Përderisa, oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive, tregoi shtrëngim për kreditë me maturitet afatgjatë, dhe mbeti kryesisht e pandryshueshme për kreditë me maturitet afatshkurtër. Në tremujorin e ardhshëm, bankat presin lehtësim në nivel të ulët të

standardeve kreditorë kryesisht për kreditë afatshkurtra. Ndërsa sa i përket kërkesës, bankat nuk presin ndryshim të rëndësishëm të kërkesës për kredi në aspekt të maturitetit, ai afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë (grafik 7).


Dinamikat e aktivitetit kreditorë për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u mbështetën kryesisht nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore kishte ndryshime marginale. Standardet kreditorë të aplikuara gjatë

shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan marginalisht për të dy llojet e kredive (grafik 4). Ky ndryshim u shpreh nga një bankë me rëndësi sistemike e cila u mbështet në uljen e rrezikut nga kolaterali i kërkuar, kryesisht

si pasojë e marrëveshjeve me kompanitë ndërtimore.

Pritjet e bankave për TM1 të vitit 2023 nuk japin ndryshime të rëndësishme të standardeve kreditore për të dy llojet e kredive për ekonomitë familjare.

Grafik 4. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan deri në një masë. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në një nivel të njëjtë për të dy llojet e kredive. Saktësisht, bankat aplikuan shtrëngime përmes rritjes së normës së interesit.

Ndërsa, lehtësim marginal u aplikua në kërkesat për kolateral. Faktori kryesor në rritjen e normës së interesit ishte perspektiva jo e mirë e tregjeve globale, e që për pjesën më të madhe të bankave nënkupton rritjen e normës së EURIBOR-it, normë e aplikuar në kreditë më normë variable të interesit (grafik 5).

Grafik 5. Rregullat dhe kushtet e aplikuar për kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Për tremujorin e parë të vitit 2023, bankat në përgjithësi presin shtrëngime marginale në kushtet dhe rregullat për kredi të ekonomive familjare. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë më të lartë për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për të dy kategoritë

pritet të shtrëngohen përmes rritjes së normës së interesit, edhe pse në nivel dukshëm më të ulët se sa vlerat për TM4 2022, dhe të lehtësohen në nivel të ulët kërkesat për kolateral.

Grafik 6. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare. Të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare kishin rritje të përafërt të kërkesës (grafik 6). Nevoja për financim të konsumit dhe perspektiva e tregut të patundshmërive ishin faktorët që kontribuan pozitivisht, përderisa rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive ishte faktor që kontribuoi negativisht kërkesën kreditore. Sipas anketës, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare kishte rënie, e i cili për tremujorin vijues pritet të ndërroj kahjen duke gjeneruar indeks të lartë pozitiv. Pritje kryesisht të ndikuara nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e

rrjedhimisht edhe nga rënia e fuqisë blerëse të klientëve.

Në tremujorin e parë të vitit 2023, bankat nuk presin lëvizje të mëdha në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare. Bankat në përgjithësi presin lëvizje negative marginale të kërkesës për kredi, saktësisht këto lëvizje reflektojnë pritjet për rënie marginale të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që rënia e konfidencës së klientëve për kapacitetin e ripagimit të kredive të ndikojë deri në një masë rënien e kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm.

Grafik 7. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se ekonomitë familjare gjatë TM4 2022 kishin rritje më të lartë të kërkesës për kreditë me maturitet afatshkurtër, se sa për atë afatgjatë.

Gjithashtu, oferta kreditore për ekonomitë familjare e ndarë sipas maturitetit të kredive rezulton të jetë lehtësuar në masë më të madhe për kreditë

afatshkurtra. Bankat presin që në tremujorin e ardhshëm lehtësimi në ofertën kreditore do të orientohet në nivel më të lartë drejt kredive afatshkurtra, se sa në kreditë afatgjata. Përderisa, presin rënie të kërkesës për kreditë afatgjata dhe kërkesë pothuajse të pandryshuar për kreditë afatshkurtëra (grafik 7).

Grafik 8. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar


Burimi: BQK.

Bankat raportuan rritje të theksuar të **qasjes në financim** gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, duke tejkaluar nivelin e shënuar në tremujorin e kaluar (TM3 2022). Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistemike deklaruan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve. Ndërsa, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare shënoi rënie marginale. Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi i

financimit me rritjen më të lartë gjatë këtij tremujori. Për tremujorin e ardhshëm TM1 2023, bankat presin rritje të qasjes në financim mirëpo në një nivel dukshëm më të ulët se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar, pasuar nga financimi nga tregjet e parasë. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin në këtë tremujor rritjen e financimit t'a dominojnë depozitat me maturitet afatgjatë. Dinamikë e nxitur nga ofertat e favorshme për tërheqjen e depozitave të afatizuara nga sektori bankar (grafik 8).

5. Rreziqet e sektorit bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2022 u ndodh në dinamika të reja të krijuara nga inflacioni i rritur, i shkaktuar fillimisht nga pasojat e pandemisë dhe intensifikuar më pas nga kriza gjeopolitike. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend gjatë vitit 2022 rezultoi të jetë neutralizuar deri në një masë nga dinamikat pozitive që karakterizuan aktivitetin e ndërmarrjeve, rritja e remitancave, rritja e kreditimit dhe performanca e mirë kreditore e huamarrësve.

Pasiguritë që kanë shoqëruar dinamikat makroekonomike, si shkalla e inflacionit dhe dobësimi i kërkesës së përgjithshme, mbetën evidente edhe tutje në vitin 2023, ndërkohë që pasojat në tkurrjen e të ardhurave reale të disponueshme kanë rritë ndjeshmërinë si ndaj rrezikut kreditor, ashtu edhe atij të likuiditetit. Tutje, shtrëngimi i politikave monetare nga bankat qendrore në nivel global, si kundërpërgjigje ndaj shkallës së inflacionit, janë përkthyer në rritje të kostos së financimit, duke krijuar presion si në ruajtjen e likuiditetit të bankave ashtu edhe në profitabilitetin e tyre.


Sektori bankar u ekspozua ndaj rritjes së disa rreziqeve që ndërlidhen me mospërputhje nga rritjet në disa pozicione bilancore. Më konkretisht, rritja më e shpejtë e kreditimit ka rritur asetet me peshë rreziku, rritja depozitave të afatizuara dhe rritja e normave të interesit ka rritur kostot e financimit me efekte në profit dhe kapital, si dhe rritja e depozitave me maturitet deri në 5 vite dhe rritja e kreditimit mbi 10 vite ka ndikuar në zgjerimin e mospërputhjeve në afatet e maturimit në mes të aseteve dhe detyrimeve. Megjithatë, që të gjithë treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar qëndruan në

pozita të favorshme për të mbështetur sektorin në rast të materializimit të rreziqeve.

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, i elaboruar në vijim, bënë vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar, që reflektojnë stabilitetin e tij në periudhën e fundit në raport me gjendjen historike ndër vite.

Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas. Indeksi është kalkuluar në baza tremujore, përmes të cilit vlerësohet nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut.²⁵

Grafik 30. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare është shënuar rritje vjetore e ndjeshmërisë ndaj rreziqeve (grafik 30). Rritja e përgjithshme e ekspozimit ndaj rreziqeve u ndikua nga indikatorët me rritje rreziku si ai i solvencës dhe likuiditetit. Ndërsa, rënie u shënuar në indikatorët e rrezikut kreditor, profitabilitetit, dhe tregut. Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës i atribuohet nivelit më të ulët të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, për shkak të rritjes më të lartë të aseteve të peshuara me rrezik që rezultojnë nga kreditimi më i lartë, ndërkohë që edhe kapitali rregullator kishte shënuar rritje (grafik 31). Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit i atribuohet nivelit më të ulët të

²⁵ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.


treguesve të likuiditetit, si raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Rritja e depozitave afatshkurta ka ndikuar që detyrimet afatshkurtra të jenë rritur më shpejtë kundrejt rritjes së mjeteve likuide.

Kurse, rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor ishte si rezultat i rënies vjetore të raportit të kredive jo-performuese, dinamikë kryesisht e ndikuar nga rritja më të theksuar e kreditimit, megjithëse edhe stoku i kredive jo-performuese ka shënuar rritje. **Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit** i atribuohet profitit më të lartë të realizuar nga të hyrat e interesit dhe jo-interesit (tarifat dhe komisionet), që tejkalon rritjen e shpenzimeve përgjatë vitit.

Indikatori që vlerëson **ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut**, i matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, po ashtu ka shënuar rënie. Megjithatë, ky indikator ka edhe ashtu peshë shumë të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar (grafik 31).

Indeksi i përgjithshëm i agreguar sugjeron rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, krahasuar me mesataren historike të indeksit (2008–2021), por edhe me mesataren e pesë viteve të fundit. Përkundër zhvillimeve pozitive gjatë vitit, në tremujorin e dytë dhe të tretë ndjeshmëria ndaj rreziqeve ishte më e theksuar për shkak të intensifikimit të inflacionit dhe pasojave të ndjera si rezultat.

Grafik 31. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriteve të rreziqeve



Gjithsesi, gjendja e treguesëve të shëndetit të sektorit bankar në mbyllje të vitit mbetet e kënaqshme, meqë sugjeron për kapacitet përballues të rreziqeve ndaj të cilave

potencialisht mund të përballet sektori në vitin vijues.


5.1. Rreziku kreditor

Dinamikat e përgjithshme që ndikojnë dimensionin e rrezikut kreditor, gjatë vitit 2022, u karakterizuan nga rritja e përgjithshme e nivelit të çmimeve dhe rritja e ngadalësuar ekonomike, dinamika që u përkeqësuan më tej me rritjen e tensioneve gjeopolitike e më vonë, me shtrëngimin e politikave monetare si masë kundër inflacionit, masë që rezultoi në rritje të kostos së financimit, përderisa pritjet e bankave komerciale sugjeronin për materjalizim të rrezikut kreditor në gjysmën e dytë të vitit 2022, si pasojë e dinamikave makroekonomike, përkeqësim i portoflios kreditore është evidentuar vetëm në tremujorin e fundit të vitit. Ruajta e performancës së mirë financiare e rrjedhimisht, edhe aftësisë ripaguese, i është atribuar deri në një masë bartjes së kostos së rritur nga ndërmarrjet tek konsumatori final, ndërkohë që kapacitetin absorbues të konsumatorëve vlerësohet ta kenë mbështetur të hyrat nga diaspora dhe masat lehtësuese qeveritare përgjatë vitit.

Ndonëse trendi i treguesve kyç të cilësisë së portfolios kreditore tregon për rrezik të ulët kreditor, pasiguritë e shtuara nga ecuria e nivelit të çmimeve dhe rritja e vlerës së kredive jo performuese në fund të vitit 2022 e vendosin rrezikun kreditor si rreziku më eminent i sektorit bankar dhe stabilitetit financiar. Norma e KJP-ve vazhdoi trendin rënës prej vitit 2021, edhe pas përfundimit të fazës së fundit të ristrukturimeve për zbutjen e efekteve të pandemisë në janar-shkurt të vitit 2022. Norma e KJP-ve shënoi rënie në 2.0 përqind në fund të vitit, nga 2.3 përqind sa ishte një vit më parë. Rritja e përsheptuar e kreditimit ka ndikuar në përmirësimin e indikatorit të rrezikut kreditor, ngaqë vlera e kredive jo-performuese shënoi rritje në krahasim me vitin paraprak. Vlera e KJP-ve u rrit për 4.5

përqind në 87.9 milionë euro (nga 84.1 milionë euro në vitin 2021) (grafik 32), kundrejtë kreditimit që shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind (15.3 përqind në vitin 2021 dhe 7.4 përqind në vitin 2020). Sipas rezultateve të anketës së kreditimit bankar, sentimentimi i bankave qysh prej tremujorit të tretë tregonte për besimin që ato kanë në kapacitetin absorbues të klientëve të tyre, në periudhën afatshkurtër, pritje të cilat i bazuan në procesin e tyre të shqyrtimit të aplikacioneve për kredi dhe monitorimit të shtuar gjatë kësaj periudhe. Përkundër besimit në klientë, bankat duke u bazuar në rritjen e vazhdueshme të presioneve inflacioniste gjatë vitit, deklaruan se presin përkeqësim të aftësisë ripaguese të klientëve në gjysmën e dytë të vitit. Në fakt, këto pritje u materializuan në tremujorin e katërt ku vlera e KJP-ve ndërroj kahje nga trendi rënës i tre tremujorëve të parë në trend në rritje. Shumica e bankave kishin zvogëlim të kredive të reja jo-performuese në baza mujore dhe krahasuar me vitin paraprak, kumulativi i kredive të reja jo-përformuese ishte për 73.0 përqind më i ulët se në vitin paraprak (477.3 mijë euro nga 1.8 milion euro në vitin 2020). Përjashtim bën performanca e muajit dhjetor që regjistroi nivel më të lartë të kredive të reja jo-performuese dhe atë në shumicën e bankave.

Grafik 32. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive joperformuese




Burimi: BQK.

Megjithëse rreziku kreditor vlerësohet të jetë rreziku eminent që i kanoset sektorit bankar, në nivelet e klasifikimeve kreditore ende nuk është reflektuar materjalizimi i tij. Për më tepër, në vitin 2022 është shënuar përmirësim i performancës së kredive nga kategoria me

cilësinë më të ulët të klasifikimit drejtë asaj me cilësi më të lartë, përkatësisht nga shtylla 2 drejt shtyllës 1 të klasifikimit kreditor.

Pjesëmarrja e kredive në shtyllën e dytë të klasifikimit kreditor u zvogëluar në 6.8 përqind në dhjetor 2022 nga 8.6 përqind në dhjetor 2021, ndërsa kreditë në shtyllën e parë rritën pjesëmarrjen në 91.2 përqind nga 89.1 përqind (grafik 33).


Grafik 33. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla



Burimi: BQK.

Në dhjetor 2022, ekspozimet kreditore pa vonesa (vonesat më pak se 30 ditë), kanë rritur lehtësisht pjesëmarrjen në 97.6 përqind nga 97.2 përqind në dhjetor 2021. Kreditë me vonesa 30 deri në 90 ditë kishin rënie marginale të pjesëmarrje prej 0.1 pikë përqindje në 0.4 përqind të gjithsej kredive. Ndërsa, kreditë jo-performuese (me probabilitet të ulët të pagesës, si dhe ato me vonesa mbi 90 ditë) kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 2.0 përqind nga 2.3 përqind në dhjetor 2021 (grafik 34).

Grafik 34. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re



Burimi: BQK.

Rritja e presioneve inflacioniste nxiti bankat për menaxhim më prudent të kreditimit. Në këtë aspekt, bankat u treguan më konservative


në ndarjen e rezervave dhe klasifikimin e sektorëve më të prekur, si dhe shtrënguan kriteret për kreditim të ri. Ndërkohë që korporatat dhe NVM-të në vend, marrë për bazë pyetësorët e realizuar nga bankat me klientët e tyre, kanë raportuar në vazhdimësi që një ndër rreziqet kryesore që ju kanoset performancës së tyre vjen nga tregu i punës (disponueshmëria e fuqisë punëtore dhe hendeku në shkathtësi), ky rrezik pritet të rritet tutje në vitin 2024. Bankat kanë faktoruar rrezikun në rritje nga migrimi tash e dy vite, ndërkohë që me miratimin e lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës në shtetet e shengenit me fillim nga viti 2024 ky rrezik mund të përkeqësohet tutje. Bazuar në zhvillimet në vendet e rajonit pas liberalizimit të vizave, valë të lëvizjeve të fuqisë punëtore priten të ndikojnë në disbalancë të tregut të punës, me pasoja në performancën dhe profitabilitetin e bizneseve e tutje në kapacitetin ripagues të borxhit të tyre. Prandaj, dimensionin e rrezikut kreditor duhet të jetë në fokus të veçantë në periudhat në vijim, marrë parasysh rritjen e faktorëve që kanë pasoja direkte në përkeqësimin e tij e tutje, në stabilitetin e përgjithshëm financiar të vendit.

Ekonomitë familjare dhe segmenti i ndërmarrjeve shënuan rënie të raportit të kredive jo performuese. Raporti i kredive jo-performuese për ekonomitë familjare zbriti në 1.2 përqind nga 1.3 përqind në vitin paraprak. Rritja dyshifrore e kreditimit për segmentin e ekonomive familjare në vitet e fundit, përjashtuar vitin 2020, në kushtet kur të hyrat e përgjithshme në ekonomi nuk rezultojnë të jenë rritur njëtrajtësisht, është vlerësuar si rrezik kreditor në rritje. Rritja e shpejtë e kreditimit (16.6 përqind) rezulton të ketë neutralizuar rritjen e vlerës së kredive joperformuese për këtë segment (5.5 përqind) dhe ndikuar në rënien e normës së KJP-ve për 0.1 pikë përqindje (grafik 35).

Poashtu edhe segmenti i ndërmarrjeve ka shënuar përmirësim të cilësisë kreditore, ku norma e KJP-ve zbriti në 2.5 përqind nga 2.8 përqind një vit më parë. Vlera e kredive joperformuese të këtij sektori u rrit për 4.4

përqind, ndërsa kreditë shënuan rritje për 15.6 përqind. Sipas AKB-së, performanca e qëndrueshme financiare e rrjedhimisht, edhe kapaciteti ripagues i mirë i segmentit të ndërmarrjeve i atribuohet bartjes së kostos shtesë të çmimeve furnizuese/lëndës së parë tek konsumatori përfundimtar. Megjithëse efekti direkt i çmimeve më të larta të inputeve është bartë tutje, rritja e çmimeve të produkteve finale rezulton të ketë ngadalësuar kapacitetin konsumues dhe kërkesën e përgjithshme në ekonomi, me pasoja edhe në ciklin financiar.

Grafik 35. Kreditë joperformuese




Burimi: BQK.


Zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore, bazuar në raportin e KJP-ve të sektorëve ekonomik ishin pozitive, të ndikuara kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit në pjesën më të madhe të sektorëve (grafik 36). Sektori i bujqësisë, i cili karakterizohet me normën më të lartë të KJP-ve, shënoi po ashtu edhe rënie më të lartë për 2.1 pikë përqindje duke zbritur në 5.0 përqind. Sektori i tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, shënoi rënie marginale të normës së KJP-ve për 0.1 pikë përqindje. Rritje në normën e KJP-ve shënuan sektori i minierave me 0.5 pikë përqindje, si dhe sektori i shërbimeve financiare dhe sektorët tjerë, saktësisht me rritje prej 0.4 pikë përqindje.

Pritjet për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore mbeten evidente edhe për vitin 2023, bazuar në shkallën e lartë të inflacionit dhe dobësimin e të ardhurave në dispozicion përgjatë dy viteve të fundit, rënien e kapacitetit konsumues për pasojë, potencialisht,

kapacitetit ripagues. Ndërkohë që ekonomitë familjare pritet të ndikohen më së shumti si segment, veçanërisht ato me të ardhura më të ulëta, sektori i ndërtimit dhe i prodhimit pritet të ndikohen edhe nga rreziku i migrimit.



Kundrejtë rajonit, sektori bankar në vend vazhdon të ketë performancë shumë më të mirë të ripagimit të kredive. Ndër vite, Kosova qëndron me raportin më të ulët të kredive jo-performuese krahasuar me vendet e rajonit, të cilat kanë kaluar nëpër fazë disa vjeçare të përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditorë (grafik 37).



Sidoqftë, ambienti i përgjithshëm makroekonomik me rritje më të dobët ekonomike dhe shkallë të lartë të inflacionit rrezikon të përmbysë progresin e arritur ndër vite. Magnituta e përkeqësimit të cilësisë kreditorë kryesisht do të varet nga mënyra e menaxhimit të një situate të tillë në kuptimin


²⁶ Raport i gjithsej Ekspozimeve të mëdha kreditorë ndaj Kapitalit të Klasit të parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm ose grup të ndërlidhur personash, vlera e të cilit

e ndërmarrjes së masave mbështetëse nga qeveritë dhe autoritetet përkatëse, rishikimit të të hyrave në kohën e duhur dhe përshtatjen e politikave të kreditimit nga ana e sektorit bankar.

Raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit qëndroi i ngjashëm me atë të vitit paraprak, saktësisht në 151.5 përqind, rritje marginale prej 0.5 pikë përqindje. Kjo lëvizje marginale erdhi pasojë e rritjes vjetore të stokut të provizioneve të ndara prej 4.8 përqind, dhe njëkohësisht, rritjes së vlerës së KJP-ve prej 4.5 përqind (grafik 38).

Vlera më e lartë e provizioneve këtë vit ka qenë e pritur, përkitazi me vlerësimet për rrezik të rritur kreditor. Megjithatë, megjithëse sektori ka ndarë nivel më të lartë të provizioneve këtë vit, shkalla e shpenzuar e provizioneve (shpenzimet për provizione ndaj kredive) për sektorin ishte më e ulët në dhjetor 2022 (-0.3 përqind) krahasuar me një vit më parë (-0.4 përqind) si rezultat i performancës së qëndrueshme kreditorë.

Grafik 38. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditorë


Shkalla e ekspozimit kreditor ka shënuar rritje, në 93.2 përqind nga 79.3 përqind një vit më parë, megjithëse vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin maksimal regullator.²⁶ Rritja vjetore e vlerës së

tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditorë së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300 përqind të kapitalit të klasit të parë. Këtu janë përjashtuar ekspozimet e degëve bankare.

ekspozimeve të mëdha për 26.4 përqind, krahas nivelit më të ulët të rritjes së kapitalit të klasit të parë për 7.5 përqind (vetëm për bankat në analizë, përjashtuar degët bankare²⁷), ndikuan në ngritjen e shkallës së ekspozimit kreditor (grafik 39).

Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, vlerësohet i ngjashëm me vitin paraprak. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha²⁸ qëndroi në 9.6 milionë euro, vlerë e ngjashme me vitin paraprak, si rezultat i efektit të rritjes së ngjashme të numrit të ekspozimeve të mëdha (rritje vjetore prej 25.6 përqind).

Grafik 39. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK.

Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore është zvogëluar marginalisht në 50.2 përqind nga 50.4 përqind. Ky ndryshim u ndikua nga rritja vjetore e përafërt e tri ekspozimeve më të mëdha dhe e gjithsej ekspozimeve për 25.8 përqind dhe 26.4 përqind, respektivisht.

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve në tri dhe pesë ekspozimet më të mëdha të bankave, në përgjithësi tregojnë për ndjeshmëri të sektorit ndaj goditjeve në këto ekspozime. Andaj, megjithëse sektori qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione, të cilat duhet të


²⁷ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare nuk janë përfshirë në analizë, ngase nuk kualifikohen si të tilla sipas rregullores në fuqi. Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë subjekt i rregullativës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit

monitorohet për së afërmi në kushtet e dinamikave aktuale. Gjithashtu, theksohet se rritja e përqendrimit të ekspozimeve kreditore në kushte të thellimit të mëtejme të dobësimit ekonomik paraqet rritje të theksuar të ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor.

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Pozita e profitabilitetit të sektorit u favorizua nga të gjitha kategoritë e realizimit të profitit. Të hyrat më të larta të realizuara përkundër rritjes së shpenzimeve ndikuan që profiti i sektorit bankar të jetë më i lartë se në vitin paraprak për 19.4 përqind. Të hyrat u karakterizuan me rritje vjetore më të përsheptuar se shpenzimet, me çrast të hyrat nga interesi në plasmanet bankare, përcjellur nga të hyrat e interesit në letra me vlerë dhe kredi, ishin kategoritë e të hyrave që kontribuan më shumë në realizim të profitit.

Grafik 40. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK.

Vlera e profitit neto arriti në 140.3 milion euro nga 117.5 milion në vitin paraprak (grafik 40). Presionet inflacioniste që filluan qysh nga fundi i vitit 2021 kanë nxitur autoritetet monetare drejtë shtrëngimit të politikave monetare, gjë që ka krijuar ambient me norma të rritura të interesit, duke u reflektuar kështu në rritjen e të hyrat nga interesi në plasmanet në bankat tjera dhe të hyrave nga interesi në


të klasit të parë të bankave amë, dhe pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumë prej 25 milion euro.

²⁸ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.

letra me vlerë. Në anën tjetër, edhe shpenzimet e interesit shënuan rritje por në nivel shumë më të ulët se të hyrat nga interesi (grafik 41).

Të hyrat për sektorin bankar u rritën për 15.0 përqind, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave nga interesi (kryesisht në plasmanet me bankat tjera) dhe deri në një masë, të hyrave nga jo-interesi (nga tarifat dhe komisionet).

Grafik 41. Kontribuesit kryesor në rritjen / zvogëlimin e profitit



Burimi: BQK.


Të hyrat neto nga interesi ishin kontribuesit që ndikuan në rritjen e profitit në raport me kontributin e të hyrave neto nga jo-interesi. Të hyrat neto nga interesi u rritën për 16.9 përqind apo 34.2 milionë euro, si rezultat i të hyrave nga plasmanet me bankat, të hyrat nga investimet në letra me vlerë dhe nga aktiviteti i rritur kreditor. Ndërsa, të hyrat neto nga jo-interesi janë rritur për 2.4 përqind apo 0.9 milion euro, si rezultat i rritjes së të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

Poashtu, margjina neto e interesit shënoi rritje në 4.6 përqind nga 4.3 përqind në vitin paraprak, që i atribuohet më shumë efektit të normave të interesit – pra të hyrave nga interesi në asete që sjellin interes (16.1 përqind rritje vjetore) se i efektit sasior - rritjes së stokut të aseteve që sjellin interes (9.7 përqind rritje vjetore)(grafik 42).

Të hyrat nga interesi u rritën për 36.5 milionë euro gjegjësisht për 16.1 përqind. Ndërsa vetëm të hyrat nga interesi në plasmanet me bankat u rritën për 16.4 milionë euro, nga rënia prej 1.4 milionë euro në vitin paraprak. Të hyrat nga interesi në letra me vlerë u rritën për 7.8 milionë euro nga rënia e vitit të kaluar për 0.6 milionë euro. Të hyrat nga interesi në

kredi shënuan rritje prej 10 milionë euro (4.7 përqind) në nivel më të ulët se në vitin paraprak që shënuan rritje për 16.8 milionë euro (apo 8.5 përqind).


Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit



Burimi: BQK.

Të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet si dhe të ardhurat tjera operative) shënuan rritje prej 8.0 përqind, apo për 6.9 milionë euro krahasuar me rritjen prej 31.0 përqind apo për 20.3 milionë euro (grafik 43 dhe 44).

Grafik 43. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit



Burimi: BQK.


Të gjitha kategoritë e shpenzimeve janë rritur përgjatë vitit. Rritja e shpenzimeve prej 12.4 përqind (apo për 25.4 milionë euro) u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative prej 14.6 milionë euro (grafik 45).

Shpenzimet e jo-interesit janë rritur për dallim nga rënia në vitin e kaluar, si rezultat i shpenzimeve për tarifa dhe komisione dhe shpenzimeve për provizione. Shpenzimet për tarifa dhe komisione u rritën për 3.4 milionë

euro, ndërkohë që shpenzimet për provizione u rritën për 2.5 milionë euro.

Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rritje prej 10.7 përqind, nga 5.7 përqind në vitin paraprak, por që ndikimi i rritjes nuk u transmetua në profit për shkak të efekteve më të larta pozitive të kategorive të tjera.


Grafik 44. Struktura e të hyrave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në muajt në vijim, profiti i sektorit bankar karakterizohet nga pasiguritë e rritura që luhatjet e çmimeve dhe perspektiva e dobët mbi aktivitetin ekonomik i kanë shkaktuar. Rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore është përcjellur me rritjen e përgjithshme të normave të interesit dhe luhatshmëri në pozitat e likuiditetit dhe të financimit.

Grafik 45. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Në këtë mënyrë efektet e zhvillimeve monetare e makroekonomike mund të ndjehen në të dy aspektet e marzhës së

profitit të bankave në vend. Në njërin anë, bankat në përpjekje për të mos rrezikuar aftësinë ripaguese të huamarrësve mund të mos e rrisin normën e interesit në kredi në nivelin e normës ndërbankare të huazimit ndërsa në anën tjetër, kostot e financimit do të mund të rriten në përmasa më të larta për shkak të aplikimit të normave të rritura nga institucionet financuese dhe rritjes së normave në depozita nën ndikim të konkurrencës për sigurimin dhe mbajtjen e tyre. Dobësimi i aftësisë paguese të klientëve si pasojë e shkallës së inflacionit dhe dobësimit të aktivitetit ekonomik pritet të shoqërohet me rritje të nivelit të provizioneve të projektuara për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë – duke ndikuar kështu në rënie të të hyrave të sektorit dhe rritje të shpenzimeve. **Indikatorët e profitabilitetit u rritën si rezultat i rritjes së profitit, dhe vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të lartë në rajon.** Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës u rrit në 2.5 përkatësisht 23.0 përqind, nga 2.3 përkatësisht 19.5 përqind një vit më parë (grafik 46).

Grafik 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Këto nivele janë mbi mesataren e bankave të rajonit që shënuan normë të kthimit në asete prej mesatarisht 1.6 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 12.6 përqind. Edhe vendet e rajonit shënuan rritje në treguesit e profitabilitetit gjatë këtij viti, por më të ulët se sektori bankar në Kosovë, prandaj edhe është rritur dallimin mes mesatares së Kosovës dhe këtyre vendeve.²⁹

²⁹ Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Burimi i informacionit

është databaza e Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së dhe bankat qendrore përkatëse.

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë nga bankat në njërin anë dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave me afat më të shkurtër maturimi në anën tjetër, në përgjithësi, kanë rritur ekspozimin e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit ngase kanë rritur mospërputhjen e maturitetit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve që bartin interes. Për më tepër, kjo dinamikë në një ambient të rritjes së normave të interesit në depozita nënkupton që rifinancimi i depozitave për shkak të maturitetit afatshkurtër që kanë, do të rris presionin në shpenzimet e bankave.


Hendeku kumulativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në vitin 2022 ishte pozitiv prej 1,048.8 milionë euro, krahasuar me 951.3 milionë euro në vitin paraprak. Detyrimet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit shënuan rritje më të lartë vjetore, dhe atë në afatet e maturimit ‘mbi 5 vite’, ‘91 - 365 ditë’ dhe ‘1-5 vite’. Rritja e asetëve ishte e përafërt me atë të detyrimeve, dhe rritjen më të lartë e kishte kryesisht në afatin e maturimit ‘1 – 30 ditë’ dhe ‘91 – 365 ditë’. Niveli më i lartë i rritjes së detyrimeve dhe rritja e mos-përputhjeve në afatet e maturimit në mes pasurisë dhe detyrimeve ndër lidhet kryesisht me nivelin më të lartë të depozitave të krijuara nga fluksi i ardhjes së diasporës, rritja e remitancave përmes kanaleve formale dhe jo formale dhe prirjet më të larta për të kursyer si rezultat i ofrave më të volitshme të ofruara nga bankat gjatë këtij viti.

Bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi (73.0 përqind e kredive janë me norma fikse), andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Sidoqoftë, numri i kredive me normë fikse të interesit ndër vite është në rënie, e veçanërisht në dy vitet e fundit si pasojë e pasigurive të shtuara

fillimisht nga pandemia e tutje nga rritja e vazhdueshme e çmimeve globalisht. Shtrëngimi i politikës monetare nga BQE që nga mesi i vitit 2022 pritet të ndikoj tutje në rritjen e kostos së financimit. Andaj, rreziku ndaj luhatjeve në normën e interesit është rrezik në rritje. Konkretisht rritja e rrezikut vërehet në rritjen e kostos së financimit gjatë vitit 2022, si pasojë e rritjes së normave të interesit në depozita si hap drejt sigurimit të financimit nga bankat. Andaj, rifinancimi i depozitave me kosto më të lartë ndikoi në rritjen e presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë pjesa më e madhe e kategorisë kryesore të asetëve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Nëse analizojmë vetëm kreditë dhe depozitat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bilancit të bankave, hendeku kumulativ ndërmjet tyre rezulton negativ si pasojë e nivelit më të lartë të depozitave krahas kredive, posaqërisht për grupin me afat maturimi ‘1-5 vite’.

Krahasuar me vitin paraprak, hendeku pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve u zgjerua për të gjitha afatet e maturimit, ndërsa hendeku negativ për kategorinë me afat maturimi ‘1 deri në 5 vite’ u thellua tutje si rezultat i rritjes së depozitave me këtë afat maturimi (grafik 47).

Grafik 47. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK.

Zgjerimi i mospërputhjeve në këto kategori të afatave të maturimit mes asetëve dhe detyrimeve mund të paraqes rritje të ekspozimit ndaj rrezikut në luhatjen, respektivisht rritjen e normave të interesit për periudhat kohore përkatëse, ngase mund të


rritë bilancin e shpenzimeve për refinancim të aseteve në raport me të hyrat që do të gjenerohen nga riinvestimi i mjeteve në këto afate.

5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kurset valutore është zvogëluar dukshëm krahasuar me vitin paraprak. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja zbriti në 14.9 milion euro ekuivalente nga 20.3 milion euro, që konsiston në raport prej 2.5 përqind të kapitalit të klasit të parë krahasuar me 3.7 përqind sa ishte në vitin 2021 (grafik 48). Rënia e pozicioneve në valutë të huaj rezultoj kryesisht nga reduktimi i ekspozimeve ndaj valutës britanike dhe dollarit amerikan.

Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto ndaj kapitalit të klasit të parë për dollarin amerikan rezulton në territor pozitiv, nga pozicioni negativ i vitit të kaluar si rezultat i rënies më të lartë të detyrimeve dhe se sa rënies së aseteve në këtë valutë. Kjo do të thotë se sektorit bankar i është ulur ekspozimi ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të euros ndaj këtyre valutave.

Grafik 48. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Burimi: BQK.


Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet

valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve të hapura në valuta të huaja. Kjo dëshmohet edhe përmes analizës ‘stres test’ që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel marginal. Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.3 përqind të gjithsej kredive, përkundër rritjes prej 2 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë nga viti paraprak.

Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 3.2 përqind, ndërsa u zvogëluan për 48.6 milionë euro nga viti paraprak (grafik 49).

Grafik 49. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK.

5.4. Kapitali


Sektori bankar vazhdon të ketë normë kapitali mbi nivelet e kërkuara rregullative.³⁰ Megjithatë, aktiviteti i lartë kreditor ka rritur asetet e peshura me rrezik në bilancet e bankave, duke rezultuar që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të jetë më i ulët.

Norma e kapitalit zbriti në **15.5 përqind, nga 16.4 përqind në vitin e kaluar**, me ç’rast kryesisht bankat me rëndësi sistemike kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Në nivel

³⁰ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9 përqind të APR-ve, ndërsa Kapitali rregullativ i klasit të parë duhet të qëndrojë minimalisht në 9 përqind në raport me APR-të.

sektori, varianca midis TMK-së së bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie (përafrim të TMK-së ndaj mesatares së sektorit). Pozita e kapitalizimit të sektorit reflektohet të jetë në nivel adekuat edhe nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj aseteve të peshuara me rrezik, i cili qëndroi në 13.5 përqind, megjithëse më e ulët se në vitin e kaluar si rezultat i rritjes së aseteve të peshuara me rrezik që konsistojnë kryesisht kreditë afatgjata (grafik 50).

Grafik 50. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK.


Norma e rritjes vjetore të APR-ve ishte 16.4 përqind nga 13.1 përqind një vit më parë, si rezultat i përshpejtimit të aktivitetit kreditues. Kapitali rregullativ shënoi rritje vjetore prej 10.5 përqind, e ndikuar nga rritja e profitit në vitin aktual dhe profitit më të lartë të mbajtur nga vitet paraprake.

Rritja e aseteve me peshë rreziku kontribuoi me 2.3 pikë përqindje në rënien e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndërkohë që rritja e kapitalit rregullator kontribuoi në rritjen e TMK-së për 1.7 pikë përqindje (Grafik 51). Efekti më i lartë i rritjes së aseteve të peshuara me rrezik se i rritjes së kapitalit dha kontribut më të lartë rënës në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit, prej 0.8 pikë përqindje.

Sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 86.9 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë, dhe profiti i mbajtur ka pjesëmarrje të lartë në kapital të klasit të parë (36.0 përqind), që sugjeron që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht

brenda aktivitetit të tyre (kapitalizimit të fitimit).


Grafik 51. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit



Burimi: BQK.

Të gjitha kategoritë e kapitalit rregullativ shënuan rritje. Me rritje më të lartë u karakterizuan vlera e emrit të mirë, fitimi i vitit aktual dhe kapitali aksionar si dhe provizionet e mbajtura. (Grafik 52). Në gjithsej profitin, efekt më të lartë kishte fitimi i mbajtur duke qenë më i lartë për 15.2 përqind, ndërsa fitimi i vitit aktual ishte më i lartë për 8.8 përqind.

Grafik 52. Struktura e kapitalit rregullator




Burimi: BQK.

Indikatorit i levës financiare (raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj ekspozimeve pas korrigjimeve rregullative) në dhjetor 2022 qëndroi në 9.3 përqind (grafik 53). Ky raport qëndron lartë mbi minimumin e sugjeruar me kornizën e Basel III për levë financiare prej

minimum 3.0 përqind,³¹ dhe sugjeron për pozitë të mirë të kapitalit.

Grafik 53. Norma e levës




Burimi: BQK.

Në kuadër të aseteve të peshuara me rrezik, asetet e peshuara për rrezik kreditor shënuan normë më të lartë të rritjes prej 17.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 13.7 përqind një vit më parë, që rezulton nga aktiviteti i rritur kreditor.

Asetet e peshuara për rrezik operacional shënuan rritje prej 7.4 përqind nga 5.8 përqind. Pjesëmarrja e aseteve të peshuara sipas rreziqeve mbetet e ngjashme, me 93.7 përqind të APR-ve të peshuara për rrezik kreditor, 6.3 përqind për rrezik operacional dhe pjesë shumë e ulët, 0.001 përqind për rrezik të tregut (grafik 54).³²

Grafik 54. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit




Burimi: BQK.

Asetet e peshuara për rrezikun kreditor (grafik 55) shënuan vlerën 4.3 miliardë euro (3.7 miliardë në vitin 2021). Në kuadër të këtyre

aseteve dominojnë kreditë me pakicë (ang. retail loans) me 44.9 përqind, pasuar nga ekspozimet ndaj korporatave me 18.7 përqind.

Kreditë hipotekare të mbështetura me pronë të paluajtshme komerciale dhe me pronë të paluajtshme rezidenciale kanë pjesëmarrje prej 14.0 dhe 8.2 përqind respektivisht. Ekspozimi ndaj bankave tjera, qeverive dhe bankave qendrore ishte relativisht i ulët prej 3.7 përqind dhe 2.2 përqind respektivisht.


Grafik 55. Asetet e peshuara me rrezik kreditor, pjesëmarrja



Burimi: BQK.

Ekspozimet tjera të mbetura përbëjnë 7.2 përqind të ekspozimeve, që përfshijnë autoritetet lokale, sektorin publik, bankat zhvillimore, organizatat ndërkombëtare (grafik 55).

Grafik 56. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK.

Sipas peshës së rrezikut, kategoria e peshuar me 100 përqind, që përbën edhe kategorinë me peshën më të theksuar në gjithsej asetet me rrezik (73.0 përqind) dhe që përfshinë ekspozime me pakicë (retail/individët), kredi ndaj korporatave dhe kredi hipotekare të

³¹ Sipas Basel III, norma e leves llogaritet si raport ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimeve pas ndryshimeve rregullative. Kjo normë duhet të jetë e barabartë apo mbi 3 përqind. BQK filloi llogaritjen e kësaj norme, sipas standardit të Basel III, nga viti 2020.


³² Asetet e peshuara për rrezik të tregut u raportuan për herë të parë me fillim nga vitin 2020, sipas formatit të ri të raportimit të kërkuar nga BQK.

mbështetura me pronë komerciale, shënoi rritjen më të theksuar këtë periudhë (për 488.4 milionë euro) (grafik 56 dhe 57).

Po ashtu edhe kategoria e aseteve me peshtë rreziku 75 përqind (që përfshinë kreditë me pakicë/retail dhe kreditë hipotekare e mbështetur me pronë të paluajtshme rezidenciale) shënuan rritje për 90.9 milionë euro (apo prej 12.7 përqind).

Kategoria e aseteve me peshtë rreziku 20 përqind që përfshinë kreditimin ndaj institucioneve financiare, qeverive dhe bankës qendrore, shënoi rritje për 15.7 përqind. Ky zhvillim sugjeron për rritje më të lartë të kreditimit në segmentin retail-për individët, korporatat dhe kreditimin hipotekar të mbështetur në pronë të paluajtshme rezidenciale (grafik 56 dhe 57).

Grafik 57. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor, sipas peshtës së rrezikut



5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet në nivelet brenda kërkesave rregullative, mbështetur kryesisht nga rritja e theksuar e depozitave të sektorit privat. Rritja e normave të interesit në nivel global, që rezultoi nga vendimet e politikave monetare për ngritje të normave bazë, ka shkaktuar sfida të reja në kontekst të kostove të financimit dhe të ruajtjes së pozitës së likuiditetit.

Rritja e depozitave ishte më e ngadalësuar përgjatë fillimit të vitit 2022

krahasuar me trendin e vitit paraprak, për shkak të pasigurive nga inflacioni në rritje dhe tensioneve të tjera të krijuara në nivel gjeopolitik. Tutje, politikat e shtrënguara monetare në gjysmën e dytë të vitit 2022 në kundërpërgjigje ndaj inflacionit gjithmonë në rritje rezultojnë në ambient me norma të rritura të interesit dhe rritje të presioneve konkurruese për tërheqjen dhe mbajtjen e depozitave.

Prospektet për vitin 2023 japin indikacione për sfida të reja mbi gjendjen me likuiditetin dhe financimin. Në njërën anë, persistenca e inflacionit në disa segmente, dhe potencialisht aktiviteti shumë më i dobët ekonomik do të mund të afektojnë disponueshmërinë e likuiditetit në treg, ndërkohë që rritja tutje e normave të interesit në konkurrencën për sigurim të likuiditetit do të shkaktojë presion mbi kostot e financimit.

Pozita e likuiditetit të sektorit gjatë vitit 2022 u mbështet tutje nga rritja e vazhdueshme e depozitave, dhe në veçanti, depozitave të sektorit privat. Depozitat e ekonomive familjare karakterizohen me natyrë më të besueshme dhe stabile për shkak se qëllimi i tyre parësor është 'kursimi/ruajtja'³³ i/e mjeteve. Për më tepër në kohëra të pasigurive, familjet priren të kursejnë më shumë në mënyrë që të jenë të pregaditura për shpenzime të pa-parashikuara eventuale. Nevojat e mundshme për likuiditetet bankat mund t'i përmbushin edhe përmes mekanizmave tjera si menaxhimit të rezervave të likuiditetit, marrëveshjeve ndërbankare për likuiditetin si dhe financimit nga bankat amë. Ndërsa BQK, si burim i fundit i likuiditetit, megjithëse e kufizuar në spektrin e mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg (në mungesë të politikës monetare) në rast të nevojave urgjente për mbështetje të sektorit me likuiditet, në dispozicion ka instrumentin e rezervës së detyrueshme, instrumentin e Fondit të Likuiditetit Emergjentsi dhe marrëveshjet e

³³ Ne kuptim jo të depozitave të kursimit por të ruajtjes së mejeve të tyre.

ri-blerjes me bankat bazuar në letra me vlerë qeveritare (REPO agreement).


Përkundër normës së lartë të likuiditetit në nivel sektori, shumica e bankave kanë shënuar rënie të raportit të likuiditetit nga viti i kaluar, ndër të cilat disa me rënie më të theksueshme. Disa banka mund të konsiderohen më të ndjeshme në këtë aspekt, për shkak të strukturës së bilancit, disponueshmërisë më të kufizuar të burimeve të financimit dhe për pasojë hapsirës më të kufizuar për të manovruar në ambient me norma të rritura të interesit.

Depozitat e transferueshme kanë vazhduar zgjerimin e tyre duke qenë edhe kategoria dominuese e depozitave, ndërsa nën ndikimin e normave të interesit në rritje, pjesëmarrja e depozitave të afatizuara poashtu është zgjeruar, që në kombinim me rritjen e vazhdueshme të kreditimit më afatgjatë kontribuan në theksimin e mospërputhjeve në mes asetëve dhe detyrimeve në disa kategori të afateve të maturimit. Megjithatë, indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit të bankave që mbahen në BQK por edhe i gjithsej asetëve likuide, e bën sektorin rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë kur mospërputhjet e afateve të maturimit në mes të investimeve dhe financimit janë të theksuara.

5.5.1 Financimi bankar


Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga depozitat e sektorit privat, të cilat vazhduan rritjen dhe mbesin burimi më i besueshëm dhe i qëndrueshëm i financimit. Përderisa depozitat e ekonomive familjare shërbejnë kryesisht për qëllime të kursimit/ruajtjes (andaj edhe konsiderohen si më të qëndrueshme), ndërmarrjet mbajnë depozitat në aspekt të sigurimit të likuiditetit për të financuar vazhdimësinë e aktiviteteve të tyre ditore.

Grafik 58. Struktura e financimit



Financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët, ndërkohë që bankat vazhdojnë të kenë ekspozim të ulët ndaj financimit në sektorin e jashtëm. Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 127.7 përqind, tregues që u zvogëlua për 3.1 pikë përqindje nga viti paraprak, nën ndikimet e rritjes më të lartë të kreditimit (grafik 59).

Grafik 59. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar




Përderisa në tremujorin e parë të vitit trendi i rritjes së depozitave u ngadalësua, rritja e normave të interesit në gjysmën e dytë të vitit u shoqërua me rritje të përforcuar të vlerës së gjithsej depozitave.

Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 8.7 përqind, që ishte rritje më e ngadalësuar kundrejt rritjes prej 13.8 përqind të shënuar në vitin paraprak. Stoku i tyre arriti në 3.7 miliardë euro (grafik 60). Pjesa më e madhe ishin depozita të transferueshme, të cilat me rritjen vjetore prej 8.4 përqind i kontribuan bazës së gjithsej depozitave. Megjithatë, ishin depozitat e afatizuara që shënuan rritje më të theksuar prej 18.7


përqind, ndikuar nga kampanjat e bankave për afatizim të mjeteve, në konkurrencën për tërheqje të depozitave. (grafik 61).

Grafik 60. Struktura e depozitave



Depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej 19.0 përqind (19.3 përqind rritje vjetore në vitin 2021), ndikuar kryesisht nga rritja e përshpejtuar e depozitave të afatizuara (prej 127.4 përqind). Rritja ishte veçanërisht e theksuar përgjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit, më konkretisht muaji dhjetor dhe shtator 2022 përbën nivelin më të lartë të depozitimit.

Grafik 61. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 1.2 miliardë euro, me pjesëmarrje 20.9 përqind në gjithsej depozitat.

Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua nga rritja e depozitave të transferueshme ngase përbëjnë kategorinë dominiuese, mirëpo rritja e theksuar e depozitave të afatizuara patën efekt të lartë pozitiv në rritjen e përgjithshme të depozitave të ndërmarrjeve. Preferenca e ndërmarrjeve për mbajtje të depozitave të transferueshme


kundrejtë atyre të afatizuara ndërlihet me qëllimin për të cilin këto depozita shërbejnë. Ndërmarrjet kryesisht fokusohen në shfrytëzimin e depozitave për çështje të likuiditetit dhe për qëllim të financimit të aktivitetit të tyre ditor. Mirëpo, gjatë dy viteve të fundit, ndërmarrjet mund të jenë nxitur drejtë afatizimit të mjeteve të tyre si pasojë e perspektivës së dobësuar ekonomike por edhe si rezultat i kampanjave të shumëta me norma më të larta të interesit.

Depozitat e institucioneve tjera financiare dhe institucioneve publike poashtu shënuan rritje të theksuar vjetore, megjithëse karakterizohen me fluktuime në frenkuenca të shpeshta përgjatë vitit për shkak të natyrës më fleksibile të tërheqjes së këtyre depozitave.

Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme me pjesëmarrje prej 64.1 përqind, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 7.9 përqind. Depozitat e afatizuara u karakterizuan me rritjen më të theksuar prej 47.1 përqind, dinamikë që rezultoj edhe në rritje të pjesëmarrjes së këtyre depozitave në 25 përqind, nga 19 përqind që ishte në vitin e kaluar (grafik 61).

Depozitat e transferueshme kryesisht posedohen nga ekonomitë familjare (65.6 përqind) ndërsa pjesa e mbetur (27.2 përqind) janë të ndërmarrjeve. Përderisa depozitat e transferueshme dhe ato të kursimit shënuan rritje, depozitat e afatizuara u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.9 përqind.

Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’. Depozitat e afatizuara me afat të maturimit ‘mbi 2 vite’ dominuan strukturën e depozitave të afatizuara, dhe rritën pjesëmarrjen e tyre relative në 50.2 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara (nga 49.5 përqind), përderisa, kreditë që kanë pjesëmarrjen më të lartë janë ato me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’, që konsistojnë 38.0 përqind të gjithsej kredive (grafik 62).

Grafik 62. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive


Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe rritja e kërkesave për financim të qëndrueshëm shton nevojat për mbikqyrje më prudente të praktikave të bankave rreth mundësive të tyre të financimit dhe kostove përcjellëse kundrejtë aktivitetit të tyre të rritur kreditor. Përderisa financimi nga jashtë është në nivel të ulët, rritja e kostos së tyre do të paraqes sfidë, veçanërisht në këtë periudhë të rritjes së inflacionit dhe të normave të interesit.

5.5.2 Rreziku i Likuiditetit


Sektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit, duke dëshmuar kapacitet për mbështetje të aktivitetit kreditues si dhe kapacitet të lartë për përballje me rreziqe të mundshme. Megjithatë, ndryshimi i politikës monetare nga BQE dhe rritja e normave të interesit është përkthyer në presione të rritura konkurruese për sigurim të financimit të qëndrueshëm. Tutje, rritja më e dobët ekonomike në eurozonë dhe vend dhe presionet ende evidente inflacioniste mund të reflektohen në dobësim të kapacitetit kursyes (marrë parasysh ndikimin që ka diaspora në ciklin e depozitave).

Në vitin 2022, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra zbriti në 36.5 përqind, nga 37.2 përqind në vitin 2021. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtëra kundrejtë rritjes së aseteve likuide prej 9.2 përqind (apo për 411.8 milionë euro), dhe 7.0 përqind (apo për 116.3

milionë euro) respektivisht. Raporti i likuiditetit do të binte në 32.2 përqind, nëse nga mjetet likuide do të përjashtoheshin letrat me vlerë të qeverisë së Republikës së Kosovës. Poashtu, raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshinë vetëm asetet shumë likuide (paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet afatshkurtëra, zbriti lehtësisht në 29.3 përqind nga 30.4 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve kundrejtë aseteve shumë likuide.

Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve zbriti në 27.1 përqind (28.8 përqind në vitin 2021), duke qenë se asetet u rriten më shpejtë kundrejt aseteve likuide (grafik 63).

Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi kryesisht nga rritja e investimeve në letra me vlerë të tregtueshme të qeverive të huaja për 43.2 milionë euro (32.3 përqind rritje) dhe rritja e depozitave me maturitet afatshkurtër deri në 30 ditë të plasuar me bankat jashtë vendit për 22.3 milionë euro. Po ashtu, kontribut të rëndësishëm në rritje të aseteve likuide kishte rritja prej 5.2 milionë euro e kategorisë dominuese që është rezerva e likuiditetit më bankën qendrore (që kanë pjesëmarrje prej 33.0 përqind), pastaj e parasë së gatshme për 32.9 milionë euro apo 13.1 përqind rritje vjetore.

Grafik 63. Indikatorët e likuiditetit


Ndërsa, efekt zbritës në mjete likuide kishte kategoria e investimeve në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës që u zvogëluar për 39.3 milionë euro (18.9 përqind rënie vjetore).

Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 49.2 përqind.

Që nga viti 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepricën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me vendimet e BQE-së. Përkundër normave negative të aplikuara, bankat kanë qenë mjaftë likuide dhe në mungesë të mundësive atraktive për investim të mjeteve, kanë vazhduar të tejkalojnë rezervën e detyrueshme për mesatarisht 40-60 përqind. Megjithatë, dinamikat e fundit me norma të interesit mund të krijojnë hapsirë për investime alternative me kthime më atraktive.


Presionet e vazhdueshme inflacioniste kanë krijuar presion kundrejtë shtrëngimit të politikave monetare. Transmetimi i ndryshimeve në normat bazë të interesit nga BQE, në gjysmën e dytë të vitit, është reflektuar në të gjitha segmentet e tregut financiar në vend ku në të njëjtën linjë është ndikuar edhe norma e depozitave me të cilën BQK ngarkon depozituesit e saj. Niveli i normës varet nga normat që bankat e eurozonës aplikojnë për BQK-në, si dhe nga kthimet e investimeve në portfolion aktuale investuese. Rrjedhimisht, me rritjen e normave të interesit në nivel global, BQK ka filluar të aplikojë normë pozitive të interesit prej 0.15 përqind nga janar 2023 për të gjithë depozituesit në BQK, si dhe për bankat komerciale - e aplikueshme mbi rezervat minimale të mbajtura në BQK.

Niveli i tepricës së rezervave bankare gjatë vitit 2022 prej 49.2 përqind është ulur krahas vitit 2021 që ishte në nivelin 68.3 përqind dhe 82.3 përqind në vitin 2020, si rezultat i rritjes vjetore shumë më të lartë të aktivitetit kredidhënës, kundrejtë rritjes së vazhdueshme të depozitave (grafik 64).³⁴

Ambienti i normave të ulëta të interesit për një kohë të gjatë ka stimuluar ekonominë familjare të zhvendosin

depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të rritjes së kreditimit afatgjatë ka rezultuar në zgjerimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve. Përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2022, afatizimi i depozitave ka marrë përmasa më atraktive nga normat më të larta të ofruara në treg, zhvillim që ka rezultuar në zgjerim më të theksuar të hendekut, veçanërisht në kategorinë e afatit të maturimit “1-5 vite”.

Grafik 64. Rezervat e likuiditetit



Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit në disa kategori të afateve të maturimit janë rritur tutje në kushtet kur depozitat e transferueshme dhe ato të afatizuara deri në 5 vite janë rritur, në të njëjtën kohë që kreditimi hipotekar afatgjatë është në rritje, lëvizje kjo që është duke rritur sfidat në menaxhimin me likuiditetin.


Hendeku kumulativ i likuiditetit në vitin 2022 u zgjerua në 709.6 milionë euro, nga 598.8 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar kryesisht zgjerimi më i theksuar i hendekut pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të afateve të maturimit “1 deri në 5 vite”, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve me këtë maturitet (44.5 përqind rritje). Rreth 38.9 përqind e aseteve kategorizohen në afatin ‘1-5 vite’, në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë 13.9 përqind të gjithsej detyrimeve. Pjesëmarrja shumë më e lartë e aseteve në këtë kategori dhe rritja vjetore prej 19.8 përqind ka ndikuar që

³⁴ Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendencia për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit

vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse.

mospërputhjet të zgjerohen në territor pozitiv pavarësisht rritjes së detyrimeve në këtë kategori prej 44.5 përqind.

Grafik 65. Hendeku i likuiditetit*



Burimi: BQK.

Zgjerimi i radhës më i lartë ishte te hendeku negativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të afateve të maturimit “1 deri në 7 ditë”, për shkak të pjesëmarrjes më të lartë të detyrimeve në këtë maturitet pasiqë rritja ishte e njejtë si e asetëve ashtu dhe e detyrimeve. Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme në gjithsej detyrimet e sektorit bën që 71.2 përqind e detyrimeve të kategorizohen në afatin “1-7 ditë” në raport me asetet e këtij afati që përbëjnë vetëm 20.6 përqind të gjithsej asetëve.

Kategoritë e tjera të afeteve të maturimit po ashtu shënuan rritje, që krijuan hendek pozitiv të likuiditetit, përveç kategorisë së maturimit “8-30 ditë” dhe “6-12 muaj” në të cilën u ngushtuan mospërputhjet.

Rrjedhimisht, mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit “1-7 ditë” dhe “1-5 vite” (grafik 65). Kjo situatë paraqet rritje të ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të likuiditetit me vazhdimësinë e rritjes së kreditimit afatgjatë dhe konkurrencës për financim.

5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test³⁵

Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj rreziqeve të rritura që rrjedhin nga ekspozimi në situata jo të favorshme ekonomike e financiare, është realizuar përmes kalibrimit të skenarëve të bazuar në parashikime reale si dhe më ekstreme por të mundshme të ngjarjeve për periudhën e ardhshme një vjeçare. Tri vitet e fundit u karakterizuan me shumë sfida për sektorin bankar të krijuara direkt nga dinamikat shumë të luhatshme në nivel global. Fillimi i luftës në Ukrainë, intensifikimi i inflacionit dhe kriza e shkaktuar energjetike turbulluan perspektivën për rritje të vazhdueshme ekonomike në eurozonë ndaj të cilit ekonomia dhe sistemi financiar i vendit janë shumë më të ekspozuar. Tutje, reagimi i paevitushëm i politikës monetare ndaj situatës me inflacionin, përmes rritjes së normave bazë të interesit, dha indikacione për një recesion të mundshëm në fund të vitit dhe në vazhdim të vitit 2023. Gjithsesi, ekonomitë performuan më mirë se sa pritej prandaj edhe parashikimet ndryshuan përkritazi, për një rritje më të ngadalësuar. Në të njejtën kohë, përkundër situatave të krijuara, edhe sektori bankar në vend deri më tani dëshmoi rezistencë pa ndonjë materializim të rreziqeve.

Për këtë arsye, përtej parashikimeve, zhvillimet dhe rrjedhimisht edhe supozimet e bëra në këtë analizë të rezistencës, janë të përcjellura me pasiguri të larta për shkak të perspektivës ekonomike më të luhatur, që ndërlidhet me të ardhmen e zhvillimeve në rendin gjeopolitik, ecurinë me inflacionin, ecurinë me norma të interesit si dhe kostot përcjellëse të vendimeve të ardhshme monetare, e që për pasojë e subjektivizojnë performancën ekonomike të të gjithë akterëve në treg.

³⁵ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve

negative, pa paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor

Indikatorët	Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë	Skenari i moderuar i rrezikut kreditor në kombinim me rrezikun e tregut
	Supozimet			
BPV (norma e rritjes reale, %)	4.0	2.4	-5.6	2.4
Kreditë bruto (norma e rritjes së kreditimit, %)	12.6	12.6	8.6	12.6
Rritja e normave të interesit në pozicionet bilancore (për pikë përqindje kredi/depozitë)	n/a	n/a	n/a	2.0pp/1.5pp
Profiti (normë e rritjes së profitit, %)	0.9	-9.7	-24.8	-0.7

Burimi: BQK.

Ndërtimi i skenarëve për rrezikun kreditor do të përfshijë goditjet makroekonomike e financiare në pozitën kapitale. Në këtë ushtrim janë konsideruar tre skenarë dhe një skenar i kombinuar, në nivel sektori, të bazuara në supozimet që janë ndërtuar mbi nivelet e parashikuara të rritjes ekonomike të ndikuara nga disa faktorë si rënia e të hyrave nga diaspora dhe shtrëngimet e kushteve kreditore që për burim kryesisht kanë dinamikën në shkallën e inflacionit.³⁶ Implikimet direkte të inflacionit në fuqinë blerëse të konsumatorit dhe standardin jetësor janë të një rëndësie të veçantë për efektin zingjiror që mund të kenë në performancën kreditore të kredimarrësve (dobësimi i aftësisë paguese) dhe në likuiditetin e bankave (zvogëlimi i mundshëm i depozitave për shkak të dekurajimit të kursimit sesi pasojë e inflacionit dhe/apo rritjes së mundësive për investime me kthime më atraktive, rritja e koncentrimin të depozitave në bankat më konkurruese me norma të interesit etj.).

Përkundër trendit në rënie të inflacionit të ëpërgjithshëm, presionet inflacioniste mbesin

në nivele të larta. Persistenca e presioneve inflacioniste dhe perspektiva për vazhdimësi të tyre ndikoi që BQE edhe në takimin e muajit maj të përgjigjet me rritje tutje të normave bazë të interesit, vendimi i gjashtë që nga korriku i vitit 2022. Ngritja e normave bazë të interesit ka implikuar kushtet e financimit dhe gjendjen me likuiditetin, duke u bartur direkt edhe në tregun financiar në vend. Situata e tillë është reflektuar në të dy anët e bilancit të bankave, duke rritë fokusin e të gjithë akterëve në rrezikun e likuiditetit. **Në rrethanat e reja të krijuara, në skenarin e katërt të përpiluar është kombinuar edhe rreziku i tregut, bazuar në supozimin e rritjes së normave të interesit që reflektojnë rritjen e normave në nivel global dhe rritjen e rreziqeve në treg.** Këto zhvillime të reja në tregun financiar konsiderohen se mund të përbëjnë efekt negativ në perspektivën e rritjes ekonomike, pasi që mund kufizojnë kushtet e kreditimit dhe besueshmërinë në treg.

Sipas rezultateve nga testi i goditjeve në portfolion kreditore, pozita kapitale e sektorit bankar, në përgjithësi, do të mund të

Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve

Përshkrimi	Elasticiteti	Reagimet e normës së KJP-ve		
		Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
Zgjerimi i hendekut të prodhimit	0.80 pp	-0.48 pp	0.83 pp	7.21 pp

Burimi: BQK.

³⁶ Norma e rritjes së inflacionit është parashikuar me modelin statistikor ARIMA.

përballonte goditjet në skenarët e dizajnuar (grafik 71, tabela 7). Në nivel të bankave, në skenarin më të rëndë, ëgjashtë banka do të përballëshin me nevojën për kapital shtesë për përballim të goditjeve në portfolion e tyre kreditor.³⁷

Rezultatet nga testi i goditjeve në pozitën e likuiditetit sugjerojnë se sektori bankar si tërësi posedon kapacitet financiar për të përballuar situatat e supozuara të tërheqjes së një shume të konsiderueshme të depozitave apo të depozitorëve më të mëdhenjë, megjithëse disa banka paraqiten më të ndjeshme ndaj skenarëve të supozuar. Në të gjithë skenarët e supozuar, pozita e likuiditetit e shumicës së bankave rezulton e qëndrueshme, përjashtuar në supozimin e tërheqjeve të 38.3 përqind të depozitave në fund të ditës së pestë me radhë, ku katër banka do të rezultonin me mungesë të mjeteve likuide (tabela 9).

5.6.1. Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në portfolion kreditor dhe pozitën kapitale

Analiza stres-test për rrezikun kreditor vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar, përmes aplikimit të tre skenarëve: skenarit bazë e mbështetur në zhvillime të pritshme, ai alternativ (moderuar) që si pikënisje ka supozimin e rënies së aktivitetit ekonomik ndikuar nga reduktimi i të hyrave nga diaspora, dhe skenari i rënduar që supozon ngadalësim më të theksuar ekonomik ndikuar nga parashikimet për ngadalësim ekonomik në eurozonë nën presionet e zgjatura inflacioniste, dhe krijimin e kushteve më të kufizuara të financimit (tabela 5 dhe 6). Në dy skenarët e parë, rritja e kreditimit është supozuar të jetë 12.6 përqind, më e ulët se rritja e këtij viti, dhe 8.6 përqind në skenarin e

rënduar, për shkak të pasigurive rreth ecurisë së inflacionit dhe aktivitetit ekonomik (tabela 5).

Skenari bazë mbështetet në zhvillimet makroekonomike të pritshme. Në këtë skenar, aktiviteti ekonomik në vend parashikohet të ketë një rritje pozitive dhe më të lartë se në vitin paraprak prej 4.0 përqind. Rritja ekonomike supozohet se do të shoqërohet me rritje të kreditimit që eëështë mesatarisht ëmë e ëngadalësuar ëkrahësuar me vitin paraprak, bazuar ënë parashikimet e bankave individuale³⁸ (tabela 5 dhe 7). Po ashtu, është supozuar se do të realizohen të hyra më të larta ngase të hyrat nga interesi në kredi do të rriten nga rritja e kreditimit. Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për vitin 2022, ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar gjatë vitit 2021, ndaj të cilit pastaj është aplikuar zbritja e të hyrave që do të realizoheshin po qe se nuk do të rriteshin KJP-të. Në këtë rast, profiti do të jetë më i lartë se në vitin aktual për 0.9 përqind për shkak të ëzvogëlimit të KJP-ve³⁹ krahas rritjes së kreditimit.⁴⁰ Rezultatet në bazë të këtyre supozimeve sugjerojnë që raporti i KJP-ve do të zvogëlohej për 0.48 pikë përqindje për shkak të aktivitetit të rritur ekonomik, me ç'rast norma e kapitalizimit do të përmirësohej në 17.1 përqind nga niveli aktual 15.3 përqind⁴¹. Rritja e normës së kapitalizimit kryesisht rezulton nga rritja më e lartë e të hyrave të pritura për t'u realizuar në vitin në vijim kundrejtë kërkesave për provizionet e pritura shtesë nga rritja e kreditimit, si dhe për shkak të përfshirjes së profitit të realizuar në vitin aktual në përlllogaritjen e nivelit të kapitalit - nën supozimin që nuk do të shpërndahet dividendë (grafik 68, grafik 69, tabela 7). Përkeqësim të pozitës së kapitalit do

³⁷ Në analizë janë përfshirë 10 nga 11 banka që operojnë në tregun e Kosovës. Banka Credins nuk është përfshirë duke qenë në fillim të aktivitetit të saj.

³⁸ Sipas parashikimeve të bankave për 2023, rritja vjetore e kreditimit të sektorit bankar do të jetë mesatarisht 13.0 përqind (siguruar nga Departamenti i Mbikqyrjes Bankare)


³⁹ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

⁴⁰ Ndikimi i këtyre zhvillimeve në cilësinë e portfolios kreditor është llogaritur përmes koeficientit të elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8pp. Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

⁴¹ Raporti i provizionimit sipas shtyllave kreditorë për secilën bankë, për të llogaritur provizionet shtesë të nevojshme me rritjen e KJP-ve, është përcaktuar të jetë i njëjtë me raportin e provizionimit të secilë bankë korresponduese, që kanë realizuar në vitin 2021.

të kishin dy banka (ënjëra bankë rezulton me normë kapitali nën kërkesën rregullative edhe para goditjes)ëëë, e cila në cilësinë e degës bankare nuk është subjekt i kërkesës minimale për kapital prej 12 përqind.

Grafk 66. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve



Burimi: BQK.

Në skenarin e dytë është supozuar ngadalësim i aktivitetit ekonomik në 2.4 përqind duke simuluar rënien e të hyrave nga diaspora, vizitave të diasporës si dhe rënien e investimeve në patundshmëri.⁴²

Kohëzgjatja e presioneve inflacioniste ka krijuar pasoja evidente, që përveç rëndesës në shportën konsumatore, ka prekur edhe kushtet e financimit dhe kreditimit me pasoja në aktivitetin e përgjithsëm ekonomik. Përderisa çmimet në tregjet financiare ndërkombtare kanë rënë, presionet inflacioniste si pasojë e rritjes së pagave dhe çmimeve të shërbimeve mbesin evidente në

eurozonë. Rritja e ngadalësuar ekonomike në eurozonë do të mund të reflektohej në vend përmes rënies së remitencave dhe burimeve të tjera hyrëse që ëëndërlidhen me diasporën. Sipas rezultateve të këtij skenari, duke u bazuar në koeficientin e elasticitetit të KJP-ve ndaj rritjes ekonomike, norma e kredive jo-performuese do të rritej për 0.83 pikë përqindje në 2.9 përqind (tabela 6). Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për vitin 2023, që do të pësonte tronditje duke u zvogëluar për 9.7 përqind si pasojë e rritjes së shkallës së dështimit të kredive. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 31.1 milionë euro (grafik 72). Këto humbje do t'i ngarkoheshin direkt kapitalit, por niveli i lartë i provizioneve aktuale të mbajtura për të mbuluar dështimin e kredive bën që sektori të jetë më rezistent ndaj goditjeve të supozuara në këtë skenar, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit që rezulton 16.0 përqind. Dy banka do të rezultonin të nënkapitalizuara (njëra degë bankare), për të cilat norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të zbriste në 10.0 përqind dhe 9.5 përqind, respektivisht. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrinin vlerën prej 1.7 milionë euro (tabela 7).

Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave me	Norma e kapitalizimit			Norma e KJP-ve			Mjetet shtesë të nevojshme për rikapitalizim (në mijëra euro)
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
Nivelet aktuale (para goditjeve)		95.0	13.2	15.3	2.8	0.0	2.0	
Rezultatet e skenarëve								
Skenari bazë: Rënia e normës KJP për 0.48pp, rritja e kreditimit për 12.6%, rritja e profitit për 0.87%	2	55.4	10.5	17.1	2.4	-0.5	1.6	884
Skenari i moderuar: Rritja e normës KJP për 0.83pp, rritja e kreditimit për 12.6%, rënie e profitit për 9.7%	2	55.3	9.5	16.0	3.7	0.8	2.9	1,719
Skenari i rënduar: Rritja e normës KJP për 7.21pp, rritja e kreditimit për 8.6%, rënia e profitit për 24.8%	6	65.5	6.5	11.9	10.1	7.2	9.3	51,545
Skenari i moderuar i rrezikut kreditor në kombinim me rrezikun e tregut	0	57.0	13.2	17.6	3.7	0.8	2.9	0
Dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenjë	3	67.9	9.2	14.7	38.1	2.1	7.9	1,157
Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenjë	5	59.4	5.4	13.0	52.3	2.1	10.5	17,319

Burimi: BQK.

⁴² Rreth skenarëve të ndërtuar të rritjes ekonomike, referohuni në Kutia 2.

Në skenarin e rënduar janë vlerësuar zhvillime negative më ekstreme të dinamikave aktuale dhe ndjeshmëri më e lartë e aktivitetit ekonomik në vend ndaj këtyre zhvillimeve, megjithëse me probabilitet më të ulët ndodhjeje. BPV reale është supozuar të shënojë rënie prej 5.6 përqind, në nivelin e afërt të përjetuar përgjatë periudhës së pandemisë. Kjo gjendje mund të karakterizohet me pasiguri të shtuara në realizimin e të ardhurave dhe dobësim të mëtejshëm të aftësisë paguese të huamarrësve. Megjithëse skenar i rënduar, kreditimi është supozuar se do të rritej për mesatarisht 8.6 përqind, duke marr parasysh që disa banka kanë kapacitetet e tyre kapitale që mbështesin kreditimin përkundër situatës së pasigurive të shtuara. Sektori bankar do të përballesh me rritje të raportit të kredive joperformuese për 7.2 pikë përqindje, duke u rritur deri në 9.3 përqind. Në analizë nuk konsiderohet mundësia e realizimit të kolateralit apo rritja e kapitalit nga burime të tjera, duke qenë se efikasiteti dhe mundësia e realizimit të këtyre veprimeve është shumë e pasigurt në kohë krize. Profiti do të pësonte tronditje nga rritja e shkallës së dështimit të kredive ekzistuese, duke u zvogëluar për 24.8 përqind. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 219.0 milionë euro (grafik 72) dhe niveli i kapitalizimit pas goditjes do të zbriste në 11.9 përqind (tabela 6). Numri i bankave me probleme në mbajtjen e pozicionit të kapitalit do të rritej në gjashtë, prej tyre dy banka me rëndësi sistematike dhe një bankë tjetër me rëndësi sistematike shumë afër kufirit rregullativ, TMK e së cilave do të zbriste në 11.8 përqind dhe 9.9 përqind. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar rregullator do të arrinin vlerën 51.5 milionë euro (grafik 72, tabela 7).

5.6.1.1 Skenari i rrezikut kreditor kombinuar me rrezikut e tregut

Skenari i moderuar i rrezikut kreditor, që supozon se ngadalësimi i aktivitetit ekonomik do të jetë 2.4 përqind, është shoqëruar me skenarin e rrezikut të tregut, përkatësisht me

supozimin mbi rritjen prej 2.0 pikë përqindje të normave të interesit në pozicionet e aseteve dhe 1.5 pikë përqindje në pozicionet e detyrimeve (tabela 5). Transmisioni i rritjes së normave bazë të interesit nga BQE dhe euribor që aktualisht janë në nivelin prej 3.3 përqind⁴³, nuk do të ishte i plotë por do të ndikonte më shumë asetet se detyrimet, ndërsa detyrimet nën ndikimin e konkurrencës ndërmjet bankave për sigurim të financimit të qëndrueshëm supozohet se do të pësojnë rritje të normës prej 1.5 pikë përqindje.

Supozimi i rritjes së normave të interesit në këtë skenar është mbështetur në situatën aktuale të inflacionit të rritur dhe në faktin se autoriteti monetar i Eurozonës ka dhënë sinjale se mundësia për rritjen tutje të normave bazë të interesit nuk përjashtohet, dhe kjo në mënyre indirekte do të ndikonte tutje normat e interesit në vend. Analiza mbështetet në gjendje statike 1 vjeçare të bilancit të gjendjes, prandaj konsiderohet se të njëjtat instrumente që maturojnë brenda një viti do të riinvestohen dhe rrefinancohen me norma të interesit të supozuara në këtë skenar. Poashtu, në anën e aseteve, janë përfshirë edhe pozicionet me afat maturimi mbi një vit por ëvetëm ato me norma variabile për shkak se këtyre kredive ju ndryshon kostoja varësisht lëvizjeve të euribor edhe brenda vitit.


Pjesëmarrja e kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive do të mbetet e njëjtë si në rrezikun e moderuar kreditor, në 2.9 përqind, ndërsa humbjet e sektorit me aplikimin e supozimit mbi rritjen e normave të interesit në këtë nivel do të zvogëloheshin për 97.2 milionë euro në vlerën 66.1 milionë (grafik 72). Në këtë skenar, supozimi i rritjes së normave të interesit ka dhënë efekte pozitive në të hyrat neto nga interesi, pasi që sektori ka hendek pozitiv të bilancit me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dhe nën supozimin se të njëjtat pozicione do të riinvestoheshin, të hyrat e sektorit rezultojnë se do të ishin më të larta -

⁴³ Sipas të dhënave të muajit Maj ([Key ECB interest rates \(europa.eu\)](https://www.ecb.europa.eu/press/pr/key ECB interest rates (europa.eu);); [Euribor 3 months - 3 month Euribor interest rate \(global-rates.com\)](https://www.global-rates.com/Euribor-3-months-3-month-Euribor-interest-rate))

megjithëse me efekte negative në kosotot e kredimarrësve.

Niveli i kapitalizimit pas goditjes rezulton 17.6 përqind për vitin 2023, që është i përmirësuar mbi nivelin aktual (grafik 67 dhe tabela 7).

Grafik 67. Rezultatet e stress testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi



Burimi: BOK.

5.6.1.2 Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve të mëdha kreditore

Në këtë skenar është vlerësuar qëndrueshmëria e bankave ndaj dështimit të mundshëm të tre dhe pesë kredimarrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj do të ndikonte që niveli i kapitalizimit të sektorit të bie në 14.7 përqind nga 15.3 përqind dhe humbjet të arrijnë në 169.7 milionë euro (grafik 67 dhe tabela 7).⁴⁴ Tri banka do të përballëshin me humbje të larta, ndër to dy degë bankare që nuk janë subjekt i rregullativës mbi kapitalin.

Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenj do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen në këto tri banka, si dhe dy banka të tjeta, ndërsa njëra nga to me rëndësi sistematike. Humbjet do të arrinin në 225.4 milionë euro dhe TMK e sektorit do të zbriste në 13.0 përqind. Bankave të nën-kapitalizuara do të ju nevojiteshin 17.3 milionë euro shtesë për ngritje të kapitalit në nivelin minimal rregullativ (duke përjashtuar degët bankare) (grafik 72 dhe tabela 7). **Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori është i ndjeshëm ndaj ekspozimeve të mëdha, performanca e të cilave duhet të**

⁴⁴ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare janë përfshirë në analizë, që megjithëse duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë subjekt i rregullativës

monitorohet për së afërmi në kushtet e dinamikave aktuale. Gjithashtu, theksohet se rritja e përqendrimit të ekspozimeve kreditore në kushte të thellimit të mëtejme të dobësisë ekonomike paraqet rritje të theksuar të ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor.

5.6.1.3 Kapacitetet kapitale të bankave për absorbim të rritjes së kredive-joperfomuese

Sektori bankar është në gjendje të përballojë një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 8.5 përqind, pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së së sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12.0 përqind. Po ashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalin paraqiten të larta për disa banka. Pragun më i ulët i tolerancës së rritjes së normës së KJP-së ishte 4.99 përqind, ndërkohë që një bankë me rëndësi sistematike do të mund të përballonte rritjen e normës së KJP-së deri në 7.2 përqind. Niveli më i lartë i përballimit të rritjes së normës së KJP-së është 13.1 përqind, para se bankës të i paraqitet nevoja për kapital shtesë.

5.6.2 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësojë qëndrueshmërinë e bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga tërheqja e depozitave të koncentruara. Skenarët janë mjaftë konservativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit. Poashtu, në skenarët e tërheqjes së menjëhershme të depozitorëve më të mëdhenj

për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumën prej 25 milion euro.

nuk është konsideruar fakti që disa depozitor kanë kontrata specifike me bankën, apo kanë raporte bankë-klientë në atë mënyrë që tërheqja e tyre është më e parashikuar apo/dhe jo-lehtësisht e realizueshme bazuar vetëm në vendimet subjektive të klientëve, përveç situatave ekstreme objektive që mund të ndodhin.

Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore

Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të


tërheqjeve në baza ditore (tabela 8), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite, ndahen 5 përqind të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jo-likuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit

Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenjë	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenjë	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK.

Grafik 68. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -Skenari 1



Burimi: BQK.

Sektori bankar në Kosovë nuk ka historik të krizave të mëparshme financiare dhe situatat e krijuara përgjatë dhe pas krizës pandemike nuk janë përkthyer në nivele të larta të tërheqjeve të depozitave. Në këto rrethana, janë supozuar nivele më ekstreme për të vlerësuar kapacitetin e sektorit bankar për të përballuar humbjet. Këto nivele më ekstreme janë bazuar në eksperiencat e vendeve të rajonit, të cilat kanë evidencë me situata të


tilla të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave në të kaluarën (tabela 8).

Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që pjesa më e madhe e bankave do të mund të përballonin tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore, deri në ditën e katërt, ku dy banka do të rezultonin të kenë nevojë për mjete likuide shtesë. Në ditën e pestë, probleme me likuiditet do të paraqiteshin në katër banka, duke përfshirë këtu edhe tri banka me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë do të arrinte në 169.9 milionë euro (grafik 68, tabela 9). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në sektorin bankar në ditën e pestë do të arrinte në 38.3 përqind të gjithsej depozitave (tabela 9).

Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj

Megjithëse pozita financuese e bankave përgjithësisht konsiderohet të jetë stabile, e trashëguar nga praktikat e mira ndër vite, zhvillimet e fundit në ekonomi dhe tregun financiar me rritjen e normave të interesit kanë lëkundur stabilitetin e likuiditetit, duke rritur ndjeshmërinë ndaj këtij rreziku. Rritja e presioneve konkurruese në tregun e depozitave në vend mund të rrezikoj dhe rezultoj në rritje të koncentrimin të depozitave. Rrjedhimisht, me shtimin e ofertave tërheqëse për depozitim, mund të rrezikohet largimi i depozitorëve nga bankat më pak konkurruese duke kontribuar që në banka të tjera baza financuese të jetë më e koncentruar. Në qoftëse aplikohet testi i rezistencës (stres-testi), nën supozimin se brenda ditës pesë depozitorët më të mëdhenj do të tërheqin depozitat e tyre, atëherë pozita e likuiditetit në shumicën e bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë tërheqjet e depozitave nga pesë depozitorët më të mëdhenj. Megjithatë tri banka paraqiten të kenë financimin shumë më të koncentruar, duke rezultuar në gjendje jo-likuide nëse tre depozitorët më të mëdhenj tërheqen nga bankat e tyre, me ç'rast raporti kredi depozitë do të rritej deri në 191.0 përqind në njërin nga këto banka nga 73.6 përqind.

Grafik 69. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - Skenari 2



Ndërsa nën supozimin se njëzet depozitorët më të mëdhenj të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohet tutje në po këto tri banka. Mungesa e mjeteve për këto tri banka do të arrinte në 60.0 milionë euro (grafik 71, tabela 9). **Rezultatet e këtij skenari përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të financimit, përkatësisht depozitave, përjashtuar bankat që sapo kanë hyrë në treg. Gjithsesi çështja e menaxhimit të likuiditetit mbetet e ndjeshme, në kushtet e mundësive të kufizuara të BQK-së për ndërhyrje të shpejtë në treg në rast të një krize likuiditeti⁴⁵, sezonalitet të lartë të depozitave (cikli i biznesit dhe ndikimi i diasporës) si dhe situatave të reja në treg që dixhitalizimi bankar dhe informacioni i shpejtë i ka krijuar. Përhapja e shpejtë e panikut nga ndonjë ngjarje negative dhe për pasojë tërheqja shumë e shpejtë e depozitave, e mundësuar nga digjitalizimi, e nxitë ndjeshmërinë e secilës bankë ndaj rrezikut të likuiditetit.**

5.6.2.1 Niveli përballues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Rezultatet sugjerojnë se sektori bankar do të ishte në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të tretës (26.3 përqind) së gjithsej depozitave brenda ditës, pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë (grafik 69 dhe tabela 9).

Në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 19.0 përqind e që është bankë me rëndësi sistemike, ndërsa pragu më i lartë i tërheqjes është 80.0 përqind dhe 68.0 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedojnë këto banka si dhe faktit që janë në fazë fillestare të aktivitetit kreditor).

⁴⁵ Në mungesë të politik[ës] monetare dhe në dispozicion vetëm të disa instrumenteve të likuiditetit – e elaboruar më shumë tek pjesa e rrezikut të likuiditetit.

Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	4	-38.3%	(169,857)	126.9%
Skenari 2.1: Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenjë	3	-11.3%	(21,472)	88.2%
Skenari 2.2: Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenjë	3	-17.4%	(59,999)	94.8%
Pragu - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-26.3%	(113,512)	106.2%

Burimi: BQK.

Kutia 5. Vlerësimi i integritetit të menaxhimit të rreziqeve nga ndryshimet klimatike në sektorin bankar

Dinamikat që kanë karakterizuar globin në aspekt mjedisor dhe sfidat gjithmonë në rritje në adresim të rreziqeve që shoqërojnë këtë dimension janë përcaktuar në krye të agjendave ndërkombëtare veçanërisht në vitet e fundit. Ndryshimet klimatike tashmë janë identifikuar si burim rreziku për stabilitetin e përgjithshëm financiar, dhe bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse financiare kanë ndërmarrë iniciativa në ndërtimin e kapaciteteve analitike dhe modeluese për të adresu ndjeshmërinë e sistemit financiar ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo analizë, që përbën një vazhdimësi të analizës së fokusuar në raportin e fundit të stabilitetit financiar⁴⁶, elaboron mbi gjetjet e një ankete të realizuar me bankat në vend. Anketa në fjalë u realizua në kuadër të iniciativës për draftimin e Strategjisë së Gjellbër të BQK-së, përmes asistencës teknike nga FinSAC. Në anketë ishin pjesëmarrëse shtatë banka, nga gjithsej dymbëdhjetë që operojnë në Kosovë, e të cilat përbëjnë rreth 93 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar.

Anketa ka pasur për qëllim vlerësimin e shkallës në të cilën bankat kanë përfshirë aspektin e ndryshimeve klimatike në kornizat e tyre të qeverisjes, në strategjitë, në praktikat e menaxhimit të rrezikut, në analizën e 'Stress-Test', në funksionet e mbikëqyrjes dhe aktivitetet e kreditimit dhe investimit. Gjetjet në këtë anketë ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut klimatik aktual në sektorin bankar dhe ofrojnë udhëzime për veprimet e nevojshme në rritjen e kapaciteteve në të ardhmen.

Anketa për këtë studim përbëhet nga 70 pyetje të ndara në disa seksione, të krijuara për të vlerësuar strukturën organizative të bankave, praktikat e menaxhimit të rrezikut, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe qasjen e tyre ndaj rreziqeve kryesore të cilat ndikohen nga rreziqet e ndërlidhura me ndryshimet klimatike. Pyetësi është i ndarë në dhjetë seksione kryesore (hijëzuar në analizë), ku secili fokusohet në aspekte të veçanta të operacioneve të bankave dhe menaxhimit të rrezikut.

Në seksionin e **pyetjeve të përgjithshme**, përgjigjet e bankave trajtojnë perceptimet dhe strategjitë e përgjithshme të tyre lidhur me ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe faktorëve mjedisorë në sektorin bankar. Në këtë kontekst, një pjesë e bankave (tre nga shtatë banka) e vlerësuan ndikimin e ndryshimeve klimatike si një nga rreziqet më relevante për bankat në ambientin e tanishëm. Tutje, dy banka theksuan rolin e bankave si akterë kryesorë në adresimin e rreziqeve të lidhura me klimën, duke pranuar rolin e rëndësishëm që ato kanë në avancimin e financimit të qëndrueshëm.

Në njërin anë, pjesa më e madhe e bankave (pesë banka) theksuan rrezikun fizik që lidhet me ndryshimet klimatike si rrezik në rritje në periudhë afatshkurtër, e që përfshinë ngjarjet natyrore relevante për vendin tonë si vërshimet, stuhitë apo thatësitrat. Ndërsa, rreziku i tranzicionit pritet të ndikoj sektorin në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Në anën tjetër, bankat e perceptuan si mundësi zhvillimin dhe ofrimin e produkteve të reja që lidhen me menaxhimin e ndryshimeve klimatike, siç janë produktet financiare të gjelbra.

⁴⁶ Raporti i Stabilitetit Financiar, numër 18. Kutia 5. Ndryshimet klimatike dhe rëndësia e tyre në stabilitetin financiar (https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/07/BQK_FSR_18.pdf)

Rezultatet tregojnë për potencial zhvillimi tutje në **strukturën organizative, administrimin dhe praktikën e menaxhimit të rrezikut** në aspekt të rreziqeve nga ndryshimet klimatike. Përderisa katër banka rezultojnë të kenë identifikuar një drejtor ekzekutiv përgjegjës për qëndrueshmërinë dhe rreziqet e ndërlidhura me ndryshimet klimatike, tre banka nuk i kanë caktuar në mënyrë specifike këto përgjegjësi. Për më tepër, në aspekt të ndarjes adekuate të resurseve, tre banka deklaruan që kanë resurse të mjaftueshme, ndërsa një bankë deklaroi për mungesë të tyre, si dhe tre bankat tjera theksuan se planifikojnë t'i adresojnë këto mungesa përmes trajnimeve apo rekrutimeve. Ndërkohë që një numër bankash (tre banka) kanë krijuar raportime dhe diskutime të rregullta mbi qëndrueshmërinë dhe rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike në nivelet e larta drejtuese, një pjesë tjetër (dy banka) nuk i ka adaptuar aktualisht këto praktika. Megjithatë, ka plane prej dy bankave tjera për të adaptuar praktikën e raportimit dhe diskutimit të rregullt në të ardhmen e afërt.

Seksioni i **sistemeve të kontrollit të brendshëm** u fokusua në strategjitë e bankave për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë tolerancën, kufijtë, identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut.

Sa i përket strategjive të menaxhimit të rrezikut, tre banka kanë zhvilluar objektiva kualitative dhe/ose kuantitative të qëndrueshmërisë mjedisore dhe i kanë integruar ato në strategjitë e tyre të rrezikut, dy banka nuk kanë aplikuar qasje të tillë, dhe dy bankat e mbetura deklaruan se planifikojnë vendosjen e këtyre objektivave në të ardhmen. Si një ndër nxitësit kryesor të ndikimit të ndryshimeve klimatike në sektorin bankar, e që lidhen njëkohësisht edhe me strategjitë e rrezikut të bankës, ishte rreziku fizik, e deklaruar nga tre banka të anketuara. Për më tepër, tre nga shtatë banka pjesëmarrëse në anketë kanë lansuar produkte të gjelbra si për individë ashtu edhe për ndërmarrje.

Rezultatet e anketës treguan se vetëm dy banka kanë përfshirë një përshkrim të mirë-përcaktuar të rreziqeve nga ndryshimet klimatike në inventarin e tyre të rrezikut. Sidoqoftë, pesë banka kanë përfshirë deklarata kualitative për shmangien e ekspozimit ndaj klientëve ose aktiviteteve ekonomike të caktuara, bazuar në ndikim mjedisor që bartin, duke treguar një qasje proaktive ndaj menaxhimit të rreziqeve nga ndryshimet klimatike. Kufizimi i ekspozimeve ndaj sektorëve të caktuar përbën edhe limitet e përcaktuara nga bankat ndaj rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike, ku

saktësisht katër banka i aplikuan këto limite. Në anën tjetër, edhe pse rreziku fizik u pa si nxitësi kryesor dhe rreziku më eminent, asnjë nga bankat nuk kanë aplikuar limite në aspektin gjeografik (lokacione specifike) për të shmangur zonat më të ndjeshme ndaj ngjarjeve klimatike, si vërshimet, thatësira apo stuhitë.

Tutje, vetëm dy banka kanë identifikuar rreziqet nga ndryshimet klimatike si rreziqe materiale. Njëkohësisht, edhe pse këto rreziqe janë përfshirë në inventarin e tyre të rrezikut, ato nuk janë trajtuar si rreziqe individuale të veçanta, mirëpo të integruara në rreziqet ekzistuese.

Sa i përket kapacitetit të bankave për vlerësimin e rrezikut të tranzicionit, katër bankat të cilat pohuan posedimin e kapaciteteve për të vlerësuar këtë rrezik aktualisht janë në proces të vlerësimit. Ndërsa, sa i përket vlerësimit të rrezikut fizik, vetëm dy banka pohuan kapacitetet për një vlerësim të tillë, e që gjithashtu janë aktualisht në proces të vlerësimit. Pengesat kyçe në vlerësimin e këtyre rreziqeve rezultojnë të jenë mungesa e njohurive teknike dhe resurseve në këtë fushë, mungesa e të dhënave, si dhe mungesa e rregullativës dhe udhëzimeve ligjore.

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e bankave (gjashtë banka) nuk i kanë përfshirë ende rreziqet fizike dhe mjedisore që rrjedhin nga ndryshimet klimatike në kriteret e tyre për vendimmarrjen dhe në procedurat për zbutjen e rrezikut. Kjo sugjeron që bankat nuk i kanë integruar plotësisht rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike në kornizat e tyre të zbutjes së rrezikut.

Në aspektin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit, anketa shqyrtoi qasjen e bankave për menaxhimin me të dhëna për rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike, zhvillimin e infrastrukturës së brendshme, përdorimin e burimeve të jashtme të të dhënave, si dhe publikimin e të dhënave përkatëse. Rezultatet tregojnë se vetëm një nga bankat ka infrastrukturë të brendshme më të avancuar të të dhënave, duke prodhuar të dhëna si të dhënat e emetimeve, strategjitë dhe objektivat për ndryshimet klimatike, probabiliteti i ngjarjeve potenciale të rrezikut fizik, si dhe të dhëna granulare gjeografike. Ndërsa, një bankë tjetër ka iniciuar anketë në lidhje me rreziqet nga ndryshimet klimatike me klientët e tyre të profilit korporata. Në anën tjetër, asnjë nga bankat nuk posedon apo merr të dhëna nga burimet e jashtme. Gjithashtu, këto të dhëna nuk publikohen nga asnjë bankë.

Rezultatet e anketës tregojnë se aktualisht asnjë nga bankat nuk ka përfshirë rreziqet nga ndryshimet klimatike në analizën e tyre të ‘Stress Test’. Megjithatë, dy banka planifikojnë për të integruar këto rreziqe në të ardhmen. Arsyet për mos përfshirjen e këtyre rreziqeve përfshijnë nevojën për udhëzim, mungesën e burimeve, mungesën e një kërkesë rregulative, si dhe mos përfshirjen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike në politikat e bankës.

Funksionet e mbikëqyrjes brenda sektorit bankar përbëhen nga tre komponentë kryesorë: funksioni i menaxhimit të rrezikut, funksioni i pajtueshmërisë (ang. ‘compliance’) dhe funksioni i auditimit të brendshëm. Këto funksione veprojnë së bashku për të siguruar identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve, duke përfshirë edhe rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike.

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e bankave (pesë banka) kanë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e funksionit të menaxhimit të rrezikut për rreziqet nga ndryshimet klimatike. Megjithatë, bankat dhanë përgjigje të përziera sa i përket mjaftueshmërisë së kapaciteteve njerëzore dhe teknike për mbikëqyrjen e këtyre rreziqeve, me një numër të barabartë bankash që deklarojnë mjaftueshmëri dhe pamjaftueshmëri, saktësisht tre banka. Tutje, pesë banka kanë ndërmarrë veprime për të përmirësuar kapacitetet e tyre për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike, ndërsa një pakicë nuk ka përcaktuar ndonjë veprim specifik. Kjo tregon se ndërsa është bërë përparim në përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë, ka ende nevojë që bankat të sigurojnë se kanë aftësitë e duhura dhe të ndërmarrin masa të vazhdueshme përmirësi për të mbikëqyrur në mënyrë efektive rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin.

Rezultatet e anketës tregojnë se pjesa më e madhe e bankave (pesë banka) nuk kanë përcaktuar funksione të qëndrueshmërisë apo të lidhura me ndryshimet klimatike brenda funksionit të pajtueshmërisë (ang. compliance). Përderisa, një pakicë bankash (dy banka) kanë verifikuar mos përfshirjen në praktikatat e ‘greenwashing’⁴⁷ dhe kanë aftësi të mjaftueshme në funksionin e pajtueshmërisë për të mbikëqyrur rreziqet nga ndryshimet klimatike, një numër i konsiderueshëm

bankash (pesë banka) treguan mungesë aftësish në këtë drejtim.

Tutje, tre banka kanë përfshirë rreziqet e lidhura me klimën dhe mjedisin në planet e tyre vjetore të auditimit, duke demonstruar njohjen e rëndësisë së vlerësimit të këtyre rreziqeve nga funksioni i auditimit të brendshëm. Megjithatë, katër banka deklaruan që auditimi i brendshëm nuk ka kryer rishikime të sistemit të tyre për menaxhimin e rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike dhe mjedisin.

Në seksionin e **rrezikut kreditor**, gjetjet e anketës sugjerojnë se shumica e bankave (gjashtë banka) duhet ende të integrojnë plotësisht rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike në politikat dhe praktikatat e tyre të menaxhimit të rrezikut kreditor. Edhe pse disa banka kanë ndërmarrë hapa fillestarë për të njohur këto rreziqe, ka ende vend për përmirësim në përfshirjen e vazhdueshme të ndikimeve të ndryshimeve klimatike, informacioneve mbi intensitetin e karbonit dhe faktorëve mjedisorë në vlerësimin dhe në koston e rrezikut kreditor. Rezultatet e anketës sugjerojnë se asnjë nga bankat aktualisht nuk merr në konsideratë rreziqet nga ndryshimet klimatike kur përcaktojnë klasifikimet kreditore ose kur llogarisin probabilitetin e mospagimit (ang. ‘Probability of Default – PD’) dhe humbjen nga mospagimi (ang. ‘Loss Given Default – LGD’). Megjithatë, dy nga bankat shprehën synimet e tyre për të përfshirë këta faktorë në të ardhmen. Për më tepër, gjetjet e anketës tregojnë se aktualisht vetëm një bankë kryen vlerësime periodike ose ad-hoc të kolateralit të ndikuar nga ndryshimet klimatike përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë. Së fundi, rezultatet e anketës tregojnë se shumica e bankave duhet të zhvillojnë ende një politikë kreditimi të qëndrueshëm për mjedisin ose të krijojnë një sistem për vlerësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të portofolit të tyre kreditor për rreziqet nga ndryshimet klimatike.

Seksioni i **rrezikut të tregut** shqyrtoi integrimin e kritereve që lidhen me ndryshimet klimatike (shembull, përjashtimi i aktivitetëve të caktuara që kontribuojnë në ndryshimet klimatike apo projekte të fokusuar në reduktimin e konsumit të energjisë) në politikat dhe procedurat e investimeve të bankave. Gjetjet e anketës zbuluan se vetëm dy banka kanë përfshirë kritere specifike në lidhje me

⁴⁷ Praktikatat e prezentimit të bankës, në përgjithësi, apo aseteve, të ardhurave apo zërave tjerë, në veçanti, si të qëndrueshëm për mjedisin, kur në fakt nuk janë të tilla. Shembuj mund të jenë: a) zotime false mjedisore, b) mungesa e transparencës mbi praktikatat e tyre të

investimeve, c) pretendime për investime të gjelbra, ku vetëm një pjesë marginale e investimeve janë të tilla, si dhe d) përdorimi i komunikimit jo të qartë për iniciativa mjedisore, pa definicione të qarta.

faktorë që lidhen me ndryshimet klimatike në politikat e tyre të investimeve. Ndonëse kjo tregon një progres, vlen të përmendet se pjesa tjetër e bankave nuk i ka përfshirë ende këto kritere. Megjithatë, një bankë është në proces të zhvillimit të politikave dhe procedurave për të integruar kritere të tilla në politikën e tyre të investimeve.

Seksioni i **rrezikut të likuiditetit** shqyrtoi përdorimin e instrumenteve të financimit të gjelbër nga bankat, si fletë-obligacionet e gjelbra (ang. 'green bonds'), si pjesë e strategjive dhe politikave të tyre të menaxhimit të likuiditetit. Rezultatet e anketës zbuluan se asnjë nga bankat në vend nuk ka emetuar instrumente të financimit të gjelbër dhe nuk kanë planifikuar për një gjë të tillë në të ardhmen e afërt. Ky zhvillim është i pritshëm bazuar në mungesën e tregut të kapitalit dhe infrastrukturës bazike për tregtimin e këtijlloj instrumenti.

Në seksionin e **rrezikut operacional**, rezultatet e anketës tregojnë që pesë banka marrin në konsideratë rrezikun e vazhdimësisë së punës të nxitur nga rreziku fizik nga ndryshimet klimatike, si dhe kanë përfshirë emergjencat fizike të ndikuara nga ndryshimet klimatike në planet e vazhdimësisë së biznesit dhe planet e rikuperimit pas fatkeqësive. Gjithashtu, pesë banka kanë regjistruar materializim të rrezikut operacional si pasojë e ngjarjeve natyrore nga ndryshimet klimatike. Njëkohësisht, gjashtë banka deklaruan se kanë siguruar operacionet e tyre nga ngjarjet klimatike si zjarri, vërshimet e stuhitë, megjithatë sigurimi në fjalë nuk është specifik për rreziqet nga ndryshimet klimatike. Vetëm dy nga bankat kanë përfshirë rrezikun fizik nga ndryshimet klimatike në politikat e tyre të menaxhimit të rrezikut operacional. Këto rezultate tregojnë se ka ndryshime në shkallën në të cilën bankat kanë integruar rreziqet nga ndryshimet klimatike në praktikat e tyre operationale. Pengesat e identifikuar nga bankat përfshijnë mungesën e të dhënave dhe metodologjive, mungesën e udhëzimeve të jashtme, mungesën e burimeve dhe ekspertizës në këtë fushë, si dhe mungesën e ndërgjegjësimit të klientëve.

Në seksionin e **rolit të Bankës Qendrore**, pjesa më e madhe e bankave (gjashtë banka) besojnë se Banka Qendrore duhet të luajë një rol në rregullimin e rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike. Forma e preferuar e përfshirjes është përmes rregullimit, megjithëse udhëzimet shihen gjithashtu si të dobishme. Bankat shprehën gjithashtu nevojën për udhëzime nga Banka Qendrore për menaxhimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike, dhe mirëpresin aktivitete për

shkëmbimin e njohurive nga Banka Qendrore. Këto gjetje tregojnë një vlerësim të ndikimit dhe të udhëzimeve potenciale të Bankës Qendrore në promovimin e praktikave efektive të menaxhimit të rrezikut nga ndryshimet klimatike brenda sektorit bankar në Kosovë.

Mangësitë dhe fushat potenciale për përmirësim

Rezultatet e anketës ofrojnë informata të vlefshme që mund të udhëzojnë përmirësimet e ardhshme në praktikat e menaxhimit të rrezikut nga ndryshimet klimatike në sektorin bankar. Bazuar në gjetjet, ka disa fusha ku bankat mund të përqendrojnë përpjekjet e tyre për avancim, në mënyrë që të rrisin qëndrueshmërinë e tyre ndaj rreziqeve nga ndryshimet klimatike.

Fillimisht, bankat duhet të forcojnë më tej qeverisjen duke ofruar mandate dhe përgjegjësi të qarta për strukturat e dedikuara përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike. Kjo përfshin sigurimin që këto struktura të kenë ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të mbikëqyrur dhe menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike. Për më tepër, bankat duhet të konsiderojnë integrimin e këtyre rreziqeve në diskutimet e tyre në nivel bordi dhe në proceset e vendimmarrjes, për të nxitur një kulturë të ndërgjegjësimit dhe llogaridhënies për ndryshimet klimatike dhe mjedisin.

Së dyti, bankat duhet të përmirësojnë kuadrin e tyre të menaxhimit të rrezikut duke integruar më tej rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike në proceset e tyre të identifikimit, vlerësimit dhe zbutjes së rrezikut. Kjo nënkupton përfshirjen e faktorëve të lidhur me ndryshimet klimatike në vlerësimet e rrezikut të kredisë, në skenarët e analizës 'Stres Test' dhe në masat për zbutjen e rrezikut. Bankat gjithashtu mund të eksplorojnë përdorimin teknikave të analizës së skenarëve të mundshëm, për të kuptuar dhe për të kuantifikuar ndikimin e mundshëm të rreziqeve nga ndryshimet klimatike në portfolion e tyre.

Për më tepër, ekziston nevoja për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre për të mbështetur menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike. Në këtë aspekt, bankat duhet të investojnë në infrastrukturë dhe sisteme të të dhënave që mundësojnë mbledhjen, grumbullimin dhe analizimin e të dhënave nga ndryshimet klimatike. Kjo përfshin bashkëpunimin me palët përkatëse të interesit për të përmirësuar disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave, si dhe eksplorimin e partneriteteve me burime të jashtme të të dhënave

për të siguruar qasje në databazat e specializuara të të dhënave në këtë fushë.

Së fundi, bashkëpunimi efektiv dhe shkëmbimi i njohurive ndërmjet bankave dhe BQK-së është thelbësor për avancimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut nga ndryshimet klimatike. Bankat duhet të angazhohen në mënyrë aktive për të ndarë praktikat më të mira dhe për të marrë pjesë në iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve. Banka Qendrore, nga ana tjetër, duhet të vazhdojë të hartoj

dhe implementojë udhëzime dhe finalizoj kuadër rregullues, si dhe të ofroj mbështetje për bankat në zbatimin e kornizave efektive të menaxhimit të rrezikut lidhur me ndryshimet klimatike.


Duke u fokusuar në këto fusha për përmirësim, sektori bankar mund të rris aftësinë për identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike, duke kontribuar kështu në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit financiar.

6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Sektori pensional në vitin 2022 shënoi rritje dukshëm më të ngadalësuar kundrejt vitit paraprak, kryesisht si pasojë e zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare me dinamikat e krijuara si pasojë e tensioneve gjeopolitike dhe presioneve inflacioniste.

Grafik 70. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Sektori pensional në vitin 2022 u karakterizua me ngadalësim të theksuar të aktivitetit kundrejt vitit paraprak. Vlera asetëve arriti në 2.42 miliardë euro në fund të vitit 2022, që përkon me një rritje vjetore prej 2.4 përqind (grafik 70). Kjo rritje më e ngadalësuar ishte rrjedhojë e performancës negative të kthimeve nga investimeve, përderisa arkëtimet prej kontributdhënësve u rritën kundrejt vitit të kaluar dhe paraqesin të hyra stabile për fondet pensionale. Përpjekjet e bankave qendrore drejtë kontrollimit të inflacionit përmes shtrëngimit të politikave monetare përçuan sinjale në korrelacion të zhdrejtë me çmimet e aksioneve e obligacioneve dhe për pasojë, ndikuan negativisht në kthimet e investimeve duke filluar qysh nga tremujori i parë i vitit që u theksua tutje në tremujorin e dytë. Vetëm në tremujorin e katërt të vitit u evidentua një normalizim dhe realizua kthim pozitiv në investime. Sektori pensional vazhdon të ketë nivel stabil dhe në rritje të kontributeve të arkëtuara prej kontributdhënësve. Kjo rritje si në vlerë të kontributeve të arkëtuara dhe numër të kontributdhënësve është edhe si

rezultat i politikave (lehtësirave) fiskale për të stimuluar formalizimin e sektorit privat.

Zhvillimet në sektorin pensional vazhdojnë të diktohen nga performanca e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që ka pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit (99.6 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 13.1 përqind (9.8 përqind në vitin 2021), vlera e të cilave arriti në 242.1 milionë euro në fund të vitit. Kurse, sa i përket performancës financiare, sektori pensional mbylli vitin 2022 me kthim negativ në vlerë prej 118.9 milionë euro.


Struktura e asetëve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm. Mirëpo, për dallim nga viti paraprak, investimet jashtë vendit kanë shënuar rënie të pjesëmarrjes si rrjedhojë e prospekteve negative që nga fundi i tremujorit të parë të vitit 2022. Në fund të vitit 2022, portfolio investuese në tregjet e huaja kishte vlerën prej 1.69 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore për 6.5 përqind (rritje vjetore prej 33.7 përqind në vitin 2021).

Investimet jashtë vendit në dhjetor 2022 kishin pjesëmarrje prej 70.2 përqind të gjithsej asetëve të FKPK-së (76.9 përqind në vitin 2021). Ndërsa, investimet brenda vendit shënuan zgjerim të pjesëmarrjes në gjithsej asetet e FKPK-së, në 29.8 përqind në fund të vitit 2022 (23.1 përqind në vitin 2021). Vlera e investimeve brenda vendit u rrit në 719.5 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 32.1 përqind (grafik 71).

Në kuadër të investimeve brenda vendit, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdojnë të jenë kategoria me peshën më të madhe, pasuar nga ajo e certifikatave të depozitit dhe parasë së mbajtur në vend. Mirëpo, pesha e letrave me vlerë u zvogëlua për 13.3 pikë përqindje në 77.0 përqind (90.3 përqind në vitin 2021), kundrejt

rritjes së certifikatave të depozitit për 10.8 pikë përqindje, në 19.0 përqind (8.2 përqind në vitin 2021). Pesha e parasë së mbajtur në BQK në gjithsej mjetet e mbajtura brenda vendit u rrit në 4.0 përqind, nga 1.5 përqind pjesëmarrje në vitin 2021.

Grafik 71. Struktura e investimeve të sektorit pensional




Burimi: BQK.

Si rezultat i pasigurive në sektorin e jashtëm dhe humbjeve financiare përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit, FKPK-ja një pjesë të konsiderueshme të mjeteve investoi / mbajti brenda vendit. Si rrjedhojë e fillimit të rritjes së normës së interesit në depozita nga bankat vendore, FKPK-ja një pjesë të konsiderueshme të mjeteve i plasoi në bankat vendore në formë të Çertifiaktave të Depozitit. Në fund të dhjetorit 2022, kjo kategori arriti vlerën prej 136.9 milionë euro (44.8 milionë euro në fund të vitit 2021). Edhe investimet në tregun e brendshëm të letrave me vlerë shënuan rritje, por me ritëm më të ulët krahasuar me atë të Çertifiaktave të Depozitit. Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në fund të vitit 2022 arritën vlerën prej 553.7 milionë euro (491.5 milionë euro në fund të vitit paraprak). Në fund të dhjetorit 2022 vlera e gjithsej asetëve të FKPK-së arriti në 2.41 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (rritje vjetore prej 18.2 përqind në vitin 2021).

Në fund të vitit 2022, vlera e gjithsej asetëve të FSKP-së ishte 8.6 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 9.4 përqind. Arkëtimet e reja shënuan vlerën prej 608.4 mijë euro, që përkon me një rënie vjetore

prej 11.3 përqind (grafik 72), ecuri e ngjashme me atë të FKPK-së.

Grafik 72. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale



Burimi: BQK.

Pjesa më e madhe e asetëve të FSKP-së vazhdon të investohet jashtë vendit, përkatësisht 75.9 përqind e gjithsej asetëve. Ngjashëm me ecurinë e investimeve të FKPK-së përgjatë vitit 2022, edhe FSKP-ja zvogëloi prezencën në tregun e jashtëm, duke rritur nivelin e investimeve në sektorin e brendshëm si rezultat i luhatjeve në tregjet e jashtme përgjatë pjesës më të madhe të vitit 2022. Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve (85.4 përqind), letrave me vlerë (6.6 përqind), dhe parasë së gatshme (8.0 përqind). Në anën tjetër, investimet në Kosovë u rritën për 3.4 pikë përqindje, me pjesëmarrje prej 24.1 përqind të gjithsej asetëve të FSKP-së. Investimet në tregun e brendshëm ishin të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (61.0 përqind), depozita në bankat komerciale (1.4 përqind), para të gatshme në trezor të FSKP-së (11.6 përqind), dhe të tjera (26.0 përqind).

6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Dinamikat e krijuara në tregjet financiare ndërkombëtare të shoqëruara me përkeqësim të tensioneve gjeopolitike, presione inflacioniste, presione në tregjet e punës dhe së fundmi, shtrëngim të politikave monetare, u reflektua në luhatshmëri të tregjeve të jashtme, duke ndikuar kështu

performancën financiare edhe të sektorit pensional.


Grafik 73. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2022 kishte kthim negativ nga investimet në vlerë prej 118.9 milionë euro, kundrejt fitimit rekord të një viti më parë prej 227.3 milionë euro. Çmimi i njësisë së FKPK-së ra në 1.63 euro, nga 1.72 euro sa ishte një vit më parë (ditën e fundit të vitit) (grafik 73).

Grafik 74. Performanca financiare e Fondit Sllveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK.

Ecuri të ngjashme kishte edhe FSKP-ja, që shënoi kthim negativ nga investimet në vlerë prej 0.8 milionë euro, kundrejt fitimit prej 1.1 milionë euro një vit më parë. Po ashtu, edhe çmimi i aksionit të FSKP-së ra në 179.67 euro nga 198.77 euro sa ishte një vit më parë (grafik 74).

Megjithë pasiguritë ende të larta, viti 2023 pritet të jetë vit më i favorshëm për ekonominë globale edhe sektorin financiar në përgjithësi, kryesisht si rezultat i normalizimit deri në një

masë të disa çmimeve në bursë, zvogëlimi të hendekut kërkesë/ofertë dhe zbutjes së tensioneve gjeo-politike në nivel global.

6.2 Sektori i Sigurimeve


6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve për të katërtin vit me radhë shënoi rritje dyshifrore në asete, kryesisht ndikuar prej burimit kryesor financues – primeve të shkruara nga policat e shitura. Po ashtu, sektori për të tretin vit me radhë operoi me rezultate pozitive financiare.

Me një pjesëmarrje prej 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia.

Niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit të sektorit të sigurimeve shënoi një rritje marginale vjetore (grafik 75).

Grafik 75. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian në 1.50 përqind (1.48 përqind në vitin 2021). Ngjashëm i ulët mbetet niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2022 shënoi vlerën prej 73.9 euro (64.8 euro në vitin 2021).⁴⁸

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e siguruesve 'jo-jetë', që përfaqësojnë 91.6 përqind të aseteve të


(prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 6.80 përqind.

⁴⁸ Sipas statistikave të publikuara në databazën e Insurance Europe, niveli i densitetit në vitin 2020 në 32 vende të Evropës ishte 3,679 Euro

tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e siguruesve 'jetë'.

Mbi gjysma e tregut të sigurimeve përfaqësohet nga siguruesit vendor (56.5 përqind), përderisa pjesa tjetër nga siguruesit me origjinë të huaj. Në kuadër të kompanive me kapital të huaj, siguruesit nga Shqipëria vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në asete, pasuar nga siguruesit nga Sllovenia dhe siguruesit nga Austria (grafik 76).

Grafik 76. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2022)



Burimi: BQK.

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me sektorët tjerë të sistemit financiar. Mirëpo, në tri vitet e fundit është shënuar rritje e lehtë e koncentrimit, veçanërisht në asete, si rezultat i likuidimit të dy siguruesve (një në vitin 2019 dhe një tjetër gjatë vitit 2021). Krahasuar me një vit më parë, Indeksi Herfindahl⁴⁹ për primet e shkruara bruto (PSHB) mbeti i pandryshuar në 981 pikë. Po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, por krahasuar me një vit më parë, rezulton të jetë rritur për 15 pikë bazë në 928 pikë për vitin 2022


Në të njëjtën kohë, indeksi CR5⁵⁰ për vitin 2022, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve, rezulton 58.2 përqind

⁴⁹ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n \frac{1}{S} \left(\frac{s_i}{S} \right)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto - PSHB) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi

(56.6 përqind në vitin 2021), ndërsa i llogaritur në raport me asetet, rezulton 53.5 përqind (53.3 përqind në vitin 2021). Pra, rritja e lehtë e koncentrimit si në raport me asetet ashtu edhe primet e shkruara bruto reflekton zvogëlimin e numrit të siguruesve në vitet e fundit, ndërsa koncentrimi është më i lartë në tregun e siguruesve që ofrojnë shërbime të sigurimit 'jetë' për shkak të numrit të ulët të tyre.

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 269.7 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 12.1 përqind (grafik 77). Sigurimet "jo-jetë" shënuan rritje vjetore prej 12.4 përqind dhe përfaqësuan 91.6 përqind të gjithsej aseteve të sektorit në fund të vitit 2022. Ndërsa, sigurimet "jetë", që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind.

Grafik 77. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara – të cilat rrjedhin prej primeve të shkruara (policave të shitura). Në vitin 2022, edhe kategoria e dytë për nga pesha shënoi rritje, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës (grafik 78), megjithëse më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë si rezultat i nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës. Po ashtu, edhe konkurrenca për të blerë borxh shtetëror të


shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁵⁰ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

Kosovës nga sektori bankar dhe ai pensional kanë ndikuar në rritjen më të ngadalësuar të kësaj kategorie në kuadër të aseteve të sektorit të sigurimit. Zërat tjerë bilancor shënuan rritje, me përjashtim të investimeve në prona, që është njëra nga dy kategoritë me peshën më të ulët në kuadër të aseteve.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 64.0 përqind, pasuar nga ekuiteti me 25.2 përqind dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (grafik 79).


Grafik 78. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve (dhjetor 2022)



Vlera e kapitalit ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë si rrjedhojë e fitimit më të ulët të realizuar në vitin 2022, por që operimi me fitim për të tretin vit me radhë ka ndikuar në zvogëlim të mëtejshëm të humbjeve të bartura nga vitet e kaluara. Si rrjedhojë, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite nga sektori u zvogëluar për 5.4 milionë euro, në 36.9 milionë euro në fund të vitit 2022.

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore kundrejt vitit të kaluar, si rrjedhojë e bazës së ulët të primeve të shkruara në vitin 2020 (si rezultat i shpërthimit të pandemisë Covid-19). Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2022 arriti në 134.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind (18.2 përqind në vitin 2021).

Grafik 79. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2022)




Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “jo-jetë” të cilat përfaqësojnë 95.2 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jo-jetë” në vitin 2022 arriti në 127.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.5 përqind (grafik 80). Kjo rritje e primeve të shkruara të kategorisë ‘jo-jetë’ është reflektuar edhe në rritjen e volumit të policave të shitura në vitin 2022, përkatësisht në 1.32 milionë sosh, një rritje vjetore prej 15.1 përqind⁵¹. Sigurimet “jo-jetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 58.9 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara “jo-jetë”, ndërsa pjesa tjetër përfshinë sigurimet vullnetare.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 6.4 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 31.5 përqind krahasuar me vitin 2021, kryesisht si rezultat i rritjes së primeve të kategorisë ‘Jeta e debitorit’ (“sigurimi i jetës”), nga 1.6 milionë euro në 3.1 milionë euro.

Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 7.1 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (tabela 10). Kurse, në kuadër të sigurimit vullnetar, është shënuar rritje e theksuar e kategorisë ‘Aksident dhe shëndet’ për 29.3 përqind, në 28.4 milionë euro prime të shkruara. Për më tepër, vetëm tek nënkategoria

⁵¹ Përfshihet vetëm sigurimi i jo-jetës.

Grafik 80. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK.

‘Sigurimi i Sëmundjeve’ në kuadër të ‘Aksident dhe shëndet’, numri i polisave të shitura në vitin 2022 është rritur për 86.8 përqind krahasuar me vitin e kaluar në 265.7 mijë sosh, e që është një sinjal pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve të cilët posedojnë sigurim shëndetësor. Për më tepër, niveli i primeve për kokë banori sa i përket sigurimit të shëndetit është rritur në 14.81 euro në vitin 2022, nga 11.30 euro sa ishte në vitin 2021.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e sigurveve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje vjetore për 5.4 përqind (24.4 përqind një vit më parë), duke arritur vlerën në 64.3 milionë euro në fund të vitit 2022 (61.0 milionë euro në vitin 2021). Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 55.5 milionë euro ishin dëme të paguara nga sigurvecit, ndërsa 8.8 milionë euro dëme të paguara nga BKS-ja.

Dëmet e paguara nga risigurvecit marrin pjesë me 19.5 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga sigurvecit⁵² (14.4 përqind në vitin paraprak). Rritja më e ulët e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve në vitin 2022 për 5.4 përqind kryesisht reflekton bazën më të lartë të vlerës së dëmeve të paguara një vit më parë, dhe jo domosdoshmërisht, ngadalësim të dëmeve të ndodhura në këtë vit.

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jetë” në vitin 2022 arriti vlerën prej 1.15 milionë euro (1.11 milionë euro një vit më parë), që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqind.

Tabela 10. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2021	Pjesëmarrja: 2022
Gjithsej Jo-jetë	112.5	127.7	13.5%	95.9%	95.2%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	60.0	63.2	5.4%	51.1%	47.1%
TPL+	3.0	3.6	18.8%	2.6%	2.7%
Sigurime kufitare	7.3	8.4	16.1%	6.2%	6.3%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	21.9	28.4	29.3%	18.7%	21.1%
Kasko	7.2	8.6	19.5%	6.1%	6.4%
Kredi dhe garancione	6.5	7.6	16.8%	5.6%	5.7%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	4.9	6.0	23.4%	4.1%	4.5%
Përgjegjësi e përgjithshme	1.8	1.9	7.2%	1.5%	1.4%
Gjithsej jetë	4.8	6.4	31.5%	4.1%	4.8%
Gjithsej tregu	117.4	134.0	14.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

⁵² Nuk përfshihet BKS-ja.

Tabela 11. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në miliona euro)


Aktiviteti	2021	2022	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2021	Pjesëmarrja: 2022
Gjithsej Jojetë	59.9	63.2	5.4%	98.2%	98.2%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	29.4	30.9	5.2%	48.2%	48.1%
TPL+	0.2	0.3	39.9%	0.4%	0.5%
Sigurime kufitare, FG, MoU	10.2	8.8	-13.3%	16.7%	13.7%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	10.6	13.0	22.3%	17.5%	20.3%
Kasko	4.6	5.5	19.9%	7.5%	8.5%
Kredi dhe garancione	1.0	1.8	86.2%	1.6%	2.9%
Sigurime në pronë	3.4	2.7	-20.3%	5.6%	4.2%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0	0.0%	0.0%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.5	0.0	-97.4%	0.8%	0.0%
<i>Gjithsej jetë</i>	1.1	1.1	3.3%	1.8%	1.8%
Gjithsej tregu	61.0	64.3	5.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara në vitin 2022 në kuadër të sigurimit “jo-jetë” u ndikua kryesisht prej pagesave të dëmeve të sigurimeve vullnetar ‘Aksident dhe Shëndet’; si dhe ‘MTPL-së’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm (tabela 11). Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare u rrit për 3.0 milionë euro krahasuar me vitin paraprak, në 23.1 milionë euro. Kurse, vlera e dëmeve të paguara nga sigurimit i detyrueshëm u rrit për 0.2 milionë euro, në 40.1 milionë euro në vitin 2022.

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në vitin 2022 u përmirësua për 4.0 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke zbritur në 48.0 përqind (grafik 81).

Grafik 81. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Kjo erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (primeve të arkëtuara) krahasuar me normën e rritjes së shpenzimeve (dëmeve të paguara) në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë (tabela 10 dhe 11).

6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 2.1 milionë euro, performancë më e dobët kundrejt vitit të kaluar kur kishte shënuar fitim neto në vlerë prej 6.3 milionë euro (tabela 12).

Siguruesit “jo-jetë” shënuan fitime në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 5.8 milionë euro në vitin 2021. Ndërsa, siguruesit “jetë” shënuan humbje në vlerë prej 413.1 mijë euro krahasuar me fitimet prej 492.4 mijë euro në vitin 2021. Zvogëlimi i fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve operative, përkatësisht kostos së blerjes së mallrave dhe shërbimeve (ndikuar nga presionet inflacioniste në vitin 2022) dhe shpenzimeve administrative (kryesisht kompensimit për punëtor). Po ashtu, krahasuar me vitin e kaluar, është evidentuar rritje e kategorisë së shpenzimeve për dëmet e ndodhura (vlerë dhe numër), e që është rezultat i rritjes së numrit dhe vlerës së primeve të shkruara.

Niveli i likuiditetit në sektorin e sigurimeve mbeti në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar (rënie marxhinale). Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave qëndroi në nivel prej 102.5 përqind (103.2 përqind në vitin 2021), si rezultat i

rritjes vjetore më të ngadalësuar të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 11.9 përqind, krahasuar me rritjen më të lartë prej 12.7 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Ngjashëm edhe raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

ndaj gjithsej detyrimeve zbriti në nivel prej 87.6 përqind, nga 89.2 përqind sa ishte një vit më parë.

Tabela 12. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022
Sigurimet Jojetë	-5.1	2.0	5.8	2.5
Sigurimet Jetë	0.5	0.3	0.5	-0.4
Gjithsejtë tregu	-4.7	2.3	6.3	2.1

Burimi: BQK.

6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar në vitin 2022 shënoi rritje të përshpejtuar të aseteve, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit dhe lizingjeve, që kryesisht u financuan nga huatë e marra nga sektori i jashtëm. Rezultati financiar tejkaloi nivelin e vitit të kaluar dhe rezultoi të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit mikrofinanciar, ndikuar nga rritja më e lartë e të hyrave kundrejt shpenzimeve. Megjithatë, në periudhat në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen e kostove të financimit për sektorin mikrofinanciar.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të financohet nga huazimet nga sektori i jashtëm, kapitali vetanak, si dhe huazimt tjera brenda vendit (kryesisht sektorit bankar). Marrë parasysh strukturën e financimit të këtij sektori, rritja e normave të interesit si rezultat i politikave të BQE-së për të frenuar inflacionin dhe zbutur atë në pragun nën 2.0 përqind mund të ndikoj në rritje të kostos së financimit të aktivitetit të sektorit mikrofinanciar. Një dinamikë e tillë do të reflektohej si në marzhën e fitimit të

sektorit, ashtu edhe në bartjen e kostos tek kredimarrësit përmes rritjes së normave të financimit për produktet kryesore (kreditim dhe lizing).

Asetet e sektorit arritën vlerën prej 400.8 milionë euro në vitin 2022, që korrespondon me një rritje vjetore prej 17.9 përqind; rritje të përshpejtuar krahasuar me një vit më parë. (grafik 82).

Grafik 82. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Në tregun vendor operojnë 30 institucione mikrofinanciare,⁵³ nga të cilat 13 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 78.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,528 pikë në vitin 2022, që paraqet rritje të lehtë të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,518 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më

⁵³ Këtu përfshihen edhe dhjetë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut. Po ashtu, nëse të dhënat krahasohen me vitet e kaluara mund të vëreni që ka dallim të theksuar në numrin e IMF-ve të raportuara këtë periudhë krahasuar me periudhat paraprake për shkak të ndryshimeve

metodologjike. Në numrin e IMF-ve përfshihen edhe IFJB me aktivitet të transferit të parave/pagesave/këmbimit, e që kanë ndikuar në rritje të theksuar të numrit të institucioneve financiare në këtë sektor.

të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u zvogëlua në 56.1 përqind, nga 56.5 përqind sa ishte në vitin 2021.


Kreditë vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe për nga pesha në kuadër të aseteve të sektorit, pasuar nga ajo e lizingjeve dhe kategoria e bilancit të mbajtur në bankat komerciale (grafik 83).



Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet, që përbëjnë 63.9 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbën 61.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Financimi nga sektori i jashtëm u rikuperua plotësisht nga viti kritik pandemik (2020), duke shënuar rritje vjetore 21.0 përqind në vitin 2022 (rritje për 3.6 përqind në vitin 2021), dhe arriti vlerën prej 247.2 milionë euro në fund të periudhës. Rritja e financimit prej sektorit të jashtëm pasqyron edhe prospektet pozitive në ekonominë vendore për vitin 2022, pavarësisht pasigurisë së krijuar nga zhvillimet negative gjeo-politike dhe prospekteve të tregjeve financiare si rrjedhojë e invazionit të Ukrainës nga Rusia, inflacionit të lartë si dhe politikave shtrënguese monetare nga bankat qendrore (BQE-ja, Rezerva Federale, Banka e Anglisë etj.)

Gjithsej stoku i kredive në sektorin mikrofinanciar në fund të vitit 2022 arriti vlerën prej 286.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.8 përqind (rritje vjetore prej 17.1


përqind në vitin 2021). Rritja e theksuar e kreditimit për të dytin vit me radhë reflekton kërkesën për kredi nga të dy segmentet, atë të ekonomive familjare (që kishin kontributin kryesor në rritjen e përgjithshme të kredive) dhe korporatave jofinanciare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 16.4 përqind dhe arriti vlerën prej 182.1 milionë euro në fund të periudhës. Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore prej 26.2 përqind dhe arritën në 104.4 milionë euro. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' dominojnë strukturën e këtyre kredive, pasuar nga ato me maturim "mbi 1 deri 2 vite" (grafik 84).



Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka ndjekur trendin e përgjithshëm, duke shënuar rritje në secilin segment. Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin për korporatat jofinanciare të IMF/IFJB-të prej 25.8 përqind (grafik 85). Për më tepër, ky segment kishte kontributin e dytë më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, duke shënuar rritje vjetore prej 25.4 përqind në vitin 2022 dhe arritur vlerën prej 26.9 milionë euro (grafik 86). Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancia e ofruar nga FKGGK-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të⁵⁴.

⁵⁴ Ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme (NMVM-të)


Grafik 85. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2022)



Burimi: BQK.

Krahasuar me një vit më parë, shumica e miratuar e kredive nga FKGK-ja për institucionet mikrofinanciare arriti në 5.6 milionë euro, një rritje kundrejtë vitit paraprak për 6.5 përqind. Si rrjedhojë e garancive prej FKGK-së, veçanërisht në dy vitete e fundit, IMF-të i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës për kredi për këtë sektor, që vlerësohet si sektor që bartë rrezik më të lartë. Me rritje dyshifrore gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe segmenti i industrisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë. Kreditimi ndaj segmentit të shërbimeve tjera⁵⁵ kishte kontributin dhe rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe.

Grafik 86. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK.

Lizingjet vazhduan të rriten me ritëm të lartë në vitet e fundit, ku kontributin kryesor e kishin lizingjet për korporatat jofinanciare ndërkohë që kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar (grafik

89). Lizingjet ndaj korporatave jofinanciare kanë një pjesëmarrje prej 61.4 përqind në gjithsej lizingjet. Kjo kategori e lizingjeve shënuan rritje vjetore prej 16.2 përqind dhe arritën vlerën prej 45.3 milionë euro. Sipas maturitetit të lizingjeve për korporatat jofinanciare, pjesa më e madhe dominohet nga lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 80.9 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 12.1 përqind.

Grafik 87. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Kurse, lizingjet ndaj ekonomive familjare, shënuan rritje më të ngadalësuar prej 7.1 përqind, duke arritur vlerën në 28.5 milionë euro në fund të vitit 2022. Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, ‘lizingu hipotekar’, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënoi rritje vjetore prej 6.4 përqind në vitin 2022 (1.0 përqind rritje vjetore në vitin e kaluar). Kjo kategori e lizingjeve kishte kontributin kryesor në rritjen e lizingjeve të ekonomive familjare në vitin 2022, pasi që përfaqësojnë rreth 71.5 përqind të lizingjeve ndaj këtij segmenti.

Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 52.1 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 31.3 përqind.


Rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore nga gjysma e vitit 2022 pritet të reflektohet në koston e

⁵⁵ Hotelet dhe Restorante, Tregti tjetër, Shfrytëzimi i shërbimeve financiare, patundshmëri, qera, Shërbime tjera etj.

financimit të sektorit dhe potencialisht, të përkthehet në aplikim më të lartë të normave të interesit për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare.

Normat e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënuan rënie të lehtë vjetore në 18.6 përqind, nga 19.4 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2021.


Grafik 88. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare ishin më të larta krahasuar me ato për korporatat jofinanciare. Norma mesatare e interesit në dhjetor 2022 për ekonomitë familjare zbriti në 20.7 përqind, rënie vjetore për 0.2 pikë përqindje. Kurse, norma mesatare e interesit ndaj korporatave jofinanciare, në dhjetor 2022 zbriti në 15.3 përqind, rënie vjetore për 2.1 pikë përqindje, (grafik 88).

Grafik 89. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, në baza vjetore, normat mesatare të interesit u zvogëluan për të gjitha veprimtaritë ekonomike - me theks të veçantë për sektorin e shërbimeve (grafik 89). Norma e interesit për kreditë për sektorin e bujqësisë

dhe atë të industrisë u zvogëluan për 1.7 dhe 1.9 pikë përqindje përkatësisht, duke qëndruar në 17.3 përqind në dhjetor 2022. Kurse, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve kishin normën më të ulët të interesit prej 13.8 përqind, rënie vjetore për 2.1 pikë përqindje.

6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar në vitin 2022 shënoi rezultate të larta financiare (fitim neto në vlerë prej 17.0 milionë euro), si rezultat i rritjes më të theksuar të hyrave kundrejt rritjes së shpenzimeve.

Grafik 90. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Të hyrat e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën në 56.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 14.9 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominuese të të hyrave (89.8 përqind), shënuan rritje vjetore prej 15.9 përqind (rritje për 3.0 përqind në vitin 2021), si rezultat i rritjesh së lartë të kreditimit në dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointerеси në vitin 2022 shënuan rritje për 6.6 përqind, por që kontributi i tyre në rritjen e gjithsej të hyrave ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej të hyrat (10.2 përqind).

Shpenzimet e sektorit arritën në vlerën prej 39.1 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 12.6 përqind. Në kuadër të shpenzimeve, rritja e evidentuar në nënkategorinë e shpenzimeve të jointerесit kryesisht i'u atribua shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 18.9 përqind (7.7 përqind një vit më parë), e që kryesisht i është

atribuar rritjes së shpenzimeve për punëtorë, dhe në masë më të ulët, atyre administrative. Rritja e numrit të personelit përgjatë vitit 2022 dhe rritja e pagave në sektor (si kundërpërgjigje ndaj shkallës së inflacionit) rezultojnë të kenë kontribuar në rritjen e kësaj nënkategorie të shpenzimeve të jointeredit. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (21.4 përqind të gjithë shpenzimeve) shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind në vitin 2022 (rënie prej 9.0 përqind një vit më parë), që kryesisht reflekton rritjen e nivelit të huazimeve prej sektorit të jashtëm.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar u përmirësua, duke u zvogëluar për 1.4 pikë përqindje, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të të hyrave kundrejt rritjes së shpenzimeve. Në vitin 2022, ky indikator qëndroi në 69.7 përqind (grafik 90).

Grafik 91. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Rezultatet financiare gjatë vitit 2022 u reflektuan dhe në treguesit tjerë të profitabilitetit të sektorit. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) shënoi rritje, në 4.9 përqind (4.6 përqind në vitin 2021), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) rënie marxhinale, në 16.5 përqind (17.0 përqind në vitin 2021) (grafik 91).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe mbulueshmëri të mirë me provizione (grafik 92). Mirëpo, dinamikat e përgjithshme makroekonomike

mike tregojnë për rritje të rrezikut si rezultat i rritjes së çmimeve dhe ngadalësimit ekonomik, si dhe aplikimit të politikave konservative nga bankat qendrore në nivel global (rritje të normave bazë të interesit). Ky sektor financiohet kryesisht nga huatë e marr nga sektori i jashtëm dhe rritja eventuale e kostos financuese mund të bartet tek klientët. Andaj, duke marrë për bazë faktin që të hyrat e disponueshme reale mund të jenë zvogëluar si rezultat i rritjes më të lartë të inflacionit kundrejt pagave në vitin e fundit; mund të ketë ndikim negativ në aftësinë paguese të klientëve në vitin e ardhshëm. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithë kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje në 1.8 përqind në fund të vitit 2022. Në të njëjtën kohë, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione qëndroi në 153.2 përqind (141.6 përqind në vitin 2021)

Grafik 92. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK.

Sektori i ndihmësve financiarë përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.4 përqind të gjithë asetëve. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP). Vlera e asetëve të ndihmësve financiar në vitin 2022 arriti në 35.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 45.1 përqind. Rritja e theksuar e asetëve të sektorit erdhi kryesisht si rezultat i ndryshimit të veprimtarisë së dy institucioneve financiar në vend, e që u reflektua në rritje të asetëve të sektorit të ndihmësve financiar.⁵⁶

⁵⁶ Një institucioni financiar i është ndërruar veprimtaria nga mikrofinancat në të ndihmësve financiar (ka ndikuar në rritje të

theksuar të asetëve të ndihmësve financiar për shkak të peshës së madhe). Kurse një institucioni tjetër financiar i është ndërruar veprimtaria nga ai i ndihmësve financiar në atë mikrofinancave, por që

Struktura e asetëve të ndihmësve financiar kryesisht përbëhet nga paraja e gatshme dhe ajo e mbajtur në sektorin bankar, që përbëjnë rreth 65.2 përqind të gjithsej asetëve. Kurse, pjesa tjetër prej 6.8 dhe 28.0 përqind përbëhet nga asetet fikse, përkatësisht asetet tjera. Sektori kryesisht financohet nga kapitali vetanak dhe huamarrjet, që përbëjnë 55.1 përkatësisht 40.8 përqind të gjithsej detyrimeve. Të hyrat e ndihmësve financiarë shënuan rritje vjetore prej 10.5 përqind dhe arritën vlerën në 11.3 milionë euro në fund të dhjetorit 2022.

Struktura e të hyrave të ndihmësve financiarë dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 59.3 përqind), të cilat u karakterizuan me rënie vjetore prej 1.3 përqind. Kategoria e dytë më e rëndësishme

për nga pesha, ajo e të hyrave tjera (39.9 përqind), shënoi rritje për 1.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë, në 4.5 milionë euro në vitin 2022, dhe njëherit kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej të hyrave. Shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 20.9 përqind, duke arritur vlerën në 8.4 milionë euro, e që është kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve të përgjithshme operative për 26.3 përqind krahasuar me një vit më parë. Kjo kategori përbënë rreth 90.2 të gjithsej shpenzimeve të sektorit, dhe pjesa tjetër përbëhet nga shpenzimet për interesa dhe shpenzimet për transferet. Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt ecurisë së të hyrave, sektori realizoi fitim prej 2.9 milionë euro në vitin 2022, që paraqet një rënie vjetore prej 11.5 përqind.

për shkak të peshë së ulët, nuk ka pasur ndikim të madh në sektorët respektiv.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN), që mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar si dhe shlyerjen e letrave me vlerë, është karakterizuar me rritje të theksuar si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve të realizuara përmes tij.

Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Numri i transaksioneve të përpunuara nga SPN në vitin 2022 arriti në 17.5 milionë (14.6 milionë në vitin 2021), që përbën një rritje vjetore prej 19.1 përqind (12.9 përqind në vitin paraprak). Gjithashtu, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara u rrit në 20.3 miliardë euro (17.2 miliardë euro

në vitin 2021), që paraqet një rritje vjetore prej 18.6 përqind (rritje vjetore prej 22.5 përqind në vitin 2021). Pagesat e rregullta masive dhe pagesat prioritare masive përfaqësuan rreth 78.7 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 13). Pagesat prioritare masive përfaqësojnë rreth 8.1 milionë transaksione të realizuara (46.6 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Kurse, pagesat masive të rregullta, përfaqësojnë rreth 5.6 milionë transaksione të realizuara (apo 32.1 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj. Ndërsa 0.7 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 13)

Tabela 13. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2021	2022	2021	2022
Të rregullta	14.3%	14.0%	11.5%	11.6%
Prioritare	4.0%	3.1%	42.3%	44.5%
Të rregullta - masive (pagesat nga tatimet, taksat, dogana, etj)	36.3%	32.1%	5.5%	5.5%
Prioritare - masive (pagat dhe pensionet nga qeveria)	40.2%	46.6%	8.7%	8.3%
Pagesat xhiro	4.9%	4.0%	8.3%	7.8%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	4.5%	4.2%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.0%	0.0%	19.0%	18.1%
Te kthyer	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK.

Sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, kategori që arriti vlerën në 9.04 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 3.67 miliardë euro deri në fund të vitit 2022. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁵⁷ në vitin 2022 arriti në 2.37 milionë, që paraqet një rënie vjetore prej 0.6 përqind. Zvogëlimi i numrit të llogarive të kursimit për

11.3 përqind krahasuar me një vit më parë (kryesisht llogari të individëve) ka ndikuar ka rënien e përgjithshme për 0.6 përqind.

Trendi i shpejtë dhe i sigurtë i zhvillimit të infrastrukturës virtuale ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2022. Bankat kanë rritur përpjekjet e përgjithshme për digjitalizim dhe automatizim të shërbimeve bankare. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë

⁵⁷ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

vazhduar rritjen. Deri në fund të vitit 2022, numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 688.9 mijë⁵⁸ (tabela 14), që paraqet një rritje vjetore prej 28.1 përqind. Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë

individuale me pjesëmarrje prej 89.6 përqind të gjithsej llogarive E-banking, pasuar nga ato afariste me pjesëmarrje prej 10.4 përqind.

Tabela 14. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i degëve bankare	46	47	50	43	49
Numri i nëndegëve bankare	166	159	149	145	141
Numri i ATM-ve	491	497	513	516	534
Numri i POS-ve	13,183	13,769	13,421	13,836	14,769
Numri i llogarive 'e-banking'	250,733	337,693	411,346	537,733	688,891

Burimi: BQK.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 2.1 përqind. Numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje vjetore prej 2.0 përqind dhe arriti në 1,306,884, kurse me funksion krediti shënoi rritje 2.9 përqind, në 181,691 sosh.

Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat

Visa (55.5 përqind) pasuar nga ato Master Card (40.6 përqind), kurse kartelat lokale kishin një pjesëmarrje prej 3.9 përqind. Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM), dhe të numrit të paisjeve POS (angl. Point-of-Sale) krahasuar me periudhën paraprahe (tabela 14).

Tabela 15. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022
ATM tërheqje në para të gatshme	58.9%	59.5%	62.7%	58.8%	56.1%
ATM depozitime	30.9%	29.9%	27.3%	30.8%	32.2%
Kredit transference nëpërmjet ATM	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	0.2%	0.2%	0.1%	0.2%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	9.8%	10.3%	9.8%	10.2%	11.6%

Burimi: BQK.

Numri i depozitimeve në sektorin bankar përmes ATM-ve gjatë kësaj periudhe arriti në 2.7 milionë transaksione në vlerë prej 2.22 miliardë euro. Si rrjedhojë, 32.2 përqind nga gjithsej vlera e transaksionve me kartela përmes terminaleve ishin të ATM-ve me funksion depozitimi (tabela 15).

Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në terminalet POS arriti në 25.9 milionë në vlerë prej 799.0 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2022 kishte një pjesëmarrje prej 11.6 përqind.

⁵⁸ Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimi të numrit të llogarive të qasshme

(aksessueshme) nga interneti. Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

8. Korniza për Makroprudencë

Qëllimi parësor i politikës makroprudenciale është të identifikojë, monitoroj dhe vlerësoj rrezikun sistemik të stabilitetit financiar, dhe të ndërmarrë masat që synojnë parandalimin apo reduktimin e rreziqeve sistematike dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar ndaj këtyre rreziqeve. Përmes objektivave të ndërmjetëme synohet zbutja e rreziqeve sistematike që mund të shkaktohen nga zhvillimet në indikatorët e caktuar ekonomik.

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë. Në funksion të mandatit makroprudencial, Komiteti Këshilldhënës për Makroprudencë (KKM) ka vazhduar të mbajë takime të rregullta tremujore ku është raportuar mbi dinamikat e tregut dhe rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Në baza të rregullta, ndër tjera, në KKM janë prezantuar rezultatet e dy instrumenteve të kalibruara për qëllime të mbikëqyrjes makroprudenciale që aplikojnë shtesa të kapitalit (anglisht: Capital based Buffers). Për të adresuar dinamikat në kuadër të dimensionit ciklik të rrezikut sistemik, në KKM janë prezantuar rezultatet tremujore të Kapitalit Shtesë Kundërciklik, që kryesisht bazohet në parametrin e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së (anglisht: Credit/GDP gap). Gjithashtu, për të adresuar dimensionin strukturor dhe ndër-sektorial të rrezikut, KKM ka analizuar edhe rezultatet tremujore të Kapitalit Shtesë bazuar në vlerësimin e bankave me rëndësi sistematike.

Përderisa ndryshimet përkatëse rregullative që do të adresojnë specifikisht mandatin

makroprudencial të BQK-së janë në proces⁵⁹, ndryshime që ndër tjera do të përcaktojnë edhe metodologjinë e këtyre instrumenteve dhe potencialisht të ridefinojnë nivelet e shtesave për kapital, instrumentet e kalibruara kanë shërbyer për monitorimin e dinamikave të këtyre rreziqeve dhe indikacionet që kanë dhënë janë prezantuar në nivelet më të larta ekzekutive. Indikatorët tjerë relevant të paraqitur në tabelën 14 dhe të elaboruar në kuadër të kapitullit të rreziqeve të sektorit bankar në këtë raport, krahas hendekut të kreditimit, plotësohen tutje me informacione kualitative dhe gjykim të ekspertëve relevant, për të formësuar përfundimisht gjykimin për peshën e zhvillimeve specifike në rrezikun e përgjithshëm sistemik.

Perspektiva e stabilitetit financiar në eurozonë është përkeqësuar me presionet inflacioniste në rritje përgjatë vitit 2022, përkeqësuar më tej me tensionet gjeopolitike. Kjo ka nxitur vendet e eurozonës të jetë më aktive në aplikimin e masave përkatëse makroprudenciale apo aktivizimin e masave të reja përkitazi rreziqeve të rritura. Rreziqet e rritura në shumë dimensionë dhe posaqërisht rreziku i rritur ndër vite nga tregu i pasurive të paluajtshme në eurozonë, ka ndikuar që shumë vende të fillojnë shtrëngimin e politikës makroprudenciale përmes rritjes së kërkesave për shtesa të kapitalit kundërciklik, aktivizimit të shtesave (buffers) të reja të kapitalit bazuar në rrezikun sistemik sektorial (CRD V⁶⁰) si dhe aplikimin e masave të tjera makroprudenciale si kufizimet në kreditimin e ekonomive familjare⁶¹. Në vitin 2022, dinamikat e përgjithshme në tregues të zgjedhur të makroprudencës u karakterizuan me qëndrueshmëri, duke rezultuar në parametra lartë mbi kërkesat rregullative. Aktiviteti ekonomik në vend në vitin 2022 shënoi rritje më të ngadalësuar kundrejt vitit paraprak, ndikuar nga dobësimi i kërkesës së përgjithshme.

⁵⁹ Draft ligji i ri për banka është në proces të shqyrtimit dhe aprovimit, dhe kjo do ta përcaktojë BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale dhe ushtrim të mandatit për makroprudencë duke mundësuar njëkohësisht nxjerrjen instrumente rregullative përkitazi me vlerësimet e rreziqeve sistematike.

⁶⁰ Direktiva e 5të mbi kërkesat për kapital (CRD V), direktivë e bartur nën diskrecion të autoritetve vendore të eurozonës, ka mundësuar

aplikimin e shtesave të kapitalit sipas rreziqeve specifike për vendet përkatëse, e ashtuquajtur shtesa për rrezikun sistemik sektorial.

⁶¹ Instrumentet e aplikuara që nga fundviti 2022, nga vendet e eurozonës: <https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/macprudential-measures/html/index.en.html>


https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/fsr/shared/pdf/measures/Overview_measures_notified_to_ECB_April_2022.xlsx?129e7e6b656f325c6455ba0b4f28a06a

Tabela 16. Objektivat, indikatorët vlerësues të rrezikut sistemik dhe instrumentet e politikës makroprudenciale

	OBJEKTIVAT	INDIKATORËT E RREZIQEVE TË PËRCAKTUARA NGA OBJEKTIVAT	INSTRUMENTET MBËSHTETËSE
1	Zbutjen dhe parandalimin e rritjes së tepërt të kreditimit dhe të levës	-Ambienti makroekonomik (BPV, Inflacioni) -Kreditimi sipas segmentëve dhe sektorëve ekonomik -Kapitalizimi -Hendeku Kredi/BPV	Masa bazuar në shtesa të kapitalit (capital based measures): 1. Kapitali shtesë kundërciklik (CCyB) 2. Kapitali shtesë sektorial 3. Shtaesa mbi raportin e levës Masat bazuar në huamarrësin (Borrower based measures): 1. Raporti i koleteralizimit të kredisë (Loan-to Value ratio LTV) 2. Raporti i borxhit dhe kështit të borxhit ndaj të hyrave (Debt-to-Income DTI& Debt-service-toIncome DSTI)
2	Të zbusë dhe të parandalojë mospërputhjet e mëdha të afateve të maturimit dhe jo likuiditetit në treg	-Treguesi i Likuiditetit (mjetet likuide ndaj detyrimeve afatëshkrutëra -Raporti Kredi/Depozitë -Rezervat e likuiditetit -Hendeku i likuiditetit	Masa bazuar në kërkesë për likuiditet (Liquidity based measures): 1. Treguesit të Mbulimit me likuiditet (Liquidity-coverage-ratio LCR) 2. Treguesit e Financimit të Qëndrueshëm Neto (Net-stable -funding-ratio NSFR) 3. Përcaktim të raportit kredi-depozitë (restricitons on funding resources) 4. Kufizimet në ekspozime ndaj depozitorëve më të mëdhenjë (large exposure limits)
3	Kufizimi direkt dhe indirekt i koncentrimit të ekspozimeve kreditore	-Koncentrimi i rrezikut kreditor (Ekspozimet e mëdha kreditore); raporti i ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	Masa tjera makroprudenciale (Other measures): 1. Kufizimet në ekspozimet e mëdha kreditore (Large exposure restrictions)
4	Kufizimin në ndikimin sistemik nga iniciativa jo-korrekte në mënyrë që të zvogëlojë rrezikun moral (moral hazard)	-Performanca financiare e bankave -Normat e interesit në kredi dhe depozita -Koncentrimin i Aseteve -Bankat me rëndësi sistematike	Masa bazuar në shtesa të kapitalit (capital based measures): 1. Shtesa për kapital ndaj bankave me rëndësi sistematike (SIFI capital surcharges OSII)

Burimi: Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (European Systemic Risk Board)

Grafik 93. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Burimi: BQK.

Institucionet financiare në vend (bankat dhe institucionet mikrofinanciare) janë burim kryesor i financimit të aktiviteteve të korporatave jofinanciare dhe ekonomive familjare. Politikat kredituese të bankave vlerësohen të kenë qenë në linjë me kapacitetin


absorbues të agjentëve ekonomik në treg. Hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (anglisht: *credit to GDP gap*), në fund të vitit 2022 është në territor negativ prej -0.354 përqind nga -0.305 përqind një vit më parë. Hendeku negativ prej -0.354 sugjeron që aktiviteti kreditues në vend në vitin 2022 nuk

ka kaluar në të ashtuquajturën periudhë të ‘mbikreditimit’, duke lënë hapësirë për rritje të mëtejme, pa rrezikuar stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend (grafik 93).

Në vitin 2022, sektori bankar rezulton të ketë pesë banka me rëndësi sistemike, ngjashëm me vitin paraprak. Kapitali shtesë ndaj

bankave me rëndësi sistemike është kalibruar dhe paraqitur në grafikun 94, bazuar në kornizën Basel III dhe metodologjinë e rekomanduar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA). Megjithatë këto dy metoda dhe instrumente përkatëse makroprudenciale⁶², në mungesë të bazës ligjore, aktualisht përdoren vetëm si indikacion i nivelit të rreziqeve.

Grafik 94. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë 1



⁶² Metodologjia e të dy metodave gjendet në verzionet e kaluara të RSF.

9. Shtojca Statistikore

Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Figura 2. Ekonomia e brendshme




Figura 3. Ekonomitë familjare






Figura 4. Ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Figura 5. Qeveria




Burimi: BQK.

Figura 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK.

Figura 7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK.

Figura 8. Likuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK.

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.9	16.5	16.4	15.5
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.2	14.7	14.7	13.5
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	1.5	4.6	3.4	3.6
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	1.9	2.5	2.3	2.0
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.2	0.2	0.3	0.3
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	63.3	63.3	62.3	62.1
	Ekonomitë familjare	36.4	36.4	37.4	37.6
	QJSHF	0.03	0.03	0.02	0.01
	Jo-rezidente	0.0	0.1	0.0	0.1
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)	2.1	1.7	2.1	2.6
	Kthimi në kapital (KNK)	17.2	14.0	17.3	20.7
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	80.6	79.2	76.5	76.7
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	48.1	46.1	45.4	43.8
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	28.8	30.1	28.8	26.8
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	23.3	23.2	23.7	21.5
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	31.2	31.1	30.6	29.3
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	37.6	40.4	37.2	36.5
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	4.7	3.5	1.5	2.3
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	11.2	11.7	11.1	8.9
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	81.8	89.5	89.8	104.1
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	43.5	43.3	43.2	44.5
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	4.8	4.7	4.5	3.9
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	129.2	133.9	130.9	127.9
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.4	4.2	4.3	3.0

Të dhënat nga janari 2022 janë në përputhje me metodologjinë e re të rekomanduar për FSI-të (Udhëzuesi FSI 2019).



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org